



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar auditimi financiar në Bashkinë Kurbin

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

MBI AUDITIMIN FINANCIAR
NË BASHKINË KURBIN

Dhjetor 2022

Nr.	PËRMBAJTJA	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-12
I.1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4-5
I.2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-8
I.3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	8-9
II.	HYRJA	9-13
II.1.	Objekti i auditimit	
II.2.	Qëllimi i auditimit	
II.3.	Identifikimi i çështjes	
II.4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
II.5.	Përgjegjësitë e audituesve	
II.6.	Kriteret e vlerësimit	
II.7.	Standardet e auditimit	
II.8.	Metodat e auditimit	
II.9.	Dokumentimi i auditimit	
III.	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	13-72
III.1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	13-14
III.2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	14-72
III.2.1	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin	14-21
III.2.1.1	Mbi auditimin e brendshëm	22-24
III.2.2	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	24-48
III.2.3	Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2021	48-58
III.2.4	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	59-72
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	72-79
V.	ANEKSE	80-100

Shkurtime

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
DPAV	Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore
DVASHK	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrulli i Lartë i Shtetit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrulli
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PBA	Projekt-Buxheti Afatmesëm
PF	Pasqyrat Financiare
TNI	Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
USH	Urdhër Shpenzimi
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim financiar në Bashkinë Kurbin, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin dhe implementimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, si dhe të transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar.

Gjatë periudhës së auditimit nga data 22.08.2022 deri në datën 19.09.2022, grupi i auditimit auditoi periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej 5 akt-konstatime dhe 1 akt-verifikim. Mbi aktet e mbajtura nga grupi i auditimit, nga subjekti i audituar, janë paraqitur observacionet, të cilat janë reflektuar rast pas rasti në mënyrë të përmbledhur.

-Për projekt raportin e auditimit nga subjekti i audituar me shkresën nr.693/4 prot., datë 07.11.2022, janë paraqitur observacione, të cilat janë trajtuar rast pas rasti në çështjet përkatëse.

Në mënyrë të përmbledhur, në përfundim rezultoi se nga auditimi i:

-Zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura, rezulton se Bashkia Kurbin për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2021 ka shpenzuar vlerën 10,915 mijë lekë për 6 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona;

-Programimit të të ardhurave për vitin 2021 në vlerën 153,897 mijë lekë, rezulton se janë realizuar në fakt në vlerën 110,498 mijë lekë, pra me një realizim në masën 71.8 %, ku mosrealizimi është në vlerën 43,399 mijë lekë, ose 28.2 e planit të miratuar. Detyrimet e papaguara nga taksapaguesit për periudhën 2011-2021 paraqiten në shumën prej 332,560 mijë lekë në progresiv, ku vetëm për vitin 2021 shuma e debitorëve e evidentuar është 103,605 mijë lekë, që përbëjnë të ardhura të munguara për Bashkinë Kurbin;

-Dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktivitetit si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve rezultoi se 17 subjekte nuk kanë paguar për të rinovuar licencën ku sipas dispozitave ligjore duhet të paguanin tarifën prej 1,000,000 lekë secili. Për licencimin 5 vjeçar nga viti 2021 dhe që shtrin efektet deri në vitin 2026, diferenca e tarifës së arkëtuar për secilin subjekt ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë në vlerë totale prej 17,100,000 lekë;

-Vjeljes së detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Bashkia Kurbin, nuk janë marrë masa për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ish-ALUIZNI Lezhë (aktualisht DVASHK Lezhë), për 1095 raste, në vlerën prej 39,481,815 lekë;

-Detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2021, u konstatua se janë të pa likuiduara gjithsej 1344 fatura për vlerën 47,605 mijë lekë (1344 fatura gjithësej), nga të cilat 237 fatura të palikujduara janë krijuar në vitin 2021 në vlerën 1,552 mijë lekë, ndërsa sipas përlllogaritjeve të grupit të auditimit, rezulton se vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura ne 31.12.2021, që duhej të raportohet në MFE duhet të është në vlerën 48,101 mijë lekë;

-Raportimit të transaksioneve dhe ngjarjeve ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2021, ka rezultuar kontabilizimi jo i saktë dhe i drejtë për:

Llogaria nr. 468 “Debitorë të ndryshëm” është pasqyruar më pak për vlerën 101,030,695 lekë; Llogaria nr. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është pasqyruar më shumë për vlerën 13,002,996 lekë;

Llogaria nr.401-408 “Furnitor dhe llogari të lidhura me to”, është pasqyruar më pak për vlerën 10,565,436 lekë;

Llogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, është pasqyruar më pak për vlerën 606,602,230 lekë;

Llogaria nr. 215 “Mjete transporti” është pasqyruar më shumë për vlerën 49,828,544 lekë.

I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura për vitin 2021, rezulton se Bashkia Kurbin për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, ka shpenzuar vlerën 10,915 mijë lekë për 6 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi për një pozicion pune paguhen dy persona. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur, konkretisht për 6 praktika likuidimi të vendimeve gjyqësore të përzgjedhura në mënyrë rastësore, u konstatua se janë kryer likuidime pjesore, megjithëse Bashkia Kurbin ka pasur disponibilitete në thesar për të likuiduar plotësisht vendimet gjyqësore. Gjithashtu në urdhrin e Titullarit të institucionit për likuidimin e vendimeve gjyqësore të mësipërme, nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna, moslikuidimit në kohë të detyrimit pa krijuar shpenzime të përbarimit) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Kurbin. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative, do të ndikonte pozitivisht në korigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore dhe si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.	24-48	E Lartë	-Kryetari i Bashkisë Kurbin dhe Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme, që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun dhe likuidimin e plotë të detyrimeve të prapambetura nga vendimet gjyqësore. -Kryetari i Bashkisë Kurbin të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.
2	Programimi i të ardhurave për vitin 2021 është në vlerën 153,897 mijë lekë dhe janë realizuar në fakt në vlerën 110,498 mijë lekë, pra me një realizim në masën 71.8 %, ku mosrealizimi është në vlerën 43,399 mijë lekë. Detyrimet e papaguara nga taksapaguesit për periudhën 2011-2021 paraqiten në shumën prej 332,560 mijë lekë në progresiv, ku vetëm për vitin 2021 shuma e debitorëve është 103,605 mijë lekë, vlera këto të konsiderueshme, që përbëjnë të ardhura të munguara për Bashkinë Kurbin. Administrimi i procesit për mbledhjen e detyrimeve tatimore ka mangësi në lidhje me ndjekjen e veprimeve procedurale nga ana e Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave Vendore, pasi nuk janë ezauruar të gjitha hapat dhe mekanizmat e përcaktuar në legjislacionin tatimor për të siguruar mbledhjen e këtyre detyrimeve.	24-48	E Lartë	-Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore, të marrë masa konkrete ndaj subjekteve debitorë duke ndjekur e zbatuar procedurat tatimore, me qëllim mbledhjen e detyrimeve të prapambetura. -Të marrë masa për arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore në momentin që lind detyrimi me qëllim mos krijimin e detyrimeve të prapambetura për secilën kategori biznesi.
3	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të subjekteve të liçencuara për ushtrim aktivitetit si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve u konstatua se 17 subjekte nuk kanë paguar tarifën 1,000,000 lekë, për të rinovuar licensën e ushtrimit të aktivitetit, duke krijuar të ardhura të munguara	24-48	E Lartë	Bashkia Kurbin, nëpërmjet Drejtorisë së Ardhurave Vendore të marrë masa që për 17 subjekte debitorë të arkëtojë tarifatat e plota, për diferencën debitorë prej 17,100,000 lekë, detyrim ky për paisjen me autorizim/liçensë për tregtimin me pakicë të

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	në buxhetin e Bashkisë në vlerë totale prej 17,100,000 lekë.			karburanteve dhe gazit të lëngshëm vajrave lubrifikante për automjetet. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për pagesën e tarifës së liçencë/autorizimit, Bashkia Kurbin në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik Industrial të ndërmarrin veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.
4	Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale, u konstatua se vlera debitore për këtë taksë në mënyrë progresive është 39,481 mijë lekë për 1095 subjekte, nga të cilat 25 subjekte për vlerën 787 mijë lekë janë krijuar në vitin 2021. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Kurbin, nuk janë marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.	24-48	E Lartë	Drejtorja e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit t'i përcjellë Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave (DAP) listën me subjektet debitore për taksën e ndikimit në infrastrukturë, si dhe në vijim DAP Bashkia Kurbin të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 39,481 mijë lekë.
5	Nga auditimi i llogarisë nr.468 "Debitorë të ndryshëm", u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Kurbin për arkëtim ndaj të tretëve, nuk është pasqyruar saktë, sepse kjo llogari është pasqyruar më pak për vlerën 101,030,695 lekë duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, për vlerën prej: -1,461,222 lekë për taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale; -1,347,673 lekë për taksat dhe tarifatat (principal dhe kamat-vonesë) vendore të biznesit; -3,679,921 lekë, vlerë e përfshirë brenda shumës totale 59,611,011 lekë, e trashëguar nga vitet e mëparshme dhe që nuk është e analizuar me dokumentacion në mënyrë analitike. -17,100,000 lekë, detyrime që kanë për të likuiduar 17 subjekte, të cilët janë pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit të tregimit të karburanteve; -1,235,438 lekë detyrim për likuidimin e tarifës së qirasë nga subjekti "H.C" Sh.P.K; -55,787,323 lekë për taksën e tokës bujqësore; -20,419,118 lekë për detyrimet e kategorisë "Familjar", e trashëguar nga vitet e mëparshme dhe që nuk është e analizuar me dokumentacion në mënyrë analitike. Konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr. 470 "Llogari në pritje – të ardhura për t'u marrë" (me kundërparti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar.	48-59	E Lartë	Drejtorja e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 "Debitorë të ndryshëm" me kundërparti llogarinë nr. 470 "Të ardhura për t'u marrë".
6	Nga auditimi i llogarisë nr. 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje", u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, është pasqyruar më shumë për vlerën 13,002,996 lekë.	48-59	E Lartë	Drejtorja e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje", si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave ju ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
				garancia është marrë në dorëzim.
7	Nga auditimi i llogarisë nr.401-408 “Furnitor dhe llogari të lidhura me to”, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më pak, për vlerën 10,565,436 lekë, për fatura të mbërritura, të palikujduara në fund të vitit 2021 dhe të pa regjistruara në pasqyrat financiare. Një pjesë e faturave të mësipërme (dy fatura të muajit tetor të vitit 2021 të subjektit “V” Sh.P.K në vlerën 496,048 lekë gjithsej) kanë plotësuar afatin 60-ditor pa u likujduar, e për rrjedhojë duhet të kontabilizohen në llogarinë nr.467 “Kreditor të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr.486, me qëllim pasqyrimin e plotë të vlerës së detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2021.	48-59	E Lartë	Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve të bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë nr. 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”.
8	Nga auditimi i llogarisë nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar me 606,602,230 lekë gjithsej, e ndarë për vlerën prej: -595,000,000 lekë aksione në shoqërinë aksionare “Ujësjetllës Kanalizime Kurbin Sh.A” me NIPT K07628310A; -10,727,230 lekë aksione në shoqërinë aksionare “Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A” me NIPT J61819502V; -875,000 lekë aksione në shoqërinë aksionare “Klubi i Futbollit Laçi” me NIPT L18105301N.	48-59	E Lartë	Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.
9	Nga auditimi i llogarive nr.210 “Toka, Troje, Terrene” nr.211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, u konstatua se në këto llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera në vitet 2006-2018, pa ndryshuar në vijimësi, duke mos pasqyruar: -vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, të pallatit të kulturës, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj; -vlerat e trojeve, pyjeve dhe kullotave të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Kurbin, -Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i aseteve për dy llogaritë e mësipërme. -Për llogaritë e mësipërme në Bashkinë Kurbin nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj.	48-59	E Lartë	- Kryetari i Bashkisë Kurbin të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me qëllim kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve, si dhe në vijim Drejtoria e Financës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.210 “Toka, Troje, Terrene” nr.211 “Pyje, kullota, plantacione”. - Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme, për hartimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, i cili minimalisht duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.
10	Nga auditimi i llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më shumë për vlerën 49,828,544 lekë, si rrjedhojë e kontabilizimit në këtë llogari të disa makinerive, si 3 fadroma, 1 kovë eskavatori dhe 1 rimorkiator, të cilat janë makineri dhe jo mjete transporti, si dhe duhet të klasifikohen në llogarinë nr.214. Për këto makineri duhet të	48-59	E Lartë	Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	aplikohet normë tjetër amortizimi (5%) dhe jo (20%).			

I.3. Konkluzione dhe opinioni i auditimit.

Opinionin mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Kurbin për vitin ushtrimor 2021, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705, dhe ISSAI 1200¹, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, **shprehim një opinion të modifikuar**² për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Kurbin, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, të cilat janë të shprehura në bazën për opinionin e modifikuar.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Kurbin, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISSAI 1700.7).

Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 39,340 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve, si dhe faktin se disa llogari në pasqyrat financiare nuk paraqesin vlerën e tyre reale, si vijon:

- Llogaria nr.468 “Debitorë të ndryshëm” është pasqyruar më pak për vlerën 101,030,695 lekë;
- Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është pasqyruar më shumë për vlerën 13,002,996 lekë;
- Llogaria nr.401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”, është pasqyruar më pak për vlerën 10,565,436 lekë;
- Llogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, është pasqyruar më pak për vlerën 606,602,230 lekë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Kurbin.

Strukturat drejtuese të subjektit Bashkia Kurbin, Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator të fushës.

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore,

¹ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit. Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

² Audituesi duhet të modifikojë opinionin në rastet kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.

planifikimin dhe realizimin e buxhetit, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare.

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II. HYRJA.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 693/2 Prot., datë 29.07.2022, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Kurbin nga data 22.08.2022 deri në datën 19.09.2022, u krye “*Auditimi Financiar*”, i cili mbuloi periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K.K., Auditues, Përgjegjës Grupi.
2. A.G., Auditues, Anëtar.
3. R.L., Auditues, Anëtar.

II.1. Objektivi i auditimit.

Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2021, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

II.2. Qëllimi i auditimit.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

II.3. Identifikimi i çështjes.

Projekt Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjëseve të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Kurbin, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Fushat të cilat u audituan janë si vijon:

1. Aktiviteti i Njesisë së Auditit të Brendshëm;
2. Implementimi dhe zbatimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
3. Planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit;
4. Raportimi financiar.

II.4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Niveli drejtues i Bashkisë Kurbin (Kryetari i Bashkisë, në rolin e Nëpunësit Autorizues të institucionit) dhe niveli i mesëm drejtues (Drejtori i Financës, në rolin e Nëpunësit Zbatues), kanë përgjegjësinë për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar; Për krijimin e kontrolleve të brendshme të nevojshme, për të mundësuar përgatitjen e drejtë të pasqyrave financiare, pa keq-raportime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; dhe kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

II.5. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e audituesve është të shprehin konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim, pra nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar dhe rezultatet financiare të njesisë ekonomike janë në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi (ISSAI 1200.3). Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së arsyeshme. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozonë që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë gjithë procesit të auditimit, audituesi duhet të ushtrojë gjykim dhe skepticizëm profesional dhe ndër të tjera: Identifikon dhe vlerëson risqet e keq-pasqyrimit material, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, bazuar në të kuptuarit e entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm të njesisë. Merr evidencat e duhura dhe të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e keqraportimeve materiale. Formon një opinion për pasqyrat financiare dhe objektivat shtesë mbi të cilat raportimi është i detyrueshëm bazuar në përfundimet e nxjerra nga evidencat e grumbulluara. (ISSAI 1200.7) Raporton rastet e mospërputhshmërisë me bazën ligjore, përfshirë buxhetin dhe përgjegjshmërinë, dhe/ose Raporton mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

II.6. Kriteret e vlerësimit.

Standardet dhe kuadri ligjor që shërbeu si kriter për vlerësimin e aktivitetit të subjektit të audituar, është si më poshtë vijon:

Lloji i dokumentit:

Detajet e bazës ligjore dhe rregullatore

Standarde auditimi dhe kuadri ligjor i KLSH: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj;
Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);
Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI¹, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit”;
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);

	Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
	Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
Ligje mbi të cilat mbështetet subjekti në aktivitetin e tij:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
	Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
	Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
	Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”;
	Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;
	Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;
	Ligj nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar.
VKM:	VKM nr. 807, datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore”, i ndryshuar;
	VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar;
	VKM nr.391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, e ndryshuar;
	VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për Miratimin e kriterëve të krijimit të Njërive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.
Akte të tjera nënligjore:	Udhëzimi MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;
	Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;
	Udhëzimi MF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njërive të vetëqeverisjes vendore”;
	Udhëzimi MF nr.10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, etj;
	Udhëzimet vjetore të MFE për zbatimin e buxhetit;
	Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësite publike”;
	Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
	Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik miratuar me urdhrin e Ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017.
Akte normative të Bashkisë Kurbin:	VKB për miratimin e rregullores mbi organizimin e funksionimin e Bashkisë Kurbin, etj;
	VKB për miratimin e paketës fiskale për vitin 2021.

II.7.Standardet e auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Projekt Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit

ISSAI 100, 200, Manualit të Auditimit të Financiar, Rregullores së Procedurave të Auditimit, dhe sigurohet se auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar.

II.8. Metodat e auditimit.

1. Kontrolli aritmetik.
2. Kontrolli i vlerësimeve.
3. Konfirmimi nga të tretët.
4. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe MFK.

II.9. Dokumentimi i auditimit.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, akt-konstatimeve 5 gjithsej, si dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili do të jetë edhe materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

▪ **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim**
Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

▪ **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

▪ **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

III.1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Bashkia është person juridik. Ky autoritet ushtrohet nëpërmjet akteve të këshillit dhe kryetarit të bashkisë si organe të zgjedhura, në përputhje me kompetencat dhe në ushtrimin e funksioneve qeverisëse që ato kanë në bazë të ligjit.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik.

Zona Gjeografike: Bashkia Kurbin shtrihet në Shqipërinë qendrore dhe kufizohet në veri me

bashkitë Lezhë dhe Mirditë, në lindje me bashkinë Mat, në jug me bashkinë Krujë dhe në perëndim me Detin Adriatik.

Bashkia Kurbin është pjesë e Qarkut Lezhë dhe përbëhet nga 4 njësi administrative të cilat janë: Laçi, Mamurrasi, Fushë-Kuqe dhe Milot. Në përbërjen e tyre këto njësi administrative përfshijnë gjithsej 3 qytete (Laç, Mamurras dhe Milot) dhe 24 fshatra.

Administrata e Bashkisë Kurbin dhe njësitë shpenzuese në varësi të saj, përbëhen nga:

-Këshilli Bashkiak (1 punonjës), Sekretari i Këshillit (1);

-Kryetari 1, Zv.Kryetari 2, Kabineti i Kryetarit (3), Drejtori 10 - Drejtoria e Financës (14), Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (10), Drejtoria e Shërbimeve Publike (9), Drejtoria e Mjedisit (7), Drejtoria e Planifikimit të Ardhurave (18), Drejtoria e Burimeve Njerëzore (14), Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike (8), Drejtoria e Ndihmës Ekonomik & Kujdesit Social (15), Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (23), **Sektorë 8** - Auditi i Brendshëm (3), Njësia për koordinimin e integritit Evropian dhe Ndihmës së Huaj (2), Zyra One Stop Shop (4), Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit (7), Policia Bashkiake (12), Pallati i Kulturës (13), Sektori i Çerdhës së Qytetit (13), Sektori i Shërbimeve Mbështetëse (Gjelbërim+Ndriçim+Dekor (15), **Njësitë Administrative 3** (Njësia Administrative Mamurras (20), Njësia Administrative Fushë-Kuqe (12), Njësia Administrative Milot (17), **Agjensi me funksione të deleguara 6** - Zyra e Gjendjes Civile (7), QKB (2), Agjencia e Infrastrukturës Rrugore dhe Shërbimeve Mbështetëse (25), Agjencia e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave (7), Agjencia e Kullimit dhe Vaditjes (10) dhe Agjencia e Arsimit Parashkollor dhe Mbështetës (138).

Funksionet kryesore të Bashkisë Kurbin kryhen në fushën e:

Infrastrukturës dhe shërbimeve publike.

Shërbimeve sociale.

Kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese.

Mbrojtjes së mjedisit.

Bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike.

Zhvillimit ekonomik vendor.

Sigurisë publike.

Financat.

Bashkia Kurbin ka të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

a) krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;

b) vendos taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) harton, miraton dhe zbaton buxhetin e tyre;

ç) mban llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofron informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

-Për vitin 2021 nga Bashkia Kurbin janë shpenzuar gjithësej 2,441,535 mijë lekë (me burim të ardhurat e veta, transferta e pakushtëzuar, kushtëzuar, specifike dhe fondet e rindërtimit), nga të cilat:

255,640 mijë lekë për investime;

268,740 mijë lekë për paga dhe sigurime;

131,257 mijë lekë për mallra dhe shërbime të ndryshme;

1,785,898 mijë lekë për transferta në ndihmë ekonomike për familje në nevoj, invalidë, bonus qiraje dhe rindërtimi etj.

-Për vitin 2021, Bashkia Kurbin nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore, ka arkëtuar gjithësej 110,498 mijë lekë.

III.2.Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

III.2.1.Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe Auditi i Brendshëm.

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/ Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Kurbin, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i Kontrollit”, “Menaxhimi i Riskut”, “Aktivitetet e Kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I.Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1: “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”.

-Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

-Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

-Për vitin 2021 ka qenë në fuqi Rregullore e Brendshme e miratuar me Vendimin nr. 7, datë 24.11.2016, si dhe Kodi i Etikës e miratuar me vendim nr.9 datë 07.12.2016 të Kryetarit të Bashkisë Kurbin. Nuk ka urdhër të titullarit për njohjen dhe trajnimin e stafit me ndryshimet në rregullore.

-Nga institucioni nuk ka program trajnimi të dedikuar për integritetin dhe sjelljen etike.

-Në Rregulloren e Brendshme është përcaktuar procedura e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, si dhe janë përcaktuar detyrat për njësinë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, procedura të mirëfillta për trajtimin e rasteve të tilla. Ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjisllacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës.

-Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sportelet e Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun), duke i’u adresuar strukturave të Bashkisë sipas problemeve, të cilat do të trajtojnë ankesat dhe kërkesat dhe përgjigjet do të firmosen nga Drejtorët sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën.

-Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip një herë në 6 muaj. Po ashtu ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit

që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune. Për vitin 2021 janë kryer vlerësimet e punonjësve.

Në lidhje me parimin 2: “Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”.

-Për vitin 2021 nuk ka pasur plan-veprimi për MFK, i cili të përfshijë aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit, nuk administrohen raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

-Për vitin 2021, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë hartuar çdo 4 - muaj, si dhe ka raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Ndërsa nga shoqëritë e përbashkëta, ku bashkia është aksionere dhe nga struktura në varësi të saj, Bashkia merr raportime në lidhje me vendim-marrjen, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat, përveç raportimeve financiare për efekt argumentimi të fondeve të alokuara.

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3: “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se rregullorja e brendshme nuk është përditësuar pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar struktura e Bashkisë Kurbin, çka ndikon negativisht në linja të qarta raportimi, komunikimi dhe llogaridhënie.

-Në rregulloren e brendshme, por edhe me urdhër të titullarit, nuk ka të përcaktuar linja komunikimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm të bashkisë, konkretisht sektori i menaxhimit të kontratave me sektorin e taksave dhe tarifave vendore, me qëllim shkëmbimin e informacionit sa kontrata për punë publike janë lidhur, subjektet, si dhe nëse këta të fundit janë me seli kryesore në Bashkinë Kurbin apo duhet të pajisen me NIPT sekondar, duke vijuar me tarifimin e tyre nga sektori i taksave dhe tarifave. Kjo mangësi evidentohet edhe në mungesën e komunikimit ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe Drejtorisë së të Ardhurave, me qëllim shkëmbimin e informacionit për subjektet të cilat janë pajisur me leje për kryerjen e punimeve ndërtimore dhe që duhet të pajisen me NIPT sekondar, për të ushtruar aktivitet në Bashkinë Kurbin.

-Lidhur me strukturën organizative të Bashkisë Kurbin, ndërmarrjes dhe institucioneve në varësi, përgjatë vitit 2021 ka pasur 4 ndryshime strukturore. Struktura e Bashkisë Kurbin për vitin 2021 është miratuar me VKB nr.5, datë 05.01.2021.

-Mungon raporti i vlerësimit nga njësia e auditit të brendshëm për përputhjen e rregullores me strukturën organike.

-Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, por është bërë pjesë e dokumentit e PBA-ve, si dhe nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme.

Për çdo drejtori janë përcaktuar objekti, qëllimi, detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist.

Në lidhje me parimin 4: “Njësia publike demonstron angazhimin në realizimin e kompetencave”.

-Në Bashkinë Kurbin nuk është hartuar “Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”.

-Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme, por vetëm nga trajnimet e zhvilluara nga ASPA.

-Për Bashkinë Kurbin Nëpunësi Autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxheri i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor.

-Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin, të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Financës.

Në lidhje me parimin 5: “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”.

-Në Rregulloren e Brendshme është parashikuar “Delegimi i kompetencave” në zbatim të ligjit 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative” si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokollin e institucionit rezulton se, nga NA për periudhën objekt auditimi nuk ka patur raste të delegimit të detyrave.

-Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).

Në zbatim të nenit nr. 24 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar; ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për proçedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore”, për vitin 2021 nuk dokumentohet ngritja dhe funksionimi i GMS.

Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupi të Menaxhimit Strategjik (GMS) rezultoi se:

-Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

-Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

II.Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.

-Nga Bashkia Kurbin përcaktohen objektiva sasior. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5 vjeçar), sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr.68/2017 “Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

-Nuk janë krijuar mekanizmat për vlerësimin e riskut.

-Në Bashkinë Kurbin nuk është krijuar strategjia e menaxhimit të riskut, si dhe nuk ka një strukturë të miratuar dhe një koordinator të deleguar të riskut.

-Në Bashkinë Kurbin nuk është krijuar regjistri i riskut.

-Sa më sipër konstatohet se, për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si silllet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Mbetet problematike menaxhimi i riskut, pasi nuk janë përcaktuar qartë proceset e punës dhe mbi bazën e proceseve të punës të analizohet risku si dhe të përcaktohen hapat konkret në eliminimin e plotë të tij.

-Nuk dokumentohen takimet periodike (1 herë në dy muaj) të Koordinatorit të Riskut me drejtorët e drejtorive përkatëse të institucionit.

-Në Bashkinë Kurbin Drejtoria e Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Drejtoria e të Ardhurave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin Excel, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

Në lidhje me parimin 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”.

-Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe proçedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli

i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Në lidhje me parimin 9: “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.

Bashkia Kurbin nuk ka një sistem të kontrollit të brendshëm.

III.Komponenti: “ Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”.

-Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar pak a shumë edhe proçeset e punës. Ekzistojnë proçedura të brendshme për proçeset e punës, si proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të proçedurave administrative, etj.

-Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

-Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtori i Financës, hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA.

-Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të përlllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimeve/shërbimeve.

-Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e proçedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumenta autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj.

-Në rregulloren e brendshme për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

-Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.

-Në përgjithësi për proçedurat e inventarizimit, vlerësimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të AAGJM, ka gjurmë auditimi, pasi ekziston dokumentacioni i firmosur nga komisionet dhe punonjësit përkatës si: Urdhri i NA për ngritjet e komisionit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi si dhe për asgjesimin e tyre. Ekzistojnë fletët e inventarit, relacioni i vlerësimit për aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, proçesverbale dhe relacionet për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve dhe proçesverbalet për asgjesimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi. Janë prerë dokumentet bazë (fletë-daljet) dhe kryer veprimet kontabël përkatës.

-Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Kurbin, si dhe veprimeve me arkën, kurse një pjesë e taksave dhe tarifave (taksat e ndara) arkëtohen nëpërmjet agjentëve tatimorë si, Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Drejtoria e Kadastrës Kurbin, Drejtoria e Transportit Rrugor. Për këto të ardhura në përgjithësi janë bërë akt-rakordimet përkatëse periodike dhe vjetore dhe janë kontabilizuar.

-Bashkia Kurbin në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të

pagesave dhe gjenden limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

Në lidhje me parimin 11: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

- Bashkia Kurbin nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

-Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të TIK, i cili varet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

-Në Bashkinë Kurbin nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

Në lidhje me parimin 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

-Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve, kjo evidentuar nga lista e projekteve në PBA 2021-2023, të cilët nuk i nënshtrohen një analize kosto-përfitim.

-Ekzistojnë procedurë kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedurë janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë Financës.

-Nuk ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.08.2018 “Për hartimin e PF”, i ndryshuar). Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV.Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

-Sipas komunikimit me personat përkatës në Bashkinë Kurbin dhe verifikimit të grupit të auditimit, faqja e bashkisë është jashtë funksionit, pra nuk sigurohet transparenca e institucionit dhe e drejta për informim.

Për vitin 2021 nga Bashkia Kurbin (për vendimmarrje për dhënien e pasurive të paluajshme me qira, buxhetin) nuk janë kryer konsultime me publikun dhe palët e interesit.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor.

Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit.

Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë shkresore/verbale/email. Grupi auditues konstaton se, nuk e kanë të gjithë punonjësit mundësinë e përdorimit të email-it zyrtar të institucionit duke qenë se sistemi ofron një numër të kufizuar adresash email-i.

V.Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”.

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.

-Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, administrohen raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet periodikisht. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet..

-Bashkia Kurbin lidhur me pyetësin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, për vitin 2021 ka raportuar në MFE me nr.1231/1 prot., datë 28.02.2022.

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.

-Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

Titulli i gjetjes: Funkionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk kuptohen dhe nuk funksionojnë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

“Mjedisi i kontrollit”

-Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

-Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit.

-Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.

-Në rregulloren e brendshme, por edhe me urdhër të titullarit, nuk ka të përcaktuar linja komunikimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm të bashkisë.

-Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

-Nuk dokumentohet procedura e ndjekur për komunikimin dhe njohjen e stafit të Bashkisë Kurbin për ndryshimet ligjore të ndodhura në fusha të ndryshme.

-Për vitin 2021 nuk ka pasur plan-veprimi për MFK, i cili të përfshijë aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit, nuk administrohen raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

-Në Bashkinë Kurbin nuk është hartuar “Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”.

-Për vitin 2021 nuk dokumentohet ngritja dhe funksionimi i GMS.

“Menaxhimi i Riskut”

-Nuk janë krijuar mekanizmat për vlerësimin e riskut.

-Nuk është krijuar regjistri i riskut dhe nuk është krijuar strategjia e menaxhimit të riskut. Mbetet problematikë menaxhimi i riskut, pasi nuk janë përcaktuar qartë proceset e punës dhe mbi bazën e proceseve të punës të analizohet risku si dhe të përcaktohen hapat konkret në eliminimin e plotë të tij.

“Aktivitetet e Kontrollit”

-Bashkia Kurbin nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm.

-Në Bashkinë Kurbin Drejtoria e Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin EXCEL dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Drejtoria e të Ardhurave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

-Në Bashkinë Kurbin nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

“Informimi dhe komunikimi”

-Sipas komunikimit me personat përkatës në Bashkinë Kurbin dhe verifikimit të grupit të auditimit, faqja e bashkisë është në përpunim e sipër, pra nuk sigurohet transparenca e institucionit dhe e drejta për informim.

-Për vitin 2021 nga Bashkia Kurbin (për vendimmarrje për dhënien e pasurive të paluajshme me qira, buxhetin) nuk janë kryer konsultime me publikun dhe palët e interesit.

“Monitorimi”

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore nuk lidhet me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

-Nuk është raportuar në MFE pyetësori i vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklarata e cilësisë për vitin 2021.

-Në Bashkinë Kurbin mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi Zj. R.K, Drejtore e Financës, Zj. D.M, ish-Përgjegjëse e sektorit të Auditit të Brendshëm, për detyrat që ngarkohen ndaj këtij sektori në hartimin e regjistrit të riskut dhe Zj. J.T, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;

Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Risk i shtuar për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Shkaku: Mungesa e zbatimit efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Juridike të kryejë ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim shmangien e mbivendosjes dhe përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune.

Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre.

III.2.1.1.Mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.

Në zbatim të pikave 2.1 dhe 2.2 të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njësisë AB të Bashkisë Kurbin;
2. Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2021;
4. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmoizimit të Auditit të Brendshëm;
5. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
6. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.

Në zbatim të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”, është krijuar Njësia e Auditimit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm, duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr. 1100, i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm. Kapaciteti auditues i strukturës së Njësisë së Auditit të Brendshëm të Bashkisë Kurbin, është bazuar në VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar. NJAB Kurbin ka funksionuar sipas strukturës organizative të miratuar me VKB nr.176 datë 28.12.2017, i përbërë nga dy specialist dhe një përgjegjës. Për vitin përgjegjës i NJAB është emëruar zj. D.M. Përgjatë vitit 2021, NJAB përbëhet nga dy punonjës, një përgjegjës sektori dhe një specialist.

Struktura e njësisë AB për vitin 2021

Nr	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në pune	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime të vijueshme
	Për vitin 2021							
1	D.M	P/Njesise	16.01.2018	Ek.Finance	30	4	Po	Vijuese
2	S.P	Specialiste	23.06.2021	Ek. Bachelor	0.5	0.5	Jo	Jo

Burimi: NJAB Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi i procedurave të emërimit të audituesve të NJAB është konstatuar se:

-Znj. S.P, emëruar në detyrën e auditueses me Urdhër nr. 147, datë 23.06.2021, të Kryetares së Bashkisë, është e pa pajisur me çertifikatën e audituesit, veprim ky që bie në kundërshtim me nenin nr. 11, pika 2, gërma “ c ”, e Ligjit Nr. 114/2015, “Për Auditin e Brendshëm Publik”.

Hartimi i planeve të auditimit, përgatitja dhe hartimi i programeve dhe llojet e auditimeve të ushtruara.

Sipas Planit Strategjik për periudhën objekt auditimi i nënshtrohen auditimit të plotë, Administrata e Bashkisë, Njësitë Administrative të Bashkisë Kurbin, saktësia e veprimeve financiare, prokurimet publike, sektori i taksave dhe tarifave, sektori i shërbimeve, sektori i administrimit të tokave pyjeve dhe kullotave, sektori i IMTV, funksionimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja.

Për çdo mision auditimi, nga audituesi janë hartuar programet e auditimit, të cilat janë miratuar, nga Përgjegjësi i NJAB, në bazë të Planit Vjetor.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se përgjatë vitit 2021, nga sektori i auditit të brendshëm, janë kryer gjithësej 5 auditime, si më poshtë vijon:

Viti 2021, plani vjetor i auditimeve i miratuar me nr.5830/1 prot., datë 19.10.2020, përcjellë në MFE me shkresën nr.5830/2 prot., datë 19.10.2020, ndryshuar me shkresën me nr. 6218 dhe 6218/1 prot., datë 15.10.2021, sipas të cilit janë planifikuar për t'u kryer 5 auditime dhe janë realizuar 5, pasqyruar si më poshtë:

Nr	Planifikuar	Nr	Subjekte të audituara nga NJAB	Nr	Realizimi angazhimeve të auditimit		Të përfunduar
					Financ	Kombin	
1	Drejtoria e Sherbimeve Publike, Sektori i monitorimit të investimeve dhe transportit	1	Drejtoria e Sherbimeve Publike, Sektori i monitorimit të investimeve dhe transportit	1		1	1
2	Drejtoria e Sherbimeve Publike, Sektori i emergjencave Civile, strehimit	1	Drejtoria e Sherbimeve Publike, Sektori i emergjencave Civile, strehimit	1		1	1
3	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga AB	1	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga AB	1		1	1
4	Auditim mbi detyrimet e prapambetura	1	Auditim mbi detyrimet e prapambetura	1	1		1
5	Sh.a Ujsjellës Kanalizime	1	Sh.a Ujsjellës Kanalizime	1		1	1
		5	Totali	5	1	4	5

Burimi: NJAB Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për aktivitetin e vitit 2021 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit Auditimit të Brendshëm me shkresën nr.262/2 prot., datë 11.02.2022.

-Karta e auditimit të brendshëm është përgatitur dhe miratuar nga Titullari i Bashkisë Kurbin me urdhrin nr.5720 prot., datë 20.11.2018.

Nga auditimi i raportimit për vitin 2021, rezulton se janë dhënë 56 rekomandime gjithsej, nga të cilat janë pranuar 56 prej tyre. Nga rekomandimet e pranuar janë në proces zbatimi 40 prej tyre. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

Nr	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				
		Rekomandime të shprehura në numër				
		Gjithsej në numër	Pranuar	Zbatuar	Në proces	Pa zbatuar
1	2021	56	56	13	40	3
TOTALI		56	56	13	40	3

Titulli i Gjetjes: Mbi krijimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm Publik në Bashkinë Kurbin, përgjatë periudhës 01.01.2021-31.12.2021.

Situata: Struktura e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, sa i përket numrit të punonjësve dhe certifikimit të tyre nuk ka qenë në përputhje me përcaktimet ligjore, të cituara më sipër rast pas rasti.

-Për vitin 2021 numri i punonjësve në sektorin e auditit të brendshëm nuk është sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, sipas të cilës njësia e auditit të brendshëm duhet të ketë 3 punonjës, ndërkohë kanë qenë dy të punësuar.

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

-Raportimi mbi aktivitetin vjetor 2021 të sektorit të auditimit të brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas strukturës së përcaktuar në shkronjën “ç” të nenit 14 në Ligjin nr. 114/2015, “Për Auditin e Brendshëm Publik”, pasi nuk jepet informacion për veprimet e ndërmarra nga titullari i njesisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar. Gjithashtu në raportin vjetor të aktivitetit, kreu IV.3 “Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre” nuk përmban plotësisht informacion sipas përcaktimit të bërë në formatin standard 5 “Struktura e raportit vjetor të njësive të auditimit të brendshëm” në manualin e auditimit të brendshëm.

-Nuk ka gjetur zbatim Urdhëri nr. 4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”, lidhur me dhënien e opinionit në përfundim të auditimit.

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

-Për vitin 2021, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Kurbin, të cilat kanë risk të lartë, si Drejtoria e Financës, Drejtoria e Kadastrës Urbane dhe

Menaxhimit të Aseteve, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, ku sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm “Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit”.

Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar më sipër, llojin e mangësive të identifikuara si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, ngarkohet me përgjegjësi Zj. D.M, ish Përgjegjëse e Sektorit të NJAB.

Kriteri: Shkronja “ç” në nenin 6, shkronja “c” në nenin 11, nenin 13, shkronja “ç” në nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;

-Urdhri nr. 4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016”;

-Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar;

-VKM nr. 83, datë 03.02.2016 për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik;

Ndikimi/Efekti: Nuk jep siguri të arsyeshme për objektivat e përcaktuara nga Institucioni. Nuk pasqyron aktivitetin e drejtorive me risk të lartë si Financa, Taksat apo Prokurimet.

Shkaku: Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për:

-Plotësimin e pozicioneve vakante (përgjegjës sektori dhe auditues) në NJAB Kurbin;

-Ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kurbin, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore etj, në mënyrë që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave.

III.2.2.Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjet vjetore “Për buxhetin e shtetit” të vitit 2021, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.

➤ **Cështjet e audituara sipas pikës 2 të programit:**

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2021;

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MFE, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FSHZH, Ministrinë e Linjës etj.);

2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FSHZH, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

➤ **Dokumentacioni i audituar si më poshtë:**

1. Dokumentacioni i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministrinë e Linjës;

2. Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;
3. Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit Laç për shpenzimet dhe të ardhurat;
4. Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative;
5. Shkresat përcjellëse në MFE për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve;
6. Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe saktësia e pasqyrimet të ndryshimeve në shtesa dhe pakësim me planin përfundimtar.
7. Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;
8. Dokumente të tjera mbështetëse (baza të ndryshme të dhënash në programin “Excel”, si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet, të ardhurat etj.).

Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, u konstatua se:

2.3.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2021.

Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, u konstatua se për vitin 2021 për përgatitjen e PBA 2021-2023 dhe buxhetet vjetore, që i korrespondojnë kësaj periudhe, janë miratuar me VKB nr.156, datë 14.12.2020, si dhe VKB përkatëse për miratimin e fondeve të trashëguara për çdo fillim viti buxhetor. Gjithashtu janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresën nr.11109/2 prot., datë 22.12.2020. Në vija të përgjithshme gjatë hartimit dhe miratimit të kërkesave buxhetore, janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve të reja, përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, rehabilitimin dhe investimin e infrastrukturën bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, përmirësimin e sistemit të edukimit dhe trajnimit profesional, mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Kurbin.

Fusha me prioritet në shpenzimet për investime janë konsideruar:

- a. *Infrastruktura rrugore;*
- b. *Strehim social;*
- c. *Furnizimi me ujë të pijshëm;*
- d. *Arsimi bazë përfshirë parashkollorin;*
- e. *Shërbime publike vendore;*
- f. *Investime në përmirësimin e strukturave të shërbimeve komunitare.*

PBA janë hartuar pjesërisht bazuar në Udhëzimin e MFE nr.23 datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njëjësive të Qeverisjes Vendore*”. Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (*kontratat në vazhdim*), angazhimet (*detyrimet e prapambetura sipas llojit*), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (*kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme*).

Programi i të ardhurave për vitin 2021 është bërë mbi bazën e paketës fiskale të miratuar me VKB nr.152, datë 14.12.2020.

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron

veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Buxheti total i Bashkisë Kurbin për vitin 2021 është 3,870,958 mijë lekë.

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2021, realizohen nga dy burime:

Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifatat vendore, të ardhura të tjera, donacione dhe të ardhura që trashëgohen;

Nga burimet qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitet 2021-2023, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet planifikimi sipas PBA-ve dhe buxheti vjetor.

Tabela nr.1 PBA për periudhën 2021-2023 sipas programeve ekonomike që menaxhon
Bashkia Kurbin

Nr	Kodi	Emërtimi	PBA 2021 & të	Buxheti Vjetor	Diferenca
			trashëguara	(Plani i rishikuar)	
			1	2	(1-2)
1	1110	Planifikim Menaxhim Administrim	340,280	286,745	(53,535)
2	1170	Gjendja Civile	5,470	6,270	(-800)
3	1620	Zgjedhje të Përgjithshme dhe Lokale	133	2,869	(-2,736)
4	3280	Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi	14,833	14,833	-
5	4130	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	1,680	1,680	-
6	4240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	20,774	20,774	-
7	4260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	2,844	2,844	-
8	4520	Rrjeti rrugor rural	23,263	15,838	(7,425)
9	4960	Rindërtimi	1,580,542	2,314,457	(-733,915)
10	6190	Strehimi(Bonusi Qerase)	97,321	300,120	(-202,799)
11	6260	Shërbimet publike vendore	90,700	73,117	(17,583)
12	6370	Furnizimi me ujë (Ujesjellesi)	10,500	161,400	(-150,900)
13	8140	Zhvillimi i Sportit	26,281	27,308	(-1,027)
14	8250	Trashëgimia kulturore,evente artistike..(P.Kultur)	10,227	9,272	(955)
15	9120	Arsimi baze perfshire Arsimin parashkollor	91,687	98,662	(-6,975)
16	9120	Arsimi mbështetës	13,534	10,549	(2,985)
17	9230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	15,283	15,283	-
18	10140	Kujdesi social për fëmijet (Çerdhja)	8,005	8,245	(-240)
19	10430	Kujdesi social për person e semure dhe me aftësi të kufizuara	236,137	492,184	(-256,047)
20	10910	Emergjencat Civile	0	8,508	(-8,508)
Totali i Shpenzimeve të njësisë			2,589,494	3,870,958	(-1,281,464)

Burimi: Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, mbi planifikimin buxhetor afatmesëm 2021-2023, pjesë e të cilit është edhe planifikimi për vitin buxhetor, si dhe krahasimi i tij me planin progresiv të vitit buxhetor, rezulton se diferenca ndërmjet planit fillestar dhe atij final është 1,281,464 mijë lekë. Diferencë e konsiderueshme rezulton në programin ekonomik: “Rindërtimi”, “Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara”, “Strehimi (Bonusi i Qirasë)”, “Furnizimi me Ujë (Ujesjellesi)”, “Emergjencat Civile” dhe “Arsimi Bazë përfshirë Arsimin parashkollor”. Diferencat më të konsiderueshme, pra ato në programin buxhetor “Rindërtimi”, “Bonusi i qirasë” dhe investimi në ujësjellës, janë fonde të kushtëzuara në mënyrën e përdorimit të tyre, si dhe alokimi bëhet nga niveli i qeverisjes qendrore, duke sjellë që edhe planifikimi i fondeve për këto programe buxhetore të bëhet me rezerva.

Pjesë e PBA dhe planifikimit të buxhetit vjetor, është edhe planifikimi i të ardhurave, si burim i integruar në programet buxhetore, të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Kështu për periudhën 2021-2023 Bashkia Kurbin ka planifikuar të arkëtojë të ardhura tatimore dhe jo tatimore, pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr.2 Planifikimi i të ardhurave

Përshkrimi	Plan 2021
Te ardhura tatimore	90,009
Te ardhura jotatimore	63,888
TOTAL	153,897

Burimi: Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Titulli i gjetjes: Zbatimi i Procedurave në përgatitjen e PBA 2021-2023.

Situata: Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2021-2023, u konstatua se:

-Për PBA 2021-2023 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Kurbin;

-Për PBA 2021-2023 nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik, strukturë e cila është përgjegjëse për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të integruar të planifikimit;

-Procedura e përgatitjes së PBA 2021-2023 nuk dokumentohet plotësisht, pasi në dosjen përkatëse të PBA, nuk administrohet dokumentacioni mbi kërkesat e bëra për fondet nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Kurbin, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;

-Në buxhetin vjetor të vitit 2021 nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin dhe përmirësimin e fondit pyjor.

Kriteri: Shkronja “ç” e nenit 5, pika 1 e nenit 33, pika 1 e nenit 35, pika 1 e nenit 37 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

Pika 5 e nenit 23 në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020;

Pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

i kuadrit rregullator të fushës.

Efekti: Planifikim jo i saktë dhe real i kërkesave buxhetore, si dhe mos kryerjen e investimeve në fusha të caktuara të aktivitetit të Bashkisë Kurbin.

Rëndësia: I Mesëm.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë Grupin e Menaxhimit Strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues i programeve ekonomike.

-Gjithashtu për çdo vit të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Kurbin.

2.3.2.Celja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të celura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit duke u bazuar në faktin e vitit paraardhës.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shitesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me Vendim të KB.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Kurbin dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së

Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Kurbin ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Lezhë.

Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve.

Nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, në Bashkinë Kurbin rezultoi se:

Për vitin 2021, **plani progresiv i shpenzimeve me burim financimi nga fondet për të cilat Bashkia Kurbin** ka lirshmëri në përdorimin e tyre, përbëhet nga:

-Të ardhurat e trashëguara nga viti 2020 në vlerën 101,847 mijë lekë;

-Transfertë e pakushtëzuar në vlerën 229,878 mijë lekë;

-Transfertë e pakushtëzuar sektoriale (specifike) në vlerën 164,277 mijë lekë;

-Të ardhurat e mbledhura (plani i korigjuar i tyre) në vlerën 110,498 mijë lekë;

-Transfertë nga donatorët (Projekti “Bashkitë e Forta”) në vlerën 19,108 mijë lekë;

Total për tu shpenzuar 625,608 mijë lekë.

Përgjatë vitit 2021 buxhetit të mësipërm, në mënyrë progresive i janë shtuar:

Fondi i rindërtimit në vlerën 2,272,319 mijë lekë;

Fondi nga transfertat e kushtëzuar për ndihmë ekonomike, bonus qiraje dhe investim në ujësjellës, në vlerën 753,704 mijë lekë.

Gjithësej fonde në dispozicion progresivisht, për tu shpenzuar 3,870,958 mijë lekë.

-Përgjatë vitit 2021 me vendim të Kryetarit së Bashkisë Kurbin, buxheti ka pësuar 3 **ndryshime**³ buxhetore brenda të njëjtit program buxhetor, me efekt në shtesa/pakësim të fondeve për artikull ekonomik, si dhe me vendim të Këshillit të Bashkisë ka pësuar 10 **ndryshime** ndërmjet programeve buxhetore, konkretisht:

Me VKB nr. 175 datë 26.08.2021, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve për Rikonstruksion i ambienteve ndihmëse në funksion të terreneve sportive Gurëz, në vlerën 1,500,000 lekë gjithsej. Pakësohen fondet e investimeve në objektin për Ndërtim infrastrukture Patok, në vlerën 1,500,000 lekë gjithsej.

Me VKB nr.150 datë 28.06.2021, kanë ndodhur shtesa të fondeve për kryerjen e shpenzimeve për Ndërtim (Rikonstruksion) I Kuz Milot në vlerën 1,960,000 lekë gjithsej.

Me VKB nr. 3 datë 01.11.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësim të fondeve në programin 1110-Administrim planifikim, për pagat e administratës në vlerën 3,139,000 lekë, për sigurimet shoqërore të administratës në vlerën 641,000 lekë, pakësim të fondeve për shpenzime operative në vlerën 3,780,000 lekë.

Me VKB nr. 14 datë 27.01.2021, si dhe me vendim nr. 15 datë 27.01.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësim nga fondi i emergjencave civile në vlerën 1,320,000 lekë.

Me VKB nr. 16 datë 27.01.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësim nga fondi i emergjencave civile në vlerën 600,000 lekë.

Me VKB nr. 24 datë 26.02.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësim nga fondi rezervë në vlerën 220,000 lekë.

³Pasqyruar në tabelën nr.3 Kapitulli V Aneksë-Aneksi nr.1;

Me VKB nr. 38 datë 23.04.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësim për kryerjen e shpenzimeve për investime në vlerën 459,472 lekë.

Me VKB nr. 41 datë 23.04.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësime për kryerjen e shpenzimeve për oponencë teknike në vlerën 4,537,079 lekë.

Me VKB nr. 57, 58, dhe 59 datë 24.06.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësim nga fondi i emergjencave civile në vlerën 850,000 lekë.

Me VKB nr. 76 datë 26.07.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësim nga fondi rezervë në vlerën 300,000 lekë.

Me VKB nr. 81 datë 30.08.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësime për kryerjen e shpenzimeve për sigurimet shoqërore në vlerën 2,277,913 lekë.

Me VKB nr.98 datë 03.11.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësime për kryerjen e shpenzimeve për shtyrje afati të ambjentëve të marra me qera nga Bashkia në vlerën 390,000 lekë.

Me VKB nr. 116 datë 23.12.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësime për kryerjen e shpenzimeve për dhënie ndihme për familjet në nevojë në vlerën 500,000 lekë.

-Mbështetur në përcaktimin e bërë në pikën 149 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, në gjykimin e grupit të auditimit ndryshimet buxhetore përgjatë vitit buxhetor, tregojnë për një performancë jo të mirë në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Tabela nr.4 Plani progresiv dhe Realizimi i buxhetit vjetor në nivel programi ekonomik-2021

Nr	Kodi	Emërtimi	Buxheti Vjetor 2021 (Plani i rishikuar)	Realizimi	Në %
1	1110	Planifikim Menaxhim Administrim	286,745	242,099	84%
2	1170	Gjëndja Civile	6,270	5,314	85%
3	1620	Zgjedhje të Përgjithshme dhe Lokale	2,869	2,664	93%
4	3280	Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi	14,833	14,539	98%
5	4130	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	1,680	1,537	91%
6	4240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	20,774	19,447	94%
7	4260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	2,844	1,894	67%
8	4520	Rrjeti rrugor rural	15,838	14,710	93%
9	4960	Rindërtimi	2,314,457	965,438	42%
10	6190	Strehimi(Bonusi Qerase)	300,120	299,274	100%
11	6260	Shërbimet publike vendore	73,117	67,627	92%
12	6370	Furnizimi me ujë (Ujesjellesi)	161,400	159,191	99%
13	8140	Zhvillimi i Sportit	27,308	27,260	100%
14	8250	Trashëgimia kulturore,evente artistike..(P.Kultur)	9,272	8,021	87%
15	9120	Arsimi baze perفشire Arsimin parashkollor	98,662	87,406	89%
16	9120	Arsimi mbështetës	10,549	5,889	56%
17	9230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	15,283	12,513	82%
18	10140	Kujdesi social për femijet (Çerdhja)	8,245	8,168	99%
29	10430	Kujdesi social për person e semure dhe me aftësi te kufizuar	492,184	490,036	100%
20	10910	Emergjencat Civile	8,508	8,508	100%
Totali i Shpenzimeve			3,870,958	2,441,535	63%

Burimi: Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se:

Për vitin 2021 realizimi i buxhetit është në nivelin 63%, si dhe programi ekonomik që paraqitet me realizimi më të lartë është “Strehimi (Bonus Qeraje), Zhvillimi i Sportit, Kujdesi social për persona të sëmurë dhe me aftësi të kufizuar dhe Emergjencat Civile”;

Programi me realizimin më të ulët është “Rindërtimi dhe Arsimi Mbështetës”.

2.3.3.Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Laç, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar në përgjithësi janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Laç, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuar me Vendim të KB ose të diktuar nga Transferta e deleguar nga pushteti qendror.


Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për periudhën 2021-2023, referuar akt-rekomandimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Tabela nr.5 Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik – viti 2021

Art.	Emertimi	Buxheti Vjetor	Fakti	%
600	Paga	238,312	230,712	97%
601	Sigurime Shoqërore	47,099	38,028	81%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	153,629	133,235	87%
604	Transferta Korente të Brendshme	2,335,980	986,974	42%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	800,955	796,945	99%
609	Trans. E Brendshme	6,766	0	0
230	Kapitale të Trupëzuara	300	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	287,915	255,640	89%
	TOTAL	3,870,958	2,441,535	63%

Burimi: Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Grafiku nr.1 Pesha e secilit artikull ndaj totalit



Burimi: Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se për vitin 2021 realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik është 63%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 606 “Transferta për buxhetin familjar dhe Individ”, ku përfshihen ndihma ekonomike, duke vijuar me shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, ndjekur nga kapitale të trupëzuara si dhe realizimin më të ulët e kanë transferta korente të brendshme.

➤ **Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit.**

Tabela nr.6. Buxheti sipas burimeve të financimit 2021

Art.	Emertimi	Fakt 2021			
		Gjitheshej	Tr.Pakushtezuar + te ardhurat e veta	Tr. Sektoriale	Tr.e Kushtezuar
230+231	Investime	255,640	96,449	0	159,191
600+601	Paga + Sigurime Shoqërore	268,739	131,725	127,661	9,353
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	131,257	111,853	19,242	162
604	Transferta të brendshme	22,642	22,434	208	
606	Transferta tek të tretë (PAK, bonus qiraje, emergjenca civile)	797,818	-	-	797,818
	Rindërtimi	965,438	-	-	-
	Total	2,441,534	362,461	147,111	966,524

Burimi: Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

-Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se fondet e shpenzuara nga transferta e kushtëzuar kanë peshën më të lartë në krahasim me fondet e shpenzuara nga burimet e tjera ekonomike. Kjo situatë vjen si rrjedhojë e fondeve të shpenzuara për bonusin e qirasë (për familjet e prekura nga dëmet e tërmetit) në vlerën 299,274 mijë lekë, ndihma ekonomike në vlerën 490,036 mijë lekë dhe investimi për ndërtimin e ujësjellësit për Qytetin e Laçit në vlerën 159,191 mijë lekë. Në vijim janë fondet e shpenzuara për rindërtimin (investime të kryera në objekte publike, private, fasadat e pallateve) në vlerën 965,438 mijë lekë.

Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat vendore.

-Buxheti nga transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat vendore nga taksat dhe tarifatat për vitin 2021 është realizuar në vlerën 362,461 mijë lekë ose 15% e totalit të fondeve të shpenzuara, e ndarë në 247,846 mijë lekë nga transferta e pakushtëzuar dhe 114,615 mijë lekë nga të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifatat vendore.

Kryesisht të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifatat e veta vendore janë shpenzuar për likuidimin e pagave dhe shtesave mbi pagë (sigurime shoqërore dhe shëndetësore) në masën 41%, duke vijuar me shpenzime për investime në masën 31%, blerje të mallrave dhe shërbimeve në masën 26%, si dhe 2% për transferta të ndryshme.

Transferta e kushtëzuar.

-Buxheti nga transferta e kushtëzuar për vitin 2021 është realizuar në vlerën 966,524 mijë lekë, ose 40 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2021, ku peshën kryesore brenda transfertës së kushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për transferta.

Transferta specifike.

-Buxheti nga transferta specifike për vitin 2021 është realizuar në vlerën 147,111 mijë lekë, ose 6 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2021, ku peshën kryesore brenda transfertës specifike, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe sigurime shoqërore.

Fondet e rindërtimit.

-Fondet e rindërtimit janë realizuar në vlerën 965,438 mijë lekë, nga 2,314,457 mijë lekë të planifikuara gjithësej, ose në masën 42%. Në krahasim me fondet total të shpenzuara për vitin 2021, fondet e rindërtimit zënë 40% të tyre. Në brendësi të fondeve të rindërtimit, peshën kryesore ose 63% të tyre e zënë fonde të shpenzuara për investime, si rindërtimi i godinës së bashkisë, rindërtim i shkollës “Gjon Gjonaj”, shëmbje e objekteve të pabanueshme etj.

➤ **Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës.**

Me miratimin e buxhetit për vitin 2021 është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/dhe kontigjencës, ku për vitin 2021 është planifikuar në masën 14,373 mijë lekë i ndarë në fond rezervë në shumën 7,607 mijë lekë dhe fond i kontigjencës në shumën 6,766 mijë lekë. Sipas të dhënave nga Bashkia Kurbin nga fondi rezervë janë shpenzuar 7,391 mijë lekë ndërsa nga fondi kontigjencës nuk është përdorur asnjë vlerë.

➤ **Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile.**

Nga Bashkia Kurbin është krijuar edhe fondi për emergjencat civile, ku për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 8,508 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 8,508 mijë lekë, për mbulimin e shpenzimeve për rikonstruksionin e banesave sociale në pronësi të Bashkisë Kurbin.

-Totali i fondit rezervë dhe kontigjencës është brenda limitit 3%, përjashtuar transfertën e kushtëzuar.

➤ **Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Kurbin.**

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se Bashkia Kurbin përgjatë periudhës 2021 nuk ka marrë nuk ka dhënë asnjë subvencion.

➤ **Realizimi i Investimeve.**

Titulli gjetjes: Planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli.

Situata: Grupi i KLSH konstaton se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet jo të mira në vitin 2021, konkretisht në masën 89 %. Kjo diferencë është krijuar si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Kurbin në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Kriteri: Shkronja “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Pika 24 dhe 25 në nenin 3, neni 47 në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

Shkaku: Planifikim i procedurave të prokurimeve për mallra/shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke i planifikuar ato në raport me planin dhe jo me faktin e të ardhurave të vitit të mëparshëm.

Efekti: Mos realizim i investimeve të planifikuara.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigojë plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

➤ **Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 muajor në Këshillin Bashkiak.**

Në zbatim të nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 dt.30.07.2018 “Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 44⁴, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, rezulton se për vitin 2021 raportet periodike dhe ai vjetor për monitorimin e zbatimit të buxhetit, janë realizuar dhe përcjellë në Këshillin Bashkiak, si dhe Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra më sipër.

2.3.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Kurbin, rezulton se është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për çdo vit buxhetor, si dhe në fund të vitit 2021 janë raportuar në Këshillin Bashkiak dhe MFE, pra jo raportim periodik të tyre.

Me fondet buxhetore të vitit 2021, përgjithësisht janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale. Sipas raportimit të kryer në strukturat/institucionet e mësipërme, shuma e detyrimit përgjatë periudhës 01.01.2021-31.12.2021 ka ardhur duke u ulur. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet zhvillimi i shumës së detyrimit përgjatë vitit 2021.

Tabela nr.7 Detyrimet e prapambetura për periudhën 2021

Detyrime e NJQV 2021	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2020	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2021	Total detyrime	Shlyerja gjate 2021	Mbetja në fund të vitit 2021
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
Investime	40,717,311	0	40,717,311	24,511,200	16,206,111
Vendime gjyqësore	12,161,158	2,415,937	14,577,095	10,915,937	3,661,158
601	2,687,805	0	2,687,805	0	2,687,805
602	21,544,615	1,932,424	23,477,039	3,142,366	20,334,673
Tjera ...	10,929,505	0	10,929,505	6,213,874	4,715,631
Total Detyrime	88,040,394	4,348,361	92,388,755	44,783,377	47,605,378
Gjendja e llogarisë 520 në fund të vitit 2021 – garancitë e kontratave					1,441,211,357

Burimi: Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela e mësipërme rezulton se stoku i detyrimeve të prapambetura për Bashkinë Kurbin në fund të vitit 2021 është në vlerën **47,605 mijë lekë** (1344 fatura gjithësej)⁵, nga të cilat 237 fatura të palikujduara janë krijuar në vitin 2021 gjithësej në vlerën **1,552 mijë lekë**.

⁴ Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim te këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport paraqitet në këshill jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

⁵ Lista analitike e faturave të palikujduara dhe burimi i likuidimit të tyre pasqyrohet në kapitullin Anekse – Aneksi nr.1 - Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Faturat e mësipërme janë parashikuar për t'u likuajduar nëpërmjet fondeve nga transfertat e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore.

Në fund të vitit 2021 të ardhurat e trashëguara për vitin 2022 (pa përfshirë fondet e rindërtimit) janë në vlerën 205,916 mijë lekë, ose detyrimet e prapambetura zënë 23% të tyre, ç'ka do të thotë se Bashkia Kurbin mund të likuajdojë detyrimet e prapambetura.

-Gjithashtu sa i përket respektimit të rradhës së likuajdimit të detyrimeve të prapambetura (pra fatura e parë likuajdohet më parë), u konstatua se nuk është respektuar ky kriter ligjor, ilustruar me disa raste:

Konkretisht për rastin e detyrimit ndaj subjektit:

-S. shpk faturë e datës 17.08.2020 në vlerën 10,000,000 lekë, likuajduar më datë 12.04.2021, ndërkohë që deri më datë 12.04.2021 janë likuajduar fatura të mbërritura më vonë se fatura e subjektit të mësipërm, si p.sh., L. – 14 për pastrimin e Njesisë Administrative Mamurras për muajin nëntor 2020, faturë e datës 30.11.2020, likuajduar më datë 23.02.2021; B. për pastrimin e qytetit Kurbin muajit tetor 2020, faturë e datës 03.11.2020 likuajduar më datë 23.02.2021.

-E njëjta situatë si më sipër rezulton edhe për subjektin E. D. (Rrethimi I shkollës Dema) Mamurras, faturë e datës 24.06.2019, likuajduar më datë 25.11.2021; E. D.i (Riparime në shkollën) Sanxhak, faturë e datës 01.07.2019, likuajduar 25.11.2021.

-Likuidim me vonesë i faturave në tejkallim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuajditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i rradhës në likuajdimin e detyrimeve të prapambetura.

Titulli i gjetjes: Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura dhe raportimi i tij në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë.

Situata: Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2021, përcjellë në MFE me shkresën nr.1231/1 prot., datë 28.02.2022, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Kurbin ndaj palëve të treta raportuar në MFE është në vlerën **47,605,378**, e cila përbëhet nga detyrime për shpenzime korrente, shpenzime kapitale dhe vendime gjyqësore, pasqyruar në tabelën më poshtë:

Tabela nr.8 Situata e vështirësisë financiare

Viti 2021						
Nr	Emërtimi	Stoku në vlerë Bashkia	Stoku sipas G.A	Diferenca	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0				
a	Hua afatgjatë	0				
a,1	Principali					
a,2	Interesi					
b	Hua afatshkurtër	0				
b,1	Hua					
b,2	Overdrafte					
b,3	Kredi të furnitorëve					
II	Detyrime (a+b+c)	47,605,378	48,101,426			
a	Shpenzime korrente	28,749,709	29,245,757			
a,1	Mallra dhe shërbime	20,387,426	20,883,474			
a,2	Paga dhe sigurime	2,687,805	2,687,805			
a,3	Të tjera	5,674,478	5,674,478			
	Shpronësime					
b	Shpenzime kapitale	16,210,911	16,210,911			
b,1	Institucione buxhetore					
b,2	Subjekte private	16,210,911	16,210,911			
c	Vendime gjyqësore	2,644,758	2,644,758			
c,1	Marrëdhënie pune	2,644,758	2,644,758			
c,2	Mallra dhe shërbime					
c,3	Investime					
c,4	Të tjera					
III	Totali (I+II)	47,605,378	48,101,426	496,048	657,168,031	7.32%

Burimi: Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sa më sipër vlera e raportuar nga Bashkia Kurbin me vlerën e evidentuar nga grupi i auditimit, që duhej të raportohet në MFE kanë një diferencë të lehtë prej 496,048 lekë, pa ndryshuar në thelb situatën normale të gjrëndjes financiare në të cilën ndodhet Bashkia Kurbin.

Kriteri: Udhëzimi nr.26, datë 27.09.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësisë financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

Kreu XI pika 1, neni 56 në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

Udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar”.

Shkak: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Efekt: Mospasqyrimi i saktë i stokut të detyrimeve të prapambetura dhe mos ekzekutimi i plotë i fondeve buxhetore, me qëllim eliminimin e detyrimeve të prapambetura.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin dhe Drejtorja e Financës, të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta. -Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe likuidimin e tyre gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve në dispozicion.

Titulli i gjetjes: Efektet negative në buxhet si rezultat i likuidimit të vendimeve gjyqësore.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura rezulton se Bashkia Kurbin për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2021, në 6 raste ka shpenzuar vlerën 10,915,937 lekë, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Nga praktikat e mësipërme të likuidimit u përzgjedhën për auditim mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit financiar dhe ligjor, 6 prej tyre. Nga kryqëzimi i të dhënave mbi detyrimet e Bashkisë Kurbin ndaj palëve të treta, kryesisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore, konstatohet se:

1.Si rrjedhojë e Vendimit nr.4108, datë 15.11.2018 të Gjykatës së Apelit, ndaj Bashkisë Kurbin është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit “R.R” në vlerën 2,360,958 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2021 është kryer vetëm një likuidim pjesor në vlerën 500,000 lekë, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Bashkia Kurbin i detyrohet subjektit R.R në vlerën 1,860,958, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

2.Si rrjedhojë e Vendimit nr.2921, datë 12.07.2018 të Gjykatës së Apelit, është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit “T.M”, në vlerën 1,662,600 lekë.

3.Nga shqyrtimi i ditarit të bankës mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës pa arsye ligjore të (T.M), rezulton se përgjatë vitit 2021 nuk është kryer asnjë likuidim i plot/pjesore, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

4.Si rrjedhojë e Vendimit nr.2435, datë 08.07.2019 të Gjykata së Shkallës Parë Kurbin, është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit “F.N” në vlerën 93,600 lekë.

5.Nga shqyrtimi i ditarit të bankës mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës pa arsye ligjore (F.N), rezulton se përgjatë vitit 2021 nuk është kryer asnjë likuidim i plot/pjesore, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

6.Si rrjedhojë e Vendimit nr.437, datë 24.02.2020 të Gjykatës së Apelit, është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit “M.M” në vlerën 44,000 lekë.

-Nga shqyrtimi i ditarit të bankës mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës pa arsye ligjore (M.M), rezulton se përgjatë vitit 2021 nuk është kryer

asnjë likujdim i plot/pjesore, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, efizienzë dhe efektivitet.

-Gjithashtu konstatohet për likujdimet e subjekteve të mësipërme janë nxjerrë urdhërat përkatës nga titullari i institucionit, por konstatohet se në urdhrin e likujdimit nuk është nxjerrë edhe përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna, moslikujdimit në kohë të detyrimit pa krijuar shpenzime të përmbarimit) ka krijuar detyrime ndaj bashkisë.

Kriteri: Pika 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit rregulator të fushës.

Efekt: Krijimi i detyrimeve të prapambetura, të cilat ndikojnë negativisht në buxhetin e Bashkisë Kurbin.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin dhe Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme, që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun dhe likujdimin e plotë të detyrimeve të prapambetura nga vendimet gjyqësore.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

-Shpronësimet për interes publik.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës rezultoi se përgjatë vitit 2021 nuk ka pasur detyrime për shpronësime të krijuara në vitin 2021 apo nga vite të mëparshme dhe të palikujduara.

2.3.5.Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FSHZH/Ministritë e linjës, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Financës për vitin 2021, në lidhje me investimet publike, rezultoi se nuk ka financim projektsh nga FSHZH. Gjatë vitit 2021 Bashkia Kurbin ka marrë financime nga fondi i rindërtimit gjithësej 919,928,341 lekë, ndarë si më poshtë vijon:

- a. 360,194,728 lekë për financimin e rikonstruksionit ose riparimit të mjediseve në bashkpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Kurbin;
- b. 296,969,254 lekë për rindërtimin e godinës së Bashkisë Kurbin, Njësia Administrative Laç Bashkia Kurbin;
- c. 65,164,800 lekë për financimin e shembjeve të objekteve të pabanueshme të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe transportimin e materialeve të dala nga shembja e tyre;
- ç. 199,602,139 lekë për financimin e rindërtimit të objektit arsimor, shkolla 9-vjeçare “Gjon Gjonaj”, Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin.

Nr	Objekti i Prokurimit	Vlera e kontratës	Data e lidhjes se kontrates	Data e perfundimit kontrates	Likujduar	Mbetur
1	Rikonstruks Riparim Mjediseve të Përbash Pallati F1	355,777,414	15-01-2021	15-10-2021	355,777,414	-
2	Mbikq e Rikonst Fasadat F1	3,650,000			3,650,000	-
3	Rindërtim Godine e Bashkisë Laç	293,035,000	01-03-2021	01-12-2021	182,073,206	110,961,794
4	Mbikqyrje e Ndërtim Godinës Bashkia Laç	3,200,000			1,200,000	2,000,000
5	Shembje e objekteve të pabanueshme, të dëmtuara nga Tërmeti i dt. 26.11.2019 dhe transporti i mbeturinave	65,164,800	04-12-2020	04-01-2021	65,164,800	-
6	Rindërtim Shkolla Gjon Gjonaj Laç	196,851,127	19-02-2021	19-07-2021	5,171,910	191,679,217
7	Mbikqyrje e Rindërtimi i Shkollës Gjon Gjonaj	2,250,000			-	2,250,000
	Total				613,037,330	193,929,217

Burimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Nga informacioni i mësipërm, mbi alokimin e fondeve (të cilat janë bërë shtesë në buxhetin e Bashkisë Kurbin nëpërmjet VKB-ve), lidhjen e kontratave dhe përfundimin e punimeve, rezulton se për 2 projekte të financuara nga fondi i rindërtimit sipas alokimit të bërë me VKM përkatëse, megjithëse kanë përfunduar në vitin 2021 nuk janë likuajduar plotësisht, si më poshtë vijon:

-Rikonstrukcionin e shkollës 9-vjeçare “Gjon Gjonaj” - mbetur pa likuajduar 191,679,217 lekë;
-Mbikqyrje për rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Gjon Gjonaj” - mbetur pa likuajduar 2,250,000 lekë;

Sa i përket fondeve të alokuara nga Transferata e Pakushtëzuar, Ministria e Linjës dhe nga të ardhurat e veta për vitin 2021, rezulton se janë financuar 6 projekte investimi me supervizimet e tyre me vlerë kontrate 577,401,496 lekë, pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr.9 Fonde të deleguara për vitin 2021 nga Ministria e Linjës për investime si dhe likuajdimi i tyre

Nr	Objekti i Prokurimit	Vlera kontratës	Shpërndarja e Investimeve			Burimi i Financimit			Likujdimi	Mbetur 31.12.2021
			2020	2021	2022	Të Ardhura	Transf. Pakushtëzu	Ministria e Linjës		
1	Rehabilitim pallatesh dhe fasadat Mamurras	34,476,012	-	41,371,215	-	8,082,303	33,288,912	-	41,371,215	-
2	Rikonstrukcion Shkolla 9-Vjeçare "Mark Trokthi"	81,182,297	58,703,61	15,000,000	23,715,144	4,580,180	24,711,634	68,126,942	73,703,612	23,715,144
3	Asfaltim, Rruga St. Trenit F.Mamurras (Tarzhi)	14,874,204	-	17,849,045	-	1,772,642	16,076,403	-	17,849,045	-
4	Asfaltim Rruga e Varrezave, Lagja Sanxhak	20,761,687	-	11,192,468	13,721,556	24,914,024	-	-	11,192,468	13,721,556
5	Ndricim Rrugore Lac	7,966,463	-	9,559,756	-	-	9,559,756	-	9,559,756	-
6	Ndertim të brendshëm dhe të jashtëm të ujësjellësit Lac	414,559,500	239,870,006	157,791,010	50,000,000	-	-	497,471,400	397,661,016	99,810,384
7	Mbikqyrje e punimeve të Ujësjellësit LAC	3,581,333	1,000,000	1,400,000	900,000	-	-	4,297,600	3,300,000	997,600
	TOTAL	577,401,496	299,573,618	254,163,494	88,336,700	39,349,149	83,636,705	501,769,000	554,637,112	100,807,984

Burimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se në fund të vitit 2021 disa prej kontratave të investimeve nuk janë likuajduar plotësisht, kjo për arsye se 3 prej tyre janë me burim financimi nga Ministria e linjës, për të cilat nuk janë akorduar plotësisht fondet. Gjithashtu rezulton se një kontratë nuk është likuajduar plotësisht, për arsye të mungesës së fondeve në Bashkinë Kurbin.

-Kontratat e mësipërme janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Laç dhe të shtrira në kohë sipas financimit e ndarë në tre vitet sipas shkresës përcjellëse nga Ministria e linjës . Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

Konkluzion i përgjithshëm:

-Buxheti i Bashkisë Kurbin dhe PBA, në përgjithësi është miratuar në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore të ligjit të buxhetit për vitin 2021. Kanë ndodhur ndryshime në buxhetet fillestare (shtesa/pakësimi), të cilat në çdo rast janë miratuar me VKB.

-Për PBA 2021-2023 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxhetit vjetor, nuk administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Kurbin, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;

-Nga shqyrtimi i ditarit të bankës mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës pa shkaqe ligjore, rezulton se përgjatë vitit 2021 janë kryer likuidime të plota/pjesore, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet në vlerën 10,915,937 lekë.

-Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqëruar në Degën e Thesarit Kurbin, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2021, ky afat nuk është respektuar në 237 fatura për shpenzime për investime dhe shpenzime korrente në vlerën 1,552,439 lekë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi, zj.R.K me funksion Drejtore e Financës.

2.3.6.Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

Në zbatim të pikës II.2, nënpika 2.6, të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

▪ Dokumentacioni i shqyrtuar për auditimin e të ardhurave.

Në auditimin e kryer mbi burimin realizimin e të ardhurave dhe përdorimi i tyre, u audituan dokumentacioni i paraqitur nga zyra e taksave dhe tarifave vendore si: Evidencat analitike të llogarive debitorë për taksat dhe tarifave vendore, akt rakordimi me degën e thesarit për realizimin e të ardhurave nga tatim taksat vendore, evidencat mbi gjendjen e debitorëve për taksat dhe tarifave vendore për subjektet dhe për detyrimet familjare, regjistrat e bizneseve, , procedura e lëshimit të liçencave dhe autorizimeve, si dhe dokumente mbi procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, Vendimet e Këshillit të Bashkisë për paketën fiskale.

▪ Baza ligjore

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKB-në nr.152, datë 14/12/2020, konfirmuar dhe nga Prefekti i Qarkut Lezhë, “Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kurbin” ku përfshin dhe ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.24 datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 9975, datë 28.07 .2008 "Për Taksat Kornbëtare", i ndryshuar. Përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, u auditua dokumentacioni i paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, për periudhën 01.01.2021 deri në 31.12.2021.

▪ Struktura e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore

Në Bashkinë Kurbin, për vitin 2021, numri i përgjithshëm i punonjësve të Drejtorisë të Ardhurave Vendore ka në përbërje 16 punonjës, të ndarë në 2 sektorë, konkretisht 1 Drejtor, 1 Përgjegjës i Sektorit dhe 5 specialistë, Kryeinspektori dhe 8 inspektorë.

Krahas strukturës në qendër, ka dhe nga 1 specialist taksash në cdo Njësi Administrative, i cili mbulon funksionin për taksat familjare (taksë ndërtese, truall, taksën e tokës bujqësore, tarifa etj).

▪ Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave

Bashkia Kurbin krijon të ardhura nga këto burime: Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, taksa e ndikimit të infrastrukturës, taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore, taksa mbi truallin, taksa për tabelat dhe reklamat, taksa e biznesit privat taksa të tjera, tarifa për shërbime administrative, tarifa për zënien e hapësirës publike dhe të fasadave, tarifa të shërbimeve publike vendore (mbetje, gjelbërim etj.)

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2021 sipas planit ka qenë **153,897** mijë lekë.

Për vitin 2021, ka pasur realizim të planit të përgjithshëm të ardhurave të planifikuara, në masën 71.8% ose 110,498 mijë lekë si dhe një mosrealizim në masën 28.2% ose në vlerën kë

43,399 mijë lekë, të rakorduara me thesarin. Planifikimi dhe realizimi I të ardhurave për vitin 2021, referuar akt-rakordimve me degën e Thesarit Kurbin paraqitet në tabelën e mëposhtme.

- Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave sipas llojeve të taksave, tarifave dhe të ardhurave të tjera, në 000/ lekë.

Tabela nr.10 Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave – viti 2021

Nr.	Emërtimi	2021		
		Plan	Fakt	%
1	Tatim mbi te ardhurat personale	0	13,135	
2	Tatim i Thjeshtuar i Biznesit	0	1,917	
3	Taksa mbi token bujqesore	19,369	240	1
4	Taksa mbi Ndërtesen	12,796	4,791	37.4
5	Taksa mbi kalimin pasurise se paluajtshme ZVRRP	1,370	253	18
6	Takse e zenies se hapësires publike	0	0	0
7	Taksa e ndikimit në infrastrukturë ndërtimet e reja	20,100	19,312	96
8	Taksa per fjetjen në hotel	0	0	0
9	Taksa per therjen e bagëtimeve	300	45	15
10	Takse per Reklamata	2,032	1,210	60
11	Taksa e Tabeles	636	396	62
12	Taksa per shfrytezimin e lendeve drusore	0	0	0
13	Taksa për truallin	4,373	2,538	58
14	Taksa e përvitshme e automjeteve	28,600	29,605	104
15	Te ardhurat nga Renta Minerare	85	0	0
TOTALI I:		89,661	73,442	82
1	Të ardhura nga Qira për Tokën	0	0	
2	Të ardhura nga Qira për Troje	0	0	
3	Të ardhura nga Qira për Ndërtesat	0	0	
4	Të ardhura nga ndërmarrjet e tjera	37	29	78
5	Të ardhura nga vërtetime e shërbime	895	221	25
6	Të ardhura për dhënie leje ushtrim aktiviteti (kontrat pyje)	2,330	0	
7	Tarifë arsimore	0	0	
8	Tarifë pastrimi dhe higjienë	13,372	6,645	50
9	Kontribute mirëmbajtje (Amortizim rruge)	0	0	
10	Tarifë shërbimi (a+b) (gjelb.+ndriç.)	6,751	2,884	43
11	Tarifë shërbime funerale	0	0	
12	Të ardhura nga kopshtet	0	0	
13	Të ardhura nga çerdhet	1,200	1,148	96
14	Të ardhura nga qendrat e formimit profesional	0	0	
15	Të ardhura nga parkingu	210	37	18
16	Të ardhura nga shërbimi MNZ	368	61	17
17	Sporti , biletat	0	0	
18	Të tjera Gjoha (a+b) (d,t,u)	21,048	13,839	65.7
19	Tarifë për regjistrimin e nje vendbanimi te ri	0	0	
20	Tarifë ujitje/ vaditje toke	0	0	
21	Leje karburanti	16,200	2,400	15
22	Mbledhje gjethe dafine/shfrytezim toke	0	0	
23	Sekuestre dhe Zhdemtime	150	0	
24	Takse linje transporti	1,675	1,257	75
25	Sponsorizime (OJQ)	0	8,085	
26	Pulla Gjendja Civile (pjesa takuese e bashkisë për realizimin)	0	450	
TOTALI II:		64,236	37,056	56.4
TOTALI I + II :		153,897	110,498	71.8

Burimi: DPAV Kurbin

- **Tatimi i thjeshtuar mbi biznesin** është realizuar.
- **Taksa e regjistrimit të mjeteve** është realizuar në masën 104% dhe për planifikim më të saktë është kërkuar database nga DRTRR Lezhë për të gjitha automjetet që figurojnë në Bashkinë Kurbin.
- **Taksa e ndërtesës** është realizuar në masën 62,6 % e planit dhe mos realizim 37.4 %.
- **Taksa e ndikimit në infrastrukturë** ndërtimet e reja, dhe ato në proces legalizimi, është realizuar në masën 96 %. Mosrealizimi në 4 % i taksës së ndikimit në infrastrukturë është së bashku me legalizimet dhe taksa për ndërtimet e reja. Për legalizimet janë njoftuar zyrtarisht qytetarët për çdo dosje të ardhur nga ASHK Lezhë për të bërë pagesën. Për këtë arsye nga zyra e taksave u janë dërguar të gjithë subjekteve debitorë të identifikuar, njoftime për pagesë. Janë afishuar listat emërore të personave debitorë, pranë Bashkisë Kurbin. Janë dërguar lista emerore tek Agjensia Shtetërore e Kadastrës Lezhë etj, për ti vënë në dijeni lidhur me detyrimin me qëllim arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Taksa për ndërtesat e legalizuara

nër vite, nuk është realizuar pasi ASHK ka pajisur me dokumentacion pronarët e tyre pa u paguar kjo taksë në Bashki.

- **Taksa e tokës bujqësore** është realizuar vetëm në masën 1 % të planit të parashikuar, me mos realizim në 99%. Nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore haset vështirësi në vjeljen e taksës së tokës bujqësore ndaj fermerëve për shkak të konflikteve të pronësisë ndërmjet familjeve që pretendojnë mbi pronën e tyre dhe mos organizimit të duhur të punës për vjeljen e taksës. Kjo sjell të ardhura të munguara nga viti në vit në buxhetin e Bashkisë.

Debitor Toka bujqësore 2021.

Tabela nr.11 Debitor për taksën e tokës bujqësore

Debitor toka bujqësore 2021					
Njësitë administrative	Debitor të trashëguar deri në fillim të vitit 2021 (2011-2020)	Debitorë krijuar në vitin 2021 (Lekë)			Debia Progressive
		Familje me tokë bujqësore	Familje debitore (Nr)	Familje debitore 2021 (vlerë)	
LAÇ	17,158,320	959	920	2,920,267	20,078,587
MAMURRAS	27,573,648	3163	3134	7,283,134	34,856,782
MILOT	15,193,982	3029	2961	3,332,754	18,526,736
FUSHË-KUQE	14,977,959	1716	1714	5,048,765	20,026,724
TOTALI	74,903,909	8,867	8,729	18,584,920	93,488,829

- **Taksa e tabelës** është realizuar ne masën 62% e planit.
- **Taksë mbi truallin** është realizuar ne 58 % e planit. Kjo taksë është për truallin funksional përjashtuar trualli njollë nën ndërtesë.
- **Taksë Hoteli** nuk është planifikuar për subjektet që kanë hotele dhe nuk është realizuar plani.
- **Tarifa e pastrimit dhe higjenës** është realizuar në masen 50 %. Kjo tarifë sipas paketës fiskale për Njësitë Administrative ka ndryshim tarife nga qyteti. Realizimi në këtë masë ka ardhur nga institucionet dhe bizneset por jo nga familjarët.
- **Tarifën e shërbimit veterinar** e paguan subjekti i thertores, realizuar në masën 15 % të planit.
- **Tarifë përdorimi**, leje karburanti, nuk është realizuar plani. Është parashikuar vlera 16,200 mijë lekë dhe është realizuar arkëtimi vetëm 2,700 mijë lekë ose 15% e planit.
- **Tarifë për leje transporti** është realizuar në masën 75% e planit, për subjektet e transportit që pajisen nga Bashkia me licensë e certifikatë transporti.
- **Tarifë parkimi** është realizuar në masën 18 %.
- **Tarifë nga vërtetimet**, si vërtetim për detyrime ose jo, ushtrim aktiviteti ose jo është realizuar në masën 25% pasi shumë vërtetime merren dhe online në portalin e-albania.
- **Tarifë për fondin pyjor** nuk është realizuar.
- **Tarifa për zënien e hapësirave publike** nuk është realizuar.
- **Tarifë për librat e udhëtimit** nuk është realizuar, sepse blloqet nuk janë tërhequr nga subjektet e transportit rrethqytetas pasi lëvizjet jashtë rrethit kanë qenë të pakta ose aspak.
- **Të ardhura nga cerdhet** etj janë realizuar në masën 96 % të planit.
- **Të ardhurat nga MKZ** janë realizuar në masën 17% e planit.
- **Të ardhura nga Renta Minerare** janë parashikuar në vlerë 85 mijë lekë dhe nuk janë realizuar për shkak të pezullimit të aktivitetit.
- **Gjoha** (interesa, kamatë vonesat) nuk janë realizuar ndonëse janë llogaritur sipas ligjit në fuqi mbas afatit zyrtar llogaritur 0.06 % në ditë mbi detyrimin deri me 365 ditë, dhe për kontratat ashtu si përcaktohet 0.01 % në ditë jo më shume se 10 % e vlerës.
- Përsa i përket përdorimit të ardhurave, janë përdorur sipas planifikimit buxhetor, ndërsa pjesa e papërdorur është mbartur në buxhetin e vitit pasardhës.

▪ **Evidentimi dhe mbajtja e regjistrit të tatimpaguesve**

Për qytetin dhe çdo njësi administrative është krijuar në mënyrë elektronike regjistri për taksat dhe tarifat vendore për subjektet private dhe familjarët, njësitë administrative (Laç, Milot, Mamurras, Fushëkuqe si dhe për Bashkinë Kurbin, si më poshtë:

Për subjektet private në qytet dhe në njësi administrative, administrohen nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore në format exel. Nuk ka nje program të vecantë lidhur me mbajtjen e tyre.

Për bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë dhe në njësitë administrative funksionon sistemi i taksave sipas llojit (Biznes i madh dhe i vogël) ndërtesa me qera, ambulante).

Për familjaret në 4 Njësite Administrative përdoret regjistri i kodifikuar i tatimpaguesve në format exeli. Është marrë informacioni zyrtarisht nga gjendja civile për Bashkinë Kurbin dhe Njësitë Administrative, ku bazuar këtij regjistri janë parashikuar dhe tarifat e familjeve sipas paketës fiskale. Regjistri Elektronik për familjarët në qytet dhe në 4 njësi administrative mbahet në formatin Excel (ndërtesë, truall, tokë bujqësore, etj).

▪ Gjendja apo statusi i subjekteve privat tatimpagues

Për vitin 2021 numri i subjekteve në fund të vitit është 1,146. Subjekte të reja për vitin 2021 janë 0. Subjekte të mbyllura në vitin 2021 nuk ka pasur.

Nr i bizneseve, shtuar dhe pakësuar gjatë periudhës dhe gjendja në fund të vitit 2021 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Lloji i Biznesit	Paraqitja e numrit të bizneseve per vitin 2021				
	Gjendja fillim 01.01.2021	Biznese të reja gjate vitit 2021	Biznese të mbyllura, pezulluara gjatë vitit 2021	Gjendja në fund të vitit 2021	Biznese të pa regjistruar deri në fund të vitit 2021
B. Madh	215	-	-	215	-
B. Vogël	876	-	-	876	-
Ambulantë (tregu)	38	-	-	38	-
Institucione	17	-	-	17	-
Gjithsej	1,146	-	-	1,146	0

Burimi: DPA Bashkia Kurbin

Në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore pranë Bashkisë Kurbin, nuk ka regjistra të veçantë për subjektet që zhvillojnë aktivitet pa u regjistruar në QKB, ku shënohet numri i procesverbalit/aktit të konstatimit, data e identifikimit, të dhënat identifikuese të personit, adresa e plotë etj., sipas kërkesave në pikën 41, “Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar” të udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 të MF “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

▪ Borxhi tatimor, menaxhimi dhe ndjekja e procedurave ligjore për arkëtimin e debitorëve.

Gjendja e debitorëve

Detyrimet debitorë të taksave për bizneset gjendje me 31.12.2020 janë në vlerën 39,895 mijë lekë në total, përfshirë dhe kamatëvonesat nga subjekte biznes i vogël dhe i madh. Më datë 31.12.2021 detyrimet kanë pësuar rritje progresive në shumën 16,036 mijë lekë. Në fund të vitit 2021 rezultojnë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 644 subjekte, nga biznesi vogël, i madh, ambulant dhe paraqiten në vlerën 55,931 mijë lekë. Gjendja e debitorëve për taksat dhe tarifat vendore per vitin 2021 e subjekteve private dhe Njësite Administrative është paraqitur sipas tabelës së mëposhtme. Lista e detajuar e debitorëve, biznes i madh, biznes i vogël privat më hollësisht paraqitet në anekse bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Tabela nr.12 Debitor kategoria “biznes”

Njësia Administrative	Në fillim të vitit 2021		Krijuar brenda vitit 2021			Progresive	Kamatvonesë	Total 2021 lekë
	Nr	Vlerë Totale	Nr	Vlera	Nr			
B.Vogël								
Qendër (Laç)	256	14,470,170	131	3,638,583	387	18,108,753	1,033,650	19,142,403
Milot	51	2,994,198	-16	-994,223	35	1,999,975	114,210	2,114,185
Mamurras	70	2,163,827	7	1,414,807	77	3,578,634	204,300	3,782,934
Fushë-Kuqe	25	969,454	26	1,025,422	51	1,994,876	113,850	2,108,726
TOTAL	402	20,597,649	148	5,084,589	550	25,682,238	1,466,010	27,148,248
B.Madh								
Qendër (Laç)	29	7,320,746	19	4,331,924	48	11,652,670	94,320	11,746,990
Milot	25	8,480,912	-2	86,612	23	8,567,524	489,060	9,056,584
Mamurras	17	3,496,259	6	4,052,089	23	7,548,348	430,920	7,979,268
Fushë-Kuqe	0	0	0	0	0	0	0	0
	71	19,297,957	23	8,470,585	94	27,768,542	1,014,300	28,782,842
TOTAL (B.M+B.V)		39,895,606			644	53,450,780	2,480,310	55,931,090

Burimi: DPA Bashkia Kurbin, përpunuar nga audituesit.

Vlera e stokut të borxhit tatimor në 01.01.2021 në mënyrë progresive është në vlerën 230,494,948 lekë, janë shtuar dhe pakësuar gjatë vitit dhe gjendja në datë **31.12.2021**, në mënyrë progresive është në vlerën **264,010,220 lekë** nga të cilat: 644 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën **55,931,931 lekë**; 8729 familje debitorë për taksën e tokës bujqësore në vlerën **93,488,829 lekë** dhe 15,217 familje debitorë për tarifave vendore në vlerën **36,359,680 lekë**.

Gjithashtu veç sa më sipër, pjesë e vlerës debitorë në fund të vitit 2021, por që nuk përfshihet në borxhin tatimor, rezultojnë: Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale në vlerën **39,481,815 lekë**, tarifë për Leje karburanti (shitje me pakicë) në shumën, **17,000,000 lekë** si dhe gjoba nga IMTV në shumën **16,068,000 lekë**.

Totali i detyrimeve të krijuara për vitin 2021 paraqitet në vlerën 103,605,087 lekë ose me një rritje 44% të totalit të stokut ku peshën më të madhe e zënë detyrimet e familjarëve për tarifave vendore si: Pastrim, gjelbërim, ndricim, taksë ndërtese etj. Sipas të dhënave të administruara nga Drejtoria e Financës, mbi 4,702 familje trajtohen me ndihmë ekonomike, por dhe nga largimi i shumë familjeve brenda dhe jashtë vendit ka ndikuar në mos arkëtimin e detyrimeve të tarifave për familjarët. Fakt është se tarifimi i tyre vijon të bëhet sipas regjistrimit të gjëndjes civile dhe jo sipas një adresari të azhornuar saktë. Gjithsesi konstatohet se rritja e detyrimeve dhe mosarkëtimi në kohë përbën risk duke ndikuar negativisht në buxhetin e Bashkisë Kurbin, efekte që shtrihen në mungesë të shërbimeve dhe investime në infrastrukturë etj.

▪ *Procedurat e ndjekura për arkëtimin e të ardhurave dhe masat e marra shtrënguese për arkëtimin e debisë nga tatimpaguesit dhe uljen e borxhit tatimor*

Nga auditimi i kryer në dokumentacionin që disponohet në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, u konstatua se bashkëpunimi me policinë bashkiake ka qenë normal dhe i vazhdueshëm, për shpërndarjen e njoftimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet privat në territorin e Bashkisë Kurbin, për njoftimin e debitorëve për kryerjen e pagesës, për mbledhjen me forcë e detyrimit nga debitorët, mbledhjen me forcë e detyrimit nga subjektet për zënien e hapësirës publike, siç parashikohet në nenin 5, shkronja “ç” nën-pika “iii”, të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

a. Të ardhurat nga ZVRPP-ja derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Kurbin brenda datës 5 të çdo muaji. Këto derdhje bëhen rregullisht dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Lezhë.

b. Rakordimet në lidhje me TFTH janë mbajtur rregullisht në fund të çdo muaji me Drejtorinë Rajonale Tatimore Lezhë, sipas akt rakordimeve dhe nuk janë konstatuar probleme:

c. Me DRSHTRR Lezhë, e cila është agjent tatimor i mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura është kryer Akt Rakordimi. DRSHTRR mbledh këtë taksë dhe e derdhen, brenda datës 30 të çdo muaji për llogari të Bashkisë Kurbin. Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, drejtoritë rajonale të DRSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5% të totalit mujor të të ardhurave, derdhen me anë të faturës për arkëtim, 25% të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, për Bashkinë Kurbin dhe 75% të të ardhurave, DPSHTRR-ja e derdh për llogari të drejtorisë rajonale, ku është regjistruar (drejtoria rajonale e tatimpaguesve të mëdhenj). Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organet tatimore të administratës qendrore dhe vendore kryhet në bazë të regjistrimit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave. Këto derdhje bëhen rregullisht dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Lezhë dhe Kurbin

Konkluzion: Nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk është bërë mirëadministrimi i informacionit tatimor, të subjekteve tatimpagues të biznesit të vogël, për të gjitha detyrimet tatimore dhe nuk janë vendosur në dosjen e çdo tatim paguesi, ka mangësi përditësimi i të dhënave dhe mungesë të dokumentacionit, si interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit për këto taksa. Veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim, me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e

Shqipërisë”, neni 29 “Dosja e detyrimeve tatimore”, pika 1.

Masat shtrënguese për arkëtimin e borxhit.

Për vitin 2021 ka ecuri lidhur me masat shtrënguese por gjithsesi në nivele të ulëta vendosje apo ekzekutimi. Masat shtrënguese nuk janë ezauruar të plota sipas përcaktimeve ligjore. Nuk është kryer një analizë e detajuar për secilin nga këta debitor tatimpagues për nxjerrë shkakun e mos mbledhjeve të detyrimeve. Analiza dhe planet operacionale janë një hap i cili duhej dhe duhet të jetë në të ardhmen në fokus si indikator orientues për vijimin e marrjes së masave me qëllim arkëtimin e detyrimeve për secilin debitor, biznes i madh i vogël apo cdo lloj debitori. Trendi i rritjes së detyrimeve të pa paguara mbetet akoma i lartë dhe për pasojë ka sjellë të ardhura të munguara, të cilat kanë ndikuar negativisht në buxhetin e Bashkisë Kurbin, të ardhura këto që mund të përdoshin nga Bashkia për investime në infrastrukturë dhe rritjen e përmirësimit të shërbimeve e në tërësi përmirësimin e kushteve të qytetarëve të kësaj bashkie.

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit dhe praktikave të ndjekura për mbledhjen e të ardhurave dhe menaxhimin e arkëtimin e borxhit u konstatua se administrimi i procesit për mbledhjen e detyrimeve tatimore ka mangësi në lidhje me ndjekjen e veprimeve proceduriale nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, duke mos ezauruar në kohë dhe me efikasitet të gjitha hapat dhe mekanizmat e përcaktuar në ligjislacionin tatimor për të siguruar mbledhjen e këtyre detyrimeve.

Për vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore nga bizneset nga kjo drejtori dhe sidomos nga specialistët dhe inspektorët e taksave në Njësitë Administrative, janë mjaftuar vetëm me dërgimin e njoftim detyrimeve për subjektet debitorë. Nuk kanë vazhduar më tej procedurat për të dërguar shkresa për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, në Zyrën Vendore të e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) apo për vendosjen e barrës së pasurisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Gjithashtu nuk është vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese për debitorët si bllokimi i aktivitetit të biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve si dhe deri në kallëzim penal sipas kërkesave të nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar” nenet 89-91.

Titulli i Gjetjes: *Performancë e ulët në realizimin e të ardhurave vendore.*

Situata: Programimi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifatat vendore, për Vitin 2021, janë me mosrealizim në vlerën 43,399 mijë lekë, ose 28% e planit të miratuar. Detyrimet e papaguara total në progresiv nga viti 2011-2021 prej 334,110,035 lekë, ku vetëm për vitin 2021 janë evidentuar 103,615 mijë lekë, shumë e cila përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Kurbin.

Kriteri: Aktet ligjore të sistemit të taksave dhe tarifave vendore, paketa fiskale miratuar me VKB, -Ligji nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 89 “Njoftimi dhe kërkesa për të paguar”, neni 90 “Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit”, neni 91 “Masa e sigurimit të detyrimit tatimor”, neni 93 “Sekuestrimi i pasurisë” neni 97 “Transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë”, neni 98 “E drejta për të kërkuar detyrimet nga pala e tretë”.

Ndikimi: Mungesë e të ardhurave në buxhetin e bashkisë, për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.

Shkaku: Mos zbatim i akteve të miratuara nga Këshilli i Bashkisë për Taksat dhe Tarifatat vendore dhe Ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”

Rëndësia: *I mesëm.*

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore, të marrë masa konkrete ndaj subjekteve debitorë duke ndjekur e zbatuar procedurat tatimore, me qëllim mbledhjen e detyrimeve të prapambetura.

-Të marrë masa për arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore në momentin që lind detyrimi me qëllim mos krijimin e detyrimeve të prapambetura për secilën kategori biznesi.

▪ Realizimi i të ardhurave nga tarifa e lëshimit të autorizimit për licencimin e ushtrimit të veprimtarisë së tregtimit me pakicë të karburanteve dhe nënprodukteve të saj

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhënie Autorizimi për pikat e tregtimit me pakicë të karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit rezultoi se: Nga verifikimi për subjektet që tregëtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në mbledhjen e detyrimeve specifike për këtë kategori biznesi. Për tregti karburanti dhe tregti gazi, ushtrojnë aktivitet 26 subjekte me aktivitet shitje karburanti me pakicë me status aktiv në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe 1 subjekt i tregtimit me pakicë të e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit, te cilët janë të pajisur me autorizim nga Bashkia. Janë konstatuar se deri më datë 31.12.2020 janë të pajisura me autorizim për tregtim me pakicë të karburanteve 5 subjekteve të tregtimit të karburantit dhe 1 subjekt i tregtimit me pakicë të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit, si një dokument i domosdoshëm për pikat e karburantit për licencimin apo lejimin e ushtrimit të kësaj veprimtarie nga këto biznese në zbatim të VKM Nr. 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970 datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” pika 15.1 në të cilën përcaktohet se: “Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë”. Sipas kësaj dispozite ligjore Bashkia Kurbin ka të drejtën dhe detyrimin të pajisë me autorizime personat juridikë apo fizikë të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregtimin e karburanteve për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse) në territorin e Bashkisë Kurbin. Sipas dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave, për subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tregtimit të karburanteve dhe nënprodukteve të tyre që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Kurbin dhe në Njësitë Administrative rezultoi se ekzistojnë të licencuar 26 subjekte private me autorizim me të drejtë rinovimi, për të cilët të dhënat për emrin, NIPTI, afatet dhe pagesat e kryera për pajisjen me autorizim paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.13 Lista e subjekteve aktivë që ushtrojnë aktivitet të tregtimit të lëndëve djegëse e hidrokarbure për konsumatorët fundorë, në territorin e Bashkisë Kurbin.

Nr	Firma	Adresa	Debitor
1	"K"	Lagje 4	1,000,000
2	"D Oil"	Lagje 3 Laç dhe Milot	2,000,000
3	B-P	Autostrade	950,000
4	B-P	Lagje 5 .Mamurras-Lac	950,000
5	"S G" Sh.P.K	Lagje 1 Lac	1,000,000
6	A.K.F.P	Rr nac Tirane-Shkoder	1,000,000
7	"T"	Lagje 2	200,000
8	"E A"	Lagje drita Mamurras	1,000,000
9	L-06	L.Demokracia.Mamurras	1,000,000
10	"C"	Shullaz Milot	1,000,000
11	"V & V G"	Mal-Bardhe Milot	1,000,000
12	V- O	Gjorem, rruga e vjeter	1,000,000
13	"L"	Superstrade Prozhme	1,000,000
14	"N.O"	Superstrade Prozhme	1,000,000
15	"S P A"	Superstrade Skuraj Milot	1,000,000
16	"F"	Fushe-Kuqe	1,000,000
17	D 2014	Fushe Kuqe, Kurbin	1,000,000
			17,100,000

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme të nxjerra nga dosjet individuale të 26 subjekteve private të administruar nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore rezulton se subjektet të cilët ushtrojnë këtë aktivitet në territorin e Bashkisë Kurbin, për paisjen me autorizim për licencimin e veprimtarisë së tregtimit me pakicë të karburanteve kanë kryer

pagesa më pak se detyrimi ligjor, për arsye se nga Bashkia Kurbin afati i autorizimit është bërë 1 vjeçar dhe për rrjedhojë dhe faturim i gabuar për shkak të interpretimit të gabuar të bazës ligjore lidhur me përcaktimin e tarifës së pagesës për këtë kategori. Drejtoria e të Ardhurave Vendore në faturim duhej ti referohej pikës 9 të VKM nr. 344 datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970 datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” në të cilën përcaktohet se: Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.

Në rastet e mësipërme kemi të bëjmë me subjekte tregtarë të cilët kanë stacione shitjesh të karburanteve dhe vajrave lubrifikantë për konsumatorë fundorë.

Konkluzion: Subjektet tregëtare, të cilët në fakt ushtrojnë veprimtari si stacione shitjesh të karburanteve dhe vajrave lubrifikantë (10 prej tyre) kanë kryer pagesa për autorizimin e lejes së ushtrimit të veprimtarisë të lëshuar nga Bashkia një tarifë prej 200,000 lekë secili, për periudhën 2021-2022, tre subjekte kanë paguar të plotë tarifën prej 1,000,000 lekë për 5 vite, ndërsa 17 subjekte nuk kanë paguar për të rinovuar licensën ku sipas dispozitave ligjore duhet të paguanin tarifën prej 1,000,000 lekë secili. Për licencimin 5 vjeçar nga viti 2021 dhe që shtrin efektet deri në vitin 2026, diferenca e tarifës së arkëtuar për secilin subjekt ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë në vlerë totale prej **17,100,000 lekë**. Për mangësitë e konstatuara më sipër (lidhur me karburantet) ngarkohen me përgjegjësi: Z. A.B me detyrë, Specialist Transporti pranë Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, Bashkia Kurbin, Z.A.B me detyrë, Drejtor i drejtorisë së të ardhurave vendore, Znj.D.R me detyrë, Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të të Ardhurave, Z.M.H me detyrë, Inspektor, Z. R.T me detyrë, K/Inspektor, Z.G.L me detyrë, Inspektor, Z.K.C me detyrë, Inspektor, Z.P.P me detyrë, Inspektor, Znj.L.B me detyrë, Inspektor, Z.A.A me detyrë, Inspektor, Z. G.L me detyrë, Inspektor, Z. E.P me detyrë, Inspektor.

Titulli Gjetjes: Mbi licensimin dhe tarifimin e gabuar e të ardhurave nga tarifa e licencimit të ushtrimit të veprimtarisë nga subjektet private për tregtimin me pakicë të karburanteve dhe vajrave lubrifikante etj.

Situata: Sipas dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, u konstatua se 17 subjekte private si vijojnë janë të pajisur me lincense me afat: 2015-2020 dhe ushtrojnë aktivitet pa u pajisur me lincense nga Bashkia Kurbin për periudhën 2021-2026. Subjektet e mëposhtme bazuar në dokumentacionin e disponuar janë debitorë me nga 1,000,000 lekë secili. Më poshtë paraqiten subjektet:

Nr	Firma	Adresa	Debitor
1	"K"	Lagje 4	1,000,000
2	"D Oil"	Lagje 3 Laç dhe Milot	2,000,000
3	B-P	Autostrade	950,000
4	B-P	Lagje 5 .Mamurras-Lac	950,000
5	"S G" Sh.P.K	Lagje 1 Lac	1,000,000
6	A.K.F.P	Rr nac Tirane-Shkoder	1,000,000
7	"T"	Lagje 2	200,000
8	"E A"	Lagje drita Mamurras	1,000,000
9	L-06	L.Demokracia.Mamurras	1,000,000
10	"C"	Shullaz Milot	1,000,000
11	"V & V G"	Mal-Bardhe Milot	1,000,000
12	V- O	Gjorem, rruga e vjeter	1,000,000
13	"L"	Superstrade Prozhme	1,000,000
14	"N.O"	Superstrade Prozhme	1,000,000
15	"S P A"	Superstrade Skuraj Milot	1,000,000
16	"F"	Fushe-Kuqe	1,000,000
17	D 2014	Fushe Kuqe, Kurbin	1,000,000
			17,100,000

Këto subjekte ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me pakicë të gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante me seli në territorin e Bashkisë Kurbin dhe në Njësitë Administrative dhe nuk janë pajisur me autorizim të vlefshëm për ushtrimin e veprimtarisë me afat 5 vjeçar për periudhën e vitit 2021 dhe që e shtrin efektin deri në vitin 2026. Nuk kanë paguar tarifën e caktuar prej 1,000,000 lekë secili, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kurbin në vlerën **17,100,000 lekë**.

Kriteri: VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” kapitulli II, pika 1; gërma “b”, dhe pika 9.

Ndikimi: Të ardhura të munguara, për buxhetin e Bashkisë Kurbin, në vlerën **17,100,000 lekë**.

Shkaku: Mos arkëtimi i tarifës vendore nga lëshimi i autorizimeve për këtë kategori subjektsh.

Rekomandimi: Bashkia Kurbin, nëpërmjet Drejtorisë së Ardhurave Vendore të marrë masa që për 17 subjekte⁶ debitorë të arkëtojë tarifën e plota, për diferencën debitorë prej 17,100,000 lekë, detyrim ky për paisjen me autorizim/liçensë për tregtimin me pakicë të karburanteve dhe gazit të lëngshëm vajrave lubrifikante për automjetet. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për pagesën e tarifës së liçencë/autorizimit, Bashkia Kurbin në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik Industrial të ndërmarrin veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

▪ Realizimi i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë (DVASHK), u auditua i gjithë dokumentacioni për periudhën deri 31.12.2022, i paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit.

Në Bashkinë Kurbin deri në 30.06.2020, disponohen shkresat përcjellëse dhe listat me emrat përkatës që ju janë miratuar lejet e legalizimit për ndërtimet pa leje ndërtimi brenda territorit të bashkisë Kurbin. Nga DVASHK Lezhë, janë dërguar dokumentet për çdo person që ka ndërtuar objekt banimi apo social ekonomik në territorin e Njësitë Administrative të bashkisë Kurbin, ku përcaktohet edhe detyrimi për të paguar vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Bashkia Kurbin, nuk janë marrë masa të veçanta për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga DVASHK Lezhë. Në vijim paraqiten pasqyra e personave të cilët janë pajisur me leje legalizimi, sipërfaqet ndërtimore sipas objekteve, funksioni, vendndodhja e objektit, sipërfaqja e objektit, detyrimi sipas personave që duhet të paguanin, për periudhën deri më 31.12.2022.

Bazuar në të dhënat e marra nga Bashkia Kurbin u konstatua se, nuk janë marrë masa për vjeljen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje ndërtimi, të pajisura me leje legalizimi nga DVASHK Lezhë konkretisht për 1070 raste në vlerën **38,694,250 lekë**, progresive të trashëguara nga viti 2020 dhe për vitin 2021 janë 25 raste në vlerë **787,595 lekë**, me pasojë **të ardhura të munguara të pa kontabilizuara**, në kundërshtim me ligjin Nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 23 dhe sipas pikës 2 të nenit 27 të ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar. Konstatohet se deri më 31.12.2022, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë në total **1198 persona, në vlerën progresive prej 39,481,815 lekë vlerë e cila nuk është kontabilizuar e plotë në financë, për shkak të mos paraqitjes të detyrimeve debitorë nga Drejtoria e Planifikimit dhe kontrollit të Zhvillimit të Territorit.**

⁶ Pasqyruar lista e subjekteve në Raportin Përfundimtar të Auditimit, Kapitulli V “Anekse – Aneksi nr.2”.

Konkluzion.

-Në auditimin e programimit dhe realizimit të të ardhurave, nga arkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se, nga Bashkia Kurbin, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga DVASHK Lezhë. Sipas të dhënave zyrtare që DVASHK Lezhë i ka dërguar Bashkisë Kurbin, konstatohet se deri më 31.12.2021, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 1095 persona, veprime dhe mosveprime e jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23. “Për Sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, të Bashkisë Kurbin, pika IV, sipas listës që disponon Bashkia, **me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 39,481,815 lekë.**

Vlera prej 39,481,815 lekë, e cila përfaqëson mos arkëtim të taksës së infrastrukturës për objektet ndërtimore të legalizuara, do të konsiderohet si e ardhur e munguar shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Kurbin.

Titulli gjetjes: Të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i taksës në infrastrukturë për ndërtimet e pa leje të kualifikuar për legalizim apo të legalizuara.

Situata: Në auditimin e programimit dhe realizimit të të ardhurave, nga arkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se, nga Bashkia Kurbin, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga DVASHK Lezhë. Sipas të dhënave zyrtare që DVASHK Lezhë i ka dërguar Bashkisë Kurbin, konstatohet se deri më 31.12.2021, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 1095 persona, veprime dhe mosveprime e jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23. “Për Sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, të Bashkisë Kurbin, pika IV, sipas listës që disponon Bashkia, **me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 39,481,815 lekë.**

Vlera prej 39,481,815 lekë, e cila përfaqëson mos arkëtim të taksës së infrastrukturës për objektet ndërtimore të legalizuara, do të konsiderohet si e ardhur e munguar shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Kurbin.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Z.Benard Palaj me detyrë, Drejtor i Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, neni 35.

VKB nr.152, datë 14.12.2020 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2021”, pika IV “Struktura e ngarkuar për përlllogaritjen, vjeljen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, pranë Bashkisë Kurbin”.

Impakti:Mungesa e realizimit të të ardhurave nga taksa e infrastrukturës për legalizimet e ndërtimeve informale.

Shkaku:Mos ndjekje dhe mos marrje e masave nga Bashkia Kurbin për arkëtimin e taksës së infrastrukturës nga debitorët, që kanë kryer legalizime të ndërtimeve pa leje.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit t’i përcjellë Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave (DAP) listën me subjektet debitore për taksën e ndikimit në infrastrukturë, si dhe në vijim DAP Bashkia Kurbin të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 39,481 mijë lekë.

II.2.3.Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë.

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

2.3.3. Opinioni mbi pasqyrat financiare.

1.Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

Për të arritur në opinionin, në se pasqyrat financiare për vitin 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin” dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, u analizuan pasqyrat financiare të vitit 2021, konkretisht:

Pasqyrat Financiare të vitit 2021.

Për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2021 është marrë në shqyrtim dokumentacioni i mëposhtëm:

Pasqyrat financiare të vitit 2021;

Centralizatori/Libri i madh;

Ditari i Bankës;

Ditari i Arkës;

Ditari i Magazinës;

Ditari i Pagesave;

Ditari i Veprimeve të ndryshme;

Aktrakordimet me Degën e Thesarit Laç;

Inventarët etj.

Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit ushtrimor 2021 janë hartuar dhe depozituar me shkresën nr.1822 prot., datë 28.03.2022 në Degën e Thesarit Laç.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit: Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm dhe i mbështetur në testet e kontrollit dhe testet thelbësore të transaksioneve për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Përputhshmëria me kërkesat ligjore për Raportimin Financiar: Përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare, në Bashkinë Kurbin, është realizuar në mbështetje të kërkesave të kuadrin rregullator të fushës.

Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare.

▪ Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2021 janë:

- Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
- Pasqyra e performancës financiare (F2);
- Pasqyra e flukseve monetare (F3);
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
- Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare (F5);

Pasqyrat statistikore:

- Investimet dhe burimi i financimit (F6);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);

- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);
- Gjithashtu është dhënë informacion mbi:

Emrin e njësisë ekonomike raportuese, Bashkia Kurbin me NIPT K57904312C;

Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2021-31.12.2021;

- Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë;
- Data e hartimit të Pasqyrave Financiare, 28.03.2022;
- Përgatitur nga zj.R.K;
- Pasqyrat Financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Kurbin me shkresën nr.1822 prot., datë 30.03.2022, nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Kurbin zj. M.C.

Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimin financiar janë Aktrakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Kurbin të konfirmuara dhe nënshkruara nga NZ dhe NA i Bashkisë Kurbin, Kontabilisti dhe Përgjegjësi i Degës së Thesarit Kurbin.

-Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike. Në këtë Bashki, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, që e bën me risk të lart për sa i përket sigurisë në saktësinë informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti.

Mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

Aktivitet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

b. Kontrolle të llogarive dhe dokumenteve.

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Aktivitet neto janë të barabarta me Aktivitet-Pasivet=4,602,311,561 lekë.

- Aktivitet 4,741,465,415 lekë
- Pasivet 139,153,854 lekë
- Aktivitet neto 4,602,311,561 lekë

Aktivitet afatshkurtra

Aktivitet afatshkurtra më datë 31.12.2021 paraqiten në vlerën **1,897,358,045 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekujivalentet e tyre” në shumën 1,509,789,364 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 59,878,235 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 327,690,446 lekë dhe

- Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 1,509,789,364 lekë, përbëhet nga: gjendja e fondeve në thesar me 31.12.2021 në shumën 1,441,211,357 lekë; gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 68,578,007 lekë.

- Mjetet në ruajtje përbëhen nga ndalesat e 5 % te garancisë së punimeve.

-Gjendja e llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas mbylljes së bilancit të vitit 2021 është në vlerën prej 1,509,789,364 lekë dhe në mbyllje të vitit 2020 në vlerën prej 1,100,205,582 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” në vlerën 1,100,205,582 lekë dhe rubrikën VI “Teprica e Likuiditeve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën 1,509,789,364 lekë. (sipas formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”)

Rakordimi i llogarive me degën e thesarit, llogaria nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, llogaria nr.466 “Mjete në ruajtje” dhe llogaritë e të ardhurave

Viti 2021

Referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit është e analizuar si më poshtë:

Testimi i llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar” për vitin ushtrimor 2021

I.Të trashëguara nga viti 2020	
Sipas aktit të rakordimit për shumën. Nga të cilat:	1,074,614,586
Granti i trashëguar	1,047,076,701
Të ardhura të trashëguara	27,537,885
Mjete në ruajtje të trashëguara (llog. 466)	25,139,996
Fonde specifike	0
FZHR	0
Totali	1,099,754,582
II.Të hyrat (Shtesat debitore) gjatë vitit	
Granti i vitit	389,964,128
Të ardhurat e vitit	110,498,436
Të hyra nga mjetet në ruajtje	44,319,870
Granti specifik	973,031,182
FZHR	0
buxheti (Rindertim)	1,341,144,767
Tot.	2,858,958,383
Totali i të ardhurave (I+II)	3,958,712,965
III.Lëvizjet kreditore të llogarisë 520	
Paga sigurime (600+601)	268,741,049
Shpenzime operative (602)	133,234,879
Subvencione (603)	0
Transferime korente të brendshme (604)	986,974,462
Transferime korente me jashtë (605)	0
Transferime për buxhetet familjare dhe individë (606)	796,945,065
Kredia (BKT) + Interesa për huamarje (651)	0
Investime (231)	255,639,364
Të dala nga mjetet në ruajtje (466)	881,859
Transferime korente të brendshme + transfertat buxhetin e vet (418,470,743 +5,975,765)	6,506,904
Totali	2,448,923,601
Totali (I+II) – III	1,509,789,364

Tabela e përpunuar nga audituesi

Llogaritë e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Gjendje Inventari qarkullues	59,878,235	103,575,157	Diferenca
Materiale	0	125,319	125,319
Inventar i imet	59,878,235	103,449,838	43,571,603
Prodhim nre proces			
Produkte			
Mallra			
Kafshe ne rritje e majmeri			
Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve			
Diferenca nga cmimet e magazinimit			
Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)			

Llogaria nr.312 “Materiale”, në fillim të vitit 2021 ka vlerën 125,319 lekë dhe në fund pasqyrohet me vlerën 0 lekë, si rrjedhojë e pakësimit të gjëndjes në magazinë.

Llogaria 327 “Objekte inventari”, ka vlerën 59,878,235 lekë dhe përpunohet me rezultatin e inventarizimit vjetor.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 43,696,922 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” (pasqyra F2 – performanca financiare) në shumën 43,696,922 lekë.

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Titullari i Bashkisë Kurbin ka nxjerrë Urdhrat e inventarizimit, si vijon:

Urdhër nr.83 dt.15.09.2021 “Për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshëm dhe të imët në Bashkinë Kurbin dhe institucionet e tjera nën juridiksionin e Bashkisë Kurbin.”

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Fondi i Konsoliduar

Në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën **7,397,506,788 lekë**. Fondi i Konsoliduar është i barabartë me fondet neto. Gjendja e fondit të konsoliduar rezulton nga diferenca e shumës së aktiveve me pasivet.

		Viti 2021	Viti 2020	Diferenca
Llogaria	FONDI I KONSOLIDUAR :	4,602,311,561	3,907,801,638	-694,509,923
101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	2,538,889,136	2,396,358,462	-142,530,674
12	Rezultatet e mbartura	0	0	0
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	1,441,211,357	1,074,615,586	-366,595,771
111	Rezerva		0	0
115	Nga Fondet e veta te investimeve	12,731,653	1,539,185	-11,192,468
15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime		0	0
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	609,479,415	435,288,405	-174,191,010
106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	0	0	
107	Vlera e mjeteve te caktuara ne perdorim	0	0	
109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata	0	0	
	Te Tjera	0	0	

Pasqyra e Performancës Financiare.

Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare përsa i përket të ardhurave:

-Llogaritë e financimit nga buxheti i shtetit për vitin 2021 (grant) paraqitet në shumën prej **3,590,661,018** lekë.

-Të ardhurat e realizuara nga Bashkia për vitin 2021 janë 59,672,747 lekë nga të cilat:

-Të ardhurat tatimore në vlerën **86,802,160** lekë dhe të ardhurat jo tatimore në vlerën **15,610,665** lekë, sipas aktrakordimit me thesarin.

Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare përsa i përket shpenzimeve:

Emërtimi	Sipas Situacionit	Sipas Pasqyrës së Performancës
600	232,288,871	
601	38,299,118	
602	202,427,624	
604	938,668,724	
606	796,481,227	
63		43,696,922
Totali	2,208,165,564	2,251,862,486

-Diferenca në shumën 43,696,922 lekë midis shpenzimeve të paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare dhe sipas Situacionit përbëhet nga "Ndryshimi i gjendjes së inventarit".

Pasqyra e flukseve monetare (F3)

Pasqyra e Flukseve Monetare, paraqet rrjedhën e likuiditeteve dhe gjendjen më datë 31.12.2021.

Nr Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportues	Periudha Paraardhëse
I	Veprimtaritë e shfrytëzimit	451,441,880	1,035,594,280
II	Veprimtaritë e investimeve	-35,351,174	-1,769,585
III	Transferta e te tjera	-6,506,924	-6,541,555
VI	Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor	1,509,789,364	1,100,205,582

Nga kontrolltet e kryera rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2021, e paraqitur në këtë pasqyrë rezulton në shumën 1,509,789,364 lekë dhe kuadron me tepricën e

likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" e cila paraqitet në shumën 1,509,789,364 lekë.

Plotësimi i Pasqyrës së Flukseve monetare është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.6 "Rregullat e plotësimi të pasqyrës financiare individuale të flukseve monetare", i ndryshuar.

Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale rezultoi:

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 468 "Debitorë të ndryshëm".

Situata: Llogaria nr. 468 "Debitorë të ndryshëm", në fund të vitit 2021 është në vlerën 109,759,462 lekë.

Levizja e llogarisë 468 Sintetike		Viti 2021			
Bashkia dhe NJA	Përshkrimi	Gjendja 31.12.2020	Debi	Kredi	Mbetja
	Debitorët	153,209,401	51,753,697	4,521,602	200,433,496

Llogaria 468 Analitike		
Nr	Emërtimi	Mbetja 31.12.2021
1	Taksë toke	37,701,506
2	Abonent familjar	20,419,118
3	TNI legalizim	38,020,593
4	Debitorë bizneset	59,611,011
5	Gjoha të IKMT	44,681,268
	Totali	200,433,496

Ndërkohë sipas përlllogaritjeve të grupit të auditimit, bazuar në të dhënat e vendosura nga Bashkia Kurbin (Drejtoria e Urbanistikës dhe Drejtoria e të Ardhurave), lëvizjet debitore dhe kreditore të llogarive përkatëse, rezultoi se vlera e llogarisë nr.468 është kontabilizuar më pak për vlerën 101,030,695 lekë, si më poshtë vijon:

-1,461,222 lekë më pak për taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale;

-1,347,673 lekë më pak për taksat dhe tarifatat (principal dhe kamat-vonesë) vendore të biznesit, pasqyruar tabela përmbledhëse e diferencave si vijon⁷:

NJA	B.V	B.M	Diferenca
Laç	432,866	540,597	
Fush Kuqe	37,205		
Mamurras	71,699	113,525	
Milot	25,038	126,739	
Total	566,810	780,863	1,347,673

-3,679,921 lekë, vlerë e përfshirë brenda shumës totale 59,611,011 lekë, e trashëguar nga vitet e mëparshme dhe që nuk është e analizuar me dokumentacion në mënyrë analitike. Të pyetur për këtë problem specialistët e financës sqarojnë se kjo shumë vjen nga pasqyrat financiare të ish Komunave qysh nga vitit 2015. Ky problem është trajtuar edhe në materialin e Auditit të mëparshëm të KLSH, i cili ka rekomanduar për gjetjen e origjinës nga vjen, arkëtimin e kësaj vlere, deri në padi në gjykatë, por aktualisht edhe gjatë këtij auditimi ende nuk është gjetur origjina se nga vjen dhe çfarë përfaqëson kjo shumë.

-17,100,000 lekë, detyrime që kanë për të likuiduar 17 subjekte, të cilët janë pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve, u është lëshuar fatura, por nuk kanë kryer likuidimet përkatëse, pasqyruar në tabelën si vijon:

-1,235,438 lekë detyrim për likuidimin e tarifës së qirasë nga subjekti "H.C" Sh.P.K, pasqyruar në tabelën si vijon:

Nr.	Qiramarrësi	Zona	Objekti	Afati Vjet	Kontrate	Pa paguar
1	H	VINJOLL	HEC	10	22.10.2013	423,750
2	H	VINJOLL	HEC	10	10.03.2014	699,375
	Total					1,235,438

⁷ Tabela analitike pasqyrohet në Kapitullin V "Anekse – Aneksi nr.3".

-55,787,323 lekë më pak për taksën e tokës bujqësore, pasqyruar si vijon:

Debitor toka bujqësore 2021					
NJ.A.	Debitor të trashëguar deri në fillim të vitit 2021 (2011-2020)	Debitorë krijuar në vitin 2021 (Lekë)			Debia Progressive
		Familje me tokë bujqësore	Familje debitoare (Nr)	Familje debitoare (vlerë)	
Laç	17,158,320	959	920	2,920,267	20,078,587
Mamurras	27,573,648	3163	3134	7,283,134	34,856,782
Milot	15,193,982	3029	2961	3,332,754	18,526,736
Fushë-Kuqe	14,977,959	1716	1714	5,048,765	20,026,724
Totali	74,903,909	8,867	8,729	18,584,920	93,488,829

Burimi: DAV Bashkia Kurbin

-20,419,118 lekë për detyrimet e kategorisë “Familjar”, e trashëguar nga vitet e mëparshme dhe që nuk është e analizuar me dokumentacion në mënyrë analitike. Të pyetur për këtë problem specialistët e financës se nuk administrohet dokumentacion mbi justifikimin e vlerës debitoare.

(Të gjitha të dhënat e mësipërme në mënyrë analitike janë bashkëlidhur akt-konstatimit)

-Konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr. 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” (me kundërparti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar.

Kriteri: Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, shkronja “ë”, pika 3, neni 12;

Ligji nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, pika 1, neni 11.

Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c”.

Pikën 10 të Udhëzimit nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Ndikimi/Efekt: Llogaria nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë të përbërjes së debitorëve të Bashkisë Kurbin në fund të vitit 2021. Pasqyrat financiare nuk janë sipas formatit të miratuar dhe për rrjedhojë nuk japin informacion të plotë dhe të saktë.

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimi e Llogarisë nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2021, vlera kontabël paraqitet në shumën 0 lekë.

Situata: Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare “Ujësjellës Kanalizime Kurbin Sh.A” me NIPT K07628310A, u konstatua se Bashkia Kurbin zotëron 100% të aksioneve të kësaj shoqërie ose 595.000 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë secili, në **total 595,000,000 lekë**.

Veç sa më sipër Bashkia Kurbin zotëron 2.4% ose 10727.23 të aksioneve të Shoqërisë Aksionare “Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A” me NIPT J61819502V, me vlerë nominale 1,000 lekë secili, në **total 10,727,230 lekë**.

Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare “Klubi i Futbollit Laçi” me NIPT L18105301N, u konstatua se Bashkia Kurbin zotëron 25% të aksioneve të kësaj shoqërie ose 875 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë secili, në **total 875,000 lekë**.

-Pra sa më sipër llogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” është nënvlerësuar me 606,602,230 lekë.

Kriteri: Urdhri i Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”.

Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu 3.1, pika 31, shkronja “b”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vetë.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”.

Situata: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Kurbin, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 68,578,007 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Laç.

Llog. 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	
Celje e vitit 2021	25,139,996
Shtesa	44,319,170
Pakësime	881,159
Gjendja në 31.12.2021	68,578,007

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2021, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Në mënyrë analitike, garancitë të cilave u ka kaluar afati i shlyerjes, si dhe objekti për të cilën është mbajtur kjo garanci ka përfunduar, paraqiten si më poshtë:

Nr	Objekti	Vlera e garancisë
1	Lyerje	75,003
2	Rikonst Rruga Rreshena	105,283
3	Ndertimi I Kuz Droje	119,508
4	Sistemim I Rruges Nacionale Skuraj	4
5	Linje E Vaditjes Zheje	282,487
6	Blerje Kompjuter E Skaner Per Urbanistiken	38,730
7	Hidroizolimi I Tarraces Shkolles Milot	78,918
8	Skema Ujitjes F,Milot,Mamur,Droje U-12	30,401
9	Rinovim Trotuari B.Kurbin	471,564
10	Riparim I Rugeve Me Cakull	340,620
11	Rikonstruksion I Shkolles Nr 3 Dhe Terreneve Sportive	4,527,173
12	Rindertim I Terreneve Sportive Mark Trokthi Lac	1,620,390
13	Rrethim I Dy Oborreve Te Shkollave 9-Vj+Mesme Gorre	199,554
14	Ambiente Funks Terren Sport Gurez	47,130
15	Ripar Rugeve Cakull	404,462
16	Punim Riparim Zyrat E Pmnzsh	231,505
17	Rehabilit Zyrat E Pasap +Gj.Civile	33,044
18	Ndricim I Disa Zonave Lac-Mamu-Milot	154,356
19	F.V Kondicioneresh	59,910
20	Rikonstruks Bashkise Kurbin	724,798
21	Rikonstruksion I Shkolles Mark Trokthi	3,458,156
	Total	13,002,996

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” është mbivlerësuar për 13,002,996 lekë për vitin 2021.

Kriteri: Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, pika 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4”.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021.

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave ju ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr.401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”.

Situata: Llogaria 401-408 në fund të vitit 2021 paraqitet me vlerën 47,605,378 lekë. Nga shqyrtimi i llogarisë analitike për fatura të mbërritura por të palikujduara, konstatohet se në llogarinë e mësipërme nuk janë kontabilizuar faturat të mbërritura gjatë vitit 2021 dhe të pa likujduara (duke përfshirë edhe periudhën deri më datë 27.01.2022⁸) për vlerën 10,565,436 lekë, si më poshtë vijon:

Data e likujdimi	Objekti	Vlera
29.03.2022	L 2014 pastrim nentor 2021	1,279,514
29.03.2022	L 2014 pastrim dhjetor 2021	988,909
29.03.2022	B /k pastrim lac nentor 2021	2,418,570
29.03.2022	B/k pastrim dhjetor 2021	2,554,871
29.03.2022	V pastrim milot-f.kuqe nentor 2021	1,624,163
29.03.2022	V pastrim milot fkuqe dhjetor 2021	941,654
29.03.2022	V transport mbeturinash muaji tetor 2021	355,312
29.03.2022	B transport mbeturinash tetor 2021	141,636
29.03.2022	B/k transport mbeturinash nentor 2021	119,816
29.03.2022	B/k transport mbeturinash dhjetor 2021	140,991
Total		10,565,436

Një pjesë e faturave të mësipërme (fatura të muajit Tetor 2021 të subjektit vale në vlerën 496,048 lekë gjithësej) kanë plotësuar afatin 60-ditor pa u likujduar, e për rrjedhojë duhet të kontabilizohen në llogarinë nr.467 “Kreditor të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr.486, me qëllim pasqyrimin e plotë të vlerës së detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2021.

Kriteri: Funksionimi kontabël i llogarive të klasës 4, në Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr.401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve të bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë nr. 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarive nr. 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje Plantacione”.

-Gjendja e llogarisë **210 “Toka, Troje, Terrene”** në datën 01.01.2021, paraqitet në vlerën 8,652,643 lekë, kurse në 31.12.2021 paraqitet po në vlerën 8,652,643 lekë e pa ndryshuar. Në

⁸ Sipas përcaktimit të bërë në Udhëzimin nr.25, datë 09.12.2021 “Për mbylljen e llogarive të vitit 2021”.

këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera në vitet e mëparshme sipas aneksit në vijim:

Analiza e llogaria 210-Toka, troje e terrene.

Nr	Përshkimi i aktivitet	Vlera
1	Toke truall për qendrën shëndetësore Droje Mamurras 2006	350,000
2	Trualli i Bashkisë mamurras2008	7,000,000
	Total Nj.A Mamurras	7,350,000
3	Truall për urën e varur Skuraj Milot 2010	123,300
	Total Nj.A Milot	123,300
4	Toke truall për varrezat Gurez	1,179,163
	Total Nj.A.F.kuqe	1,179,163
	Total	8,652,643

Nga analiza e kësaj llogarie **konstatohet se:**

Në llogarinë 210 “*Toka, Troje, Terrene*”, nuk është pasqyruar:

a) vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, të pallatit të kulturës, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj, sipas inventarit të aktiveve afatgjata materiale, të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtim e konstruksione”;

b) vlerat e trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Kurbin, përkatësisht me VKM nr.467, datë 18.07.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Laç, të qarkut të Lezhës”.

VKM nr.114, datë 13.02.2013 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Mamurras, të qarkut të Lezhës”.

VKM nr.307, datë 10.04.2013 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Fushë-Kuqe, të qarkut të Lezhës”.

-Gjendja e llogarisë 211 “**Pyje, kullota, plantacione**” në datën 01.01.2021, paraqitet në vlerën 9,414,833 lekë, kurse në 31.12.2021 paraqitet po në vlerën 9,414,833 lekë, e cila tregon se edhe për këtë zë nuk ka patur ndryshime nga viti i kaluar. Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera për pemë dekorative para vitit 2020, sipas aneksit në vijim:

Nr	Përshkimi i aktivitet	Vlera
1	Peme dekorative Bli viti 2013	5,302,673
2	Peme dekorativeviti 2014	3,812,160
	Total Nj.A Mamurras	9,114,833
3	Peme dekorative Rrap viti 2018	200,000
4	Peme dekorative Bli viti 2018	100,000
	Total llogaria 211 me 31.12.2021	9,414,833

Nga analiza e kësaj llogarie **konstatohet se:**

*Në llogarinë 211 “*Pyje, kullota, plantacione*”, nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Kurbin, të transferuara me VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, e ndryshuar, pika 46, shtojca me nr.44, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Kurbin, me numër rendor nga 1(një) deri 722 (shtatëqind e njëzet e dy).

Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i aseteve për dy llogaritë e mësipërme.

Situata: Për llogaritë e mësipërme në Bashkinë Kurbin nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitet, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitet, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj.

Kriteri: Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 “Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë”; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap III, pika 30, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e informacionit në mënyrë analitike për secilin aktiv si dhe mungesa e një regjistri kontabël për çdo llogari të aktiveve sjell një pasqyrim jo të saktë të këtyre vlerave kontabël.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me qëllim kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve, si dhe në vijim Drejtoria e Financës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.210 “Toka, Troje, Terrene” nr.211 “Pyje, kullota, plantacione”.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme, për hartimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, i cili minimalisht duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”.

Situata: Llogaria 215 “Mjete transporti” paraqet vlerën neto të mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Kurbin më datë 31.12.2021 në shumën 24,245,023 lekë.

-Nga shqyrtimi llogarisë analitike të mjeteve të transportit, rezulton se kemi klasifikim të gabuar të disa makinerive në këtë llogari, si 3 fadroma, 1 kovë eskavatori dhe 1 rimorkiator për vlerën 49,828,544 lekë të cilat janë makineri dhe jo mjete transporti, si dhe duhet të klasifikohen në llogarinë 214, si dhe për këto makineri duhet të aplikohet normë tjetër amortizimi (5%) dhe jo (20%).

Kriteri: Nomenklatura e llogarive të planit kontabël publik-instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune – llogaria 7-shifrore 2140240-Pajisje dhe makineri për konstruksione (ndertime); 2140260-Pajisje pastrimi për rrugët; 2140320-Mjete dhe pajisje të tjera teknike

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr. 215 “Mjete transporti”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021, si dhe ndikon në rritjen e vlerës së amortizimit vjetor për aktivitetin e institucionit.

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi:

-Zj. R.K, Drejtore e Drejtorisë së Financës, për mangësitë e në kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të të gjitha transaksioneve.

-Z. A.B, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave, për mangësitë në raportimin e debitorëve (biznes dhe familjar) për taksat dhe tarifatat vendore.

-Z. R.V, Specialist pranë Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, për mangësitë në raportimin e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale.

II.2.4.Auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

Titulli i gjetjes: Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Situata: Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmblendhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

1. Shkresa përcjellëse nr.773/11, datë 20.11.2021 e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë, si dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës, protokolluar në zyrën e protokollit të Bashkisë Kurbin, më datë 22.10.2021 me shkresën nr.4782/2 prot.
2. Shkresa kthim-përgjigje (brenda afatit 20 ditë) për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit.
3. Shkresa kthim-përgjigje (brenda afatit 6-muajsh) së bashku me raportin për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Për sa më lart në Bashkinë Kurbin, nga grupi i auditimit u mbajt akt-verifikimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Nga auditimi u konstatua se:

1. Me shkresën nr.6981 prot., datë 18.11.2022 “Kthim përgjigje për raportin përfundimtar të auditimit dhe rekomandimet e lëna”, Bashkia Kurbin nuk ka respektuar afatin prej 20-ditësh për dërgimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Shkalla e zbatimit: Ky detyrim ligjor nuk është zbatuar në afat.

2. Bashkia Kurbin me shkresën nr.2141 prot., datë 15.04.2022 ka dërguar në KLSH, raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit prej 6-muajsh, në përputhje me pikën 2 të nenit 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Shkalla e zbatimit: Ky detyrim ligjor është zbatuar në afat.

3. Analizimi dhe nxjerrja e përgjegjësive në Bashkinë Kurbin:

Nga KLSH janë lënë 49 rekomandime gjithsej, nga këto:

- 16 masa organizative;
- 3 masa shpërblim dëmi;
- 4 masa për eliminimin e efekteve negative të shkaktuara në administrimin e fondeve publike në përputhje me parimin e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit;
- 6 masa për uljen e borxhit tatimor;
- 18 masa disiplinore;
- 2 masa administrative.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Në numër rekomandimesh: 49 rekomandime të dhëna, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 49 rekomandime, 27 prej tyre janë zbatuar ose 56%, 3 zbatuar pjesërisht ose 7%, 3 në proces zbatimi ose 7%, si dhe 16 pa zbatuar ose 33%.

-Në vlerë monetare, sa i përket rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

3 rekomandime për shpërblimin e dëmit të krijuar për 3 subjekte në vlerën 6,565 mijë lekë, të cilat janë pranuar plotësisht nga subjekti. Nga 3 rekomandime, 2 janë zbatuar për vlerën 5,184 mijë lekë për 2 raste, si dhe 1 në proces zbatimi për vlerën 1,381 mijë lekë për 1 subjekt.

4 masa për eliminimin e efekteve negative financiare në vlerën 770,658 mijë lekë, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 4 masa në vlerën 770,658 mijë lekë, 1 masë në vlerën 249,059 mijë lekë ose 33% është në proces zbatimi, si dhe 3 prej tyre në vlerën 521,599 mijë lekë ose 67 % nuk janë zbatuar.

6 masa për eliminimin e borxhit tatimor, për 16174 subjekte në vlerën 494,850 mijë lekë, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 6 masa në vlerën 494,850 mijë lekë, është në proces zbatimi

1 masë për 40 subjekte në vlerën 20,000 mijë lekë, ose 4% e tyre në vlerë monetare, si dhe 5 masa në vlerën 474,850 mijë lekë ose 96 % nuk janë zbatuar.

-Janë lënë 18 masa disiplinore, të cilat janë zbatuar.

-Janë lënë 2 masa administrative, të cilat nuk janë zbatuar.

Pasqyruar në formë tabelare, si dhe përshkruese për çdo rekomandim në kapitullin “Aneksi – Aneksi nr.4”.

Më hollësisht rekomandimet e pazbatuara dhe zbatuar pjesërisht, për të cilat nga KLSH rikërkohet zbatimi i tyre, paraqiten si më poshtë vijon (numrat rendor janë sipas renditjes në shkresën përcjellëse dërguar subjektit):

A. MASA ORGANIZATIVE:

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore, u konstatua se për periudhën objekt auditimi (2019-30.06.2020), janë në proces pagese gjithsej 15 vendime për vlerën **26,403,099 lekë**, nga e cila për largimet nga puna për 12 punonjës në vlerën 9,826,716 lekë dhe 3 vendime të tjera për vlerën 16,576,383 lekë, detyrimi për vendimet gjyqësore të formës së prerë, për shpronësime, ndihmë ekonomike, etj.

Shuma prej 26,403,099 lekë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, është një shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit duke qenë se i përket vendimmarrjeve të gabuara për largim nga puna, para vitit 2018, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në R.Sh”, i ndryshuar.

Nga auditimi rezultoi se janë zbatuar (likuiduar) gjatë vitit 2019 deri më datë 30.06.2020 vlera prej 10,475,879 lekë, mbetet për likuidim vlera **15,971,220 lekë**. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nga titullari nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62 të UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit.

2.1. Rekomandimi: Titullari i institucionit të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore në vlerën **15,971,220 lekë**, të nxjerrë arsyet dhe përgjegjësitë për efektin negativ që këto vendime i kanë shkaktuar buxhetit të njësisë vendore. Sektori juridik në rastet e proceseve gjyqësore të ndjek këtë proces në të gjitha shkallët e gjykimit. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nga titullari të nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.

Menjëherë

Zbatimi: Rekomandimi 2.1 është zbatuar pjesërisht.

3. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2019, në llogarinë 210 “*Toka, Troje, Terrene*”, nuk është pasqyruar:

a)-Vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, të pallatit të kulturës, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj, sipas inventarit të aktiveve afatgjata materiale, të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”.

b)-Vlerat e trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Kurbin, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 30.

3.1. Rekomandimi: Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për sistemin e llogarisë 210 “*Toka, Troje, Terrene*”, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e tokës truall nën objekte të ndërtesave të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2019 dhe vlera e trojeve të cilat me Vendime të Këshillit të Ministrave i janë kaluar në pronësi, Bashkisë Kurbin.

Menjëherë

Zbatimi: Rekomandimi 3.1 nuk është zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2019, në llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, nuk është pasqyruar:

a)-Vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Kurbin, të transferuara me VKM nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 46, shtojca me nr. 44, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Kurbin, me numër rendor nga 1(një) deri 722 (shtatëqind e njëzet e dy), në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 30.

4.1. Rekomandimi: Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues, të marrin masa për inventarizimin e pyjeve dhe kullotave të cilat janë në pronësi të Bashkisë Kurbin si dhe të bëhet pasqyrimi i saktë në dokumentet kontabël të vlerës së llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, në pasqyrat e pozicionit financiar.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021
Zbatimi: Rekomandimi 4.1 nuk është zbatuar.

8. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2019, gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, paraqitet në vlerën 11,007,682 lekë, e cila pasqyron vlerën e garancisë për punime të kryera për 30 objekte, e verifikuara sipas akt rakordimit me degën e thesarit. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se, për 14 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, në vlerën **2,446,209 lekë**, nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në degën e thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës.

Nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimeve, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me Subjektet Sipërmarrëse, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve dhe Sektorin Juridik, të marrë masat për zbatimin e procedurave ligjore për likuidimin e vlerës 2,446,209 lekë ndaj subjekteve private dhe sistemimin e llogarisë nr.466 “Mjete në ruajtje”.

Brenda 6 Mujorit I-rë të vitit 2022
Zbatimi: Rekomandimi 8.1 është në proces zbatimi.

9. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2019, gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 117,344,259 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë për taksa dhe tarifa vendore të bizneseve, detyrimet e familjarëve për tarifa vendore. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se nga vlera totale, vlera prej **3,678,921 lekë**, gjendje më 01.01.2019, e trashëguar nga vitet e mëparshme, nuk është e analizuar me dokumentacion në mënyrë analitike, me pretendimin se është e trashëguar nga ish komunat qysh nga vitit 2015, kohë në të cilën u krye zbatimi i reformës administrative e territoriale, ku ish komunat që u përthithën nga Bashkia Kurbin, me të drejtat dhe detyrimet e tyre. Nga Drejtoria e Financës nuk janë marrë masa për gjetjen e dokumentacionit të origjinës dhe arkëtimin e kësaj vlere. Veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6.

9.1 Rekomandim: Bashkia Kurbin, Drejtoria e Financës të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit duke administruar dokumentacionin e nevojshëm kontabël e ligjor që në origjinën e krijimit të tyre e sidomos të vlerës **3,678,921 lekë** për të cilën mungon

dokumentacioni i origjinës dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre duke bërë kërkesë padi në gjykatë. Të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

Menjëherë

Zbatimi: Rekomandimi 9.1 nuk është zbatuar.

10. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2019, u verifikuan Aktivet Afatgjata Materiale, të llogarive 210, 211, 212, 213, 214, për vërtetësinë e gjendjeve fizike dhe për justifikimin me dokumentacionin e nevojshëm ku u konstatua se:

Llogaria 210 “*Toka Troje Terrene*” për vlerën historike 8,652,643 lekë, pa lëvizje gjatë vitit 2019,

Llogaria 211 “*Pyje Plantacione*” për vlerën historike 9,414,833 lekë, pa lëvizje gjatë vitit 2019,

Llogaria 212 “*Ndërtesa e Konstruksione*” për vlerën historike 1,760,845,363 lekë, është shtuar gjatë vitit 2019 për vlerën 9,639,055 lekë,

Llogaria 213 “*Rrugë, Rrjete, Vepra Ujore*” për vlerën historike 1,376,400,001 lekë, është shtuar gjatë vitit 2019 për vlerën 10,680,921 lekë,

dhe **Llogaria 214** “*Instalime teknike, makineri e pajise*” për vlerën historike 33,019,211 lekë, është shtuar gjatë vitit 2019 për vlerën 8,728,820 lekë,

-Në kontabilitet, janë mbajtur të analizuar vlerat sipas objekteve të investuara nga Bashkia Kurbin dhe të analizuar sipas vendndodhjes së tyre në vlerë sipas Njësive Administrative.

-Drejtoria e Financës nuk disponon të dhëna nëse është kryer inventarizimi fizik për Aktivet afat gjata materiale të llogarive 210, 211, 212, 213 dhe 214 përkatësisht për: Toka, troje, terrene, pyje, kullota, plantacione, ndërtesa e konstruksione, rrugë, rrjete e vepra ujore, instalime teknike, makineri e pajisje, në kundërshtim me kërkesat e pikave 74 e 96 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar.

-Nga auditimi mbi regjistrimin e aktiveve të qëndrueshme në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Vendore në pronësi të Bashkisë Kurbin, u konstatua se nuk janë kryer regjistrimet në pronësi dhe rrjedhimisht nuk kanë marrë certifikatën e pronësisë, veprime në kundërshtim me kërkesat e neneve 9, 12, Kap. III dhe neni 23, pika 14, Kap. VII të Ligjit nr. 139/2015 “*Për Vetëqeverisjen Vendore*”, i ndryshuar.

Mos kryerja e inventarizimit të aktiveve afat gjata materiale, është në shkelje të kërkesave të pikave 74 dhe 96, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar dhe pika 30, Kap. III të UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”.

10.1 Rekomandim: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata Materiale (AAGJM), të verifikojë dhe saktësojë pronat të investuara prej saj ndër vite si dhe për ato që me Vendime të Këshillit të Ministrave, kanë kaluar në pronësi të saj dhe të rakordojë rezultatet e inventarizimit dhe llogaritë kontabël përkatëse, në përfundim të punës komisioni të hartojë relacion për titullarin për rezultatet e inventarizimit.

Brenda 6 Mujorit I-rë të vitit 2022

Zbatimi: Rekomandimi 10.1 nuk është zbatuar.

11. Gjetje nga auditimi: Në 5 (pesë) procedura prokurimi konkretisht a). “Pastrimi i qytetit, ruajtja dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të varrezave 1+2+3, Laç”, Bashkia Kurbin (zhvilluar në vitin 2014); b). “Pastrimi, grumbullimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane dhe të ngurta, gjelbërimi, dekori dhe mirëmbajtja e varrezave për Njësine Administrative Mamurras” (zhvilluar në vitin 2015-16); c). “Pastrimi, grumbullimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane dhe të ngurta për Njësine Administrative Milot” (zhvilluar në vitin 2015-16); d). “Pastrimi, grumbullimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane dhe të ngurta për Njësine Administrative Fushë Kuqe” (zhvilluar në vitin 2015-16); dhe e). “Pastrimi i qytetit, ruajtja dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të varrezave 1+2+3, Laç”, Bashkia Kurbin (zhvilluar në vitin 2019).

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në procesverbalet e mbajtur në lidhje me hartimin dhe miratimin e kriterëve të kërkesave kualifikuese në DT, nuk ka argumentuar në asnjë rast për kriteret e vendosura në secilën kërkesë të veçantë të kualifikimit, ndërsa është mjaftuar vetëm me listimin e kërkesave për kualifikim me pasqyrimin e përshkrimi të termave në mënyrë të përgjithshme, apo janë vendosur kriterë jo në përputhje me;

-Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”, pikat (1; 3/a e 4) dhe

-Ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Neni 83 “Kohëzgjatja normale e javës së punës është jo më shumë se 40 orë.....” dhe Pika 2 e Nenit 92;

-VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës”, Pika (2) neni 28 “Kontrata e Shërbimeve”; neni 59 Pika (2), paragrafi i fundit; neni 61 “Hartimi dhe publikimi dokumenteve të tenderit”, pika (2), paragrafi (2).

11.1- Rekomandimi: NJHDT në hartimin e miratimin e kriterëve të kërkesave kualifikuese në DT, të argumentojë me hollësi secilin kriter në kërkesat kualifikuese të pasqyruara në procesverbalin përkatës. Argumentimi të bëhet i hollësishëm mbi natyrën e kontratës, zërat e preventivit, volumet e punimeve/shërbimeve, kohëzgjatjen e kontratës, orët e punës për njësi të zërave të preventivit, analizave të manualit teknik të çmimeve, numrin e nevojshëm të mjeteve, punonjësve, licencave, etj, me analizë të hollësishme për secilin kriter të vendosur.

Brenda 6 Mujorit II-të të vitit 2021

Zbatimi: Rekomandimi 11.1 është zbatuar pjesërisht.

13. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer mbi identifikimin dhe vlerësimin e nivelit të implementimit të MFK, Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi, komunikimi dhe monitorimi rezultoi se Bashkia Kurbin ju është përmbajtur pjesërisht objektivave të vendosur prej saj në lidhje me monitorimin dhe menaxhimin e MFK-së, konkretisht: Nuk janë dërguar deklaratat e misionit si dhe raporti i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm sipas formatit, Raporti për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollin nuk është dërguar në përputhje me kriteret e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Pyetëtori i vetvlerësimit për vitin 2019 është dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik me vonesë, nuk disponohet regjistër risku.

13.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Kurbin, të merren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, hartimin e regjistrit të riskut, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë

Zbatimi: Rekomandimi 13.1 nuk është zbatuar.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar rezultoi se struktura e NJAB-së funksionon vetëm me një punonjës, e cila është P/NJAB-së, nuk i është kushtuar vëmendje e vecantë auditimeve me risk të lartë, siç janë prokurimet publike, lejet e ndërtimit etj.

14.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Kurbin, të merren masa për plotësimin e strukturës së NJAB-së sipas legjislacionit në fuqi, t’i kushtohet më tepër rëndësi auditimeve me risk të lartë si prokurimet publike, lejet e ndërtimit, taksat etj

Menjëherë

Zbatimi: Rekomandimi 14.1 nuk është zbatuar.

15. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kurbin është audituar nga KLSH në vitin 2019 dhe në vijim është bërë verifikimi i zbatimit të rekomandimeve me shkresën nr. 1082/45 prot., datë 05.06.2020, protokolluar në Bashkinë Kurbin me nr. 2280 prot., datë 09.06.2020 ku është kërkuar zbatimi i masave të pa zbatuara. Për përmirësimin e gjendjes janë kërkuar 9 masa

organizative të rekomanduara 7 masa janë në proces dhe 2 masa janë të pa zbatuara, konkretisht rekomandimet nr.2, nr. 5, nr. 7, nr. 11, nr. 14, nr. 15 dhe nr. 17, ndërsa rekomandimet nr.16 dhe nr.18 janë të pazbatuara.

Nga 4 masa shpërblim dëmi, në vlerën 7,218,185 lekë, të cilat janë pranuar nga ku është arkëtuar shuma 318,730 lekë, ndërsa shuma 6,900,355 lekë është ende e pa arkëtuar, të cilat janë në proces, respektivisht rekomandimi nr.1, nr.2, nr.3 dhe nr.6.

Bashkisë Kurbin i janë rekomanduar 2 masa për eliminimin e efekteve negative respektivisht rekomandimi nr.1 dhe nr.2, masa të cilat janë në proces, në vlerën 4,745,385 lekë; 1 masë për uljen e borxhit tatimor në vlerën 110,710,081 lekë, e pranuar dhe në proces zbatimi; 1 masë administrative e cila është në proces, në shumën totale 500,000 lekë, nga ku rezulton se është arkëtuar shuma prej 61,000 lekë duke mbetur në proces arkëtimi edhe vlera prej 439,000 lekë.

15.1 Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Kurbin, drejtoria juridike dhe ekonomike të merren masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Për këtë të ndiqen të gjitha rrugët e mundshme ligjore deri në hapjen e proceseve gjyqësore. Nga titullari të hartohet një plan veprimi dhe të caktohen personat përgjegjës për zbatimin e tij. Të njoftohet KLSH për masat e marra.

Menjëherë

Zbatimi: Rekomandimi 15.1 është zbatuar pjesërisht.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, ish Komuna Milot i ka dhënë me qira subjektit Shoqëria “H C” ShPK, për përdorim për qëllime biznesi pasuri përkatësisht:

1. Sipërfaqen që do të shërbejë për ndërtimin e rrugës me gjatësi prej 0.45 km tokë pyjore, që do shërbejë për ndërtimin e rrugës për të shkuar në hidrocentral. (131.250 lekë)

2. Sipërfaqen që do të shërbejë për shtrirje tubacioni me gjatësi 2.95 km, që do shërbejë për shtrirje tubacioni. (2.95 km x 145.000 lekë shtrirje tubacioni cunqishte= 427,750 lekë)

3. Sipërfaqen që do shërbejë për shtrirje e linjës elektrike me gjatësi 2.75 km, e cila fillon nga fshati Vinjollë e deri në fshatin Shullaz. Afati i kontratës është 10 vjet duke filluar nga 2014-2024. (2.75 km x175.000 lekë shtrirje të linjës elektrike = 481.250 lekë).

Qiraja vjetore për vlerën e bimësisë pyjore, gjatë ndërtimit në hapjen e trasesë për shitjen e linjës është 96.000(nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë.

Vlera totale e qirasë vjetore të kontratës është 1.136.250 lekë e llogaritur sipas VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010. Drejtoria e Taksave Vendore nuk ka vjelë vlerën 1.040.250 lekë (1,136,250-96,000=1,040,250 lekë) por i referohet Vendimit të Këshillit të Komunës Milot nr. 17 datë 21.02.2014 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore” me zbritje 30% nga vlera e përgjithshme, sipas pikës 4.5 të këtij neni dhe raportit teknik të miratuar në vlerën 699,375 lekë, gjë që ka sjellë dëm ekonomik vlerën 1,381,125 lekë, për Bashkinë Kurbin. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 i ndryshuar, me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” lidhja nr. 2, pikat 11.

3.1 Rekomandimi: Bashkia Kurbin nëpërmjet zyrës juridike të ndjek të gjitha masat (administrative dhe ligjore) ndaj subjektit shoqëria “H C” ShPK, për kontratat e lidhura në datat 15.02.2014 dhe 10.03.2014 për vjeljen e detyrimit në vlerën **1,381,125 lekë** gjë që ka sjellë dëm ekonomik për Buxhetin e Bashkisë Kurbin.

Menjëherë dhe në vijimësi

Zbatimi: Rekomandimi 3.1 është në proces zbatimi.

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.Gjetje nga auditimi:

1.a. Gjetje nga auditimi: Njësia e Prokurimi në Bashkinë Kurbin nuk ka hartuar procesverbalin e argumentimit të fondit limit, për 6 (gjashtë) procedura të zhvilluara në këtë bashki, si më poshtë;

- *“Blerje materiale dekori, bashkia Kurbin”*, Urdhër prokurimi nr. 3, datë 03.01.2019, fondi limit 1,375,000 lekë pa TVSh, lloji procedurës, “Kërkesë për propozim”.

- *“Blerje materiale pastrimi dhe detergjent për aparatin, çerdhen, pallatin e kulturës dhe arsimin”*, Urdhër prokurimi nr. 12, datë 09.01.2019, fondi limit 2,416,667 lekë pa TVSh, lloji procedurës, ”Kërkesë për propozim”.

- *“Lyerja e Institucioneve Arsimore, Bashkia Kurbin”*, Urdhër prokurimi nr. 29, datë 18.01.2019, fondi limit 7,415,669 lekë pa TVSh, lloji procedurës, “Kërkesë për propozim”.

- *“Riparim rrugësh të pa asfaltuara, bashkia Kurbin”*, Urdhër prokurimi nr. 62, datë 13.02.2019, fondi limit 7,248,698 lekë pa TVSh, lloji i procedurës “Kërkesë për propozim”.

- *“Ndriçimi i rrugës së kishës, bashkia Kurbin”*, Urdhri prokurimit nr. 36, datë 11.02.2019, fondi limit 2,453,547 lekë pa TVSh, lloji i procedurës “Kërkesë për propozim”.

- *“Punime për shërbimin e ndriçimit të disa zonave të qytetit Laç, Mamurras, Milot, Bashkia Kurbin”*, Urdhër prokurimi nr. 96, datë 04.04.2019, lloji i procedurës “Kërkesë për propozim”.
Veprime dhe mosveprime që bien në kundërshtim me pikën 1 të nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*.

1.b. Gjetje nga auditimi: Njësia e Prokurimit në Bashkinë Kurbin nuk ka bërë argumentimin teknik dhe ligjor, me procesverbal, të specifikimeve teknike të vendosura në dokumentet standarde të tenderit, në 7 (shtatë) praktika të prokurimit publik të zhvilluara në këtë bashki. Si më poshtë;

- *“Blerje materiale dekori, bashkia Kurbin”*, Urdhër prokurimi nr. 3, datë 03.01.2019, fondi limit 1,375,000 lekë pa TVSh, lloji procedurës, “Kërkesë për propozim”.

- *“Lyerja e Institucioneve Arsimore, Bashkia Kurbin”*, Urdhër prokurimi nr. 29, datë 18.01.2019, fondi limit 7,415,669 lekë pa TVSh, lloji procedurës, “Kërkesë për propozim”.

- *“Punime riparime për zyrat e PMNZ dhe kapanon, Bashkia Kurbin”*, Urdhër prokurimi nr. 33, datë 23.01.2019, fondi limit 4,542,381 lekë pa TVSh, lloji i procedurës “Kërkesë për propozim”.

- *“Riparim rrugësh të pa asfaltuara, bashkia Kurbin”*, Urdhër prokurimi nr. 62, datë 13.02.2019, fondi limit 7,248,698 lekë pa TVSh, lloji i procedurës “Kërkesë për propozim”.

- *“Ndriçimi i rrugës së kishës, Bashkia Kurbin”*, Urdhër prokurimi nr. 36, datë 11.02.2019, fondi limit 2,453,547 lekë pa TVSh, lloji i procedurës “Kërkesë për propozim”.

- *“Punime për shërbimin e ndriçimit të disa zonave të qytetit Laç, Mamurras, Milot, Bashkia Kurbin”*, Urdhër prokurimi nr. 96, datë 04.04.2019, lloji i procedurës “Kërkesë për propozim”.

- *“Rikonstrukcion i plotë i shkollës 9-vjeçare “Mark Trokthi, Laç”*, Urdhri prokurimit nr. 88, datë 02.04.2019, fondi limit 82,492,842 lekë pa TVSh, lloji i procedurës “I hapur”.

Veprime dhe mosveprime që bien në kundërshtim me pikën 1 të nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 46-94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.c. Gjetje nga auditimi: Njësia e Prokurimit në Bashkinë Kurbin ka vendosur në dokumentet standarde të tenderit kritere jo në përputhje me kuadrin ligjor për prokurimin publik, në 10 (dhjetë) praktika të prokurimit publik të zhvilluara në këtë bashki

- *“Blerje materiale dekori, Bashkia Kurbin”*, Urdhër prokurimi nr. 3, datë 03.01.2019, fondi limit 1,375,000 lekë pa TVSh, lloji procedurës, “Kërkesë për propozim”.

- *“Blerje materiale pastrimi dhe detergjent për aparatin, çerdhen, pallatin e kulturës dhe arsimin”*, Urdhër prokurimi nr. 12, datë 09.01.2019, fondi limit 2,416,667 lekë pa TVSh, lloji procedurës, ”Kërkesë për propozim”.

- *“Riparim rrugësh të pa asfaltuara, bashkia Kurbin”*, Urdhër prokurimi nr. 62, datë 13.02.2019, fondi limit 7,248,698 lekë pa TVSh, lloji i procedurës “Kërkesë për propozim”.

- *“Ndriçimi i rrugës së kishës, bashkia Kurbin”*, Urdhër prokurimi nr. 36, datë 11.02.2019, fondi limit 2,453,547 lekë pa TVSh, lloji i procedurës “Kërkesë për propozim”.

- *“Shërbimi i pastrimit dhe mirëmbajtjes së varrezave nr. 1,2,3, të qytetit Laç, bashkia Kurbin”*, Urdhri prokurimit nr. 36, datë 11.02.2019, fondi limit 141,124,405 lekë pa TVSh, lloji procedurës “I hapur”.

- *“Punime për shërbimin e ndriçimit të disa zonave të qytetit Laç, Mamurras, Milot, Bashkia Kurbin”*, Urdhër prokurimi nr. 96, datë 04.04.2019, lloji i procedurës “Kërkesë për propozim”.

- *“Rikonstruksion i plotë i shkollës 9-vjeçare “Mark Trokthi, Laç”*, Urdhri prokurimit nr. 88, datë 02.04.2019, fondi limit 82,492,842 lekë pa TVSh, lloji i procedurës “I hapur”.

- *“Ndërtim i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të ujësjellësit të qytetit Laç, faza e I”*, Urdhër prokurimi nr. 2017, datë 01.11.2019, lloji i procedurës “I hapur”, me fond limit 416,666,667 lekë pa TVSh.

- *“Lyerja e Institucioneve Arsimore, Bashkia Kurbin”*, Urdhër prokurimi nr. 29, datë 18.01.2019, fondi limit 7,415,669 lekë pa TVSh, lloji procedurës, “Kërkesë për propozim”.

- *“Punime riparime për zyrat e PMNZ dhe kapanon, bashkia Kurbin”*, Urdhër prokurimi nr. 33, datë 23.01.2019, fondi limit 4,542,381 lekë pa TVSh, lloji i procedurës “Kërkesë për propozim”.

Veprime dhe mosveprime që bien në kundërshtim me pikën 1 të nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*.

Veprime dhe mosveprime që bien në kundërshtim me pikën 2 të nenit 23 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar.

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kurbin, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve sipas llojit të procedurës, me synim sigurimin e pjesëmarrjes së gjerë në procedurat e prokurimit. Të bëhet argumentimi teknik për secilin kriter, duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve dhe dokumentacioni i argumentimit të kritereve të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 është në proces zbatimi.

2. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit me objekt:

- *“Blerje materiale dekori”*, me fond limit 1,375,000 lekë pa TVSh, ku është shpallur fitues OE “S. T.” ShPK, me vlerë 1,365,000 lekë, procedurë në të cilën kanë konkurruar 2 OE, prej të cilëve është s’kualifikuar 1OE;

- *“Ndriçimi i rrugës së kishës”*, me fond limit 2,453,547 lekë, është shpallur fitues OE “2 Z Konstruksion” ShPK, me vlerë 2,404,250 lekë, procedurë në të cilën kanë konkurruar 2 OE, prej të cilëve është s’kualifikuar 1 OE;

- *“Punime për shërbimin e ndriçimit të disa zonave të qytetit Laç, Milot, Mamurras”*, me fond limit 2,698,233 lekë, është shpallur fitues OE “B.” ShPK, me vlerë 2,572,600 lekë, procedurë në të cilën ka konkurruar 1 OE i vetëm;

- *“Rikonstruksion i plotë i shkollës 9 – vjeçare Mark Trokthi, Laç”*, me fond limit 82,492,842 lekë, është shpallur fitues OE “S.” ShPK, me vlerë 82,310,597 lekë, procedurë në të cilën kanë konkurruar 7 OE, prej të cilëve janë s’kualifikuar 6 OE;

- *“Ndërtim i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të ujësjellësit të qytetit Laç, faza e I”*, me fond limit 416,666,667 lekë, është shpallur fitues BOE “S.” ShPK & “2 T”ShPK, me vlerë 414,559,284 lekë, procedurë në të cilën kanë konkurruar 5 OE, prej të cilëve janë s’kualifikuar 3 OE,

Ofertuesi i shpallur fitues nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e vendosura nga AK në DT.

KVO në vendimin e saj ka vepruar në paligjshmëri të përdorimit të fondeve në shumën 414,559,284 lekë, veprime këto që bien në kundërshtim me pikën 3 të nenit 53 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar.

2.1.Rekomandimi: Bashkia Kurbin, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomikë në kushtet e mosplotësimit të kritereve të miratuara në DT,

pasi operatorët ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, e cila nga auditimi arrin shifrën prej **503,212 mijë lekë**. Strukturat përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të prokurimit të konsiderojnë faktin se përlllogaritja e Fondit Limit, Specifikimet Teknike e DT jo në përputhje me realizimin e shërbimit si dhe kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret për realizimin e kontratës, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, është edhe risk real për shpenzimet jo efektive të njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Menjëherë

Zbatimi: Rekomandimi 2.1 nuk është zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “*Ndriçimi i rrugës së kishës, Bashkia Kurbin*”, zhvilluar në datë 25.02.2019, fituar nga OE “2 Z K”, me vlerën e ofertës ekonomike 2,404,250 lekë, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kurbin, ka nënshkruar kontratën me OE fitues pa bërë sigurimin e kësaj kontrate. Veprim që bie në kundërshtim me pikën 1 dhe 3 të nenit 24 të VKM nr. 914, 29.12.2014, i ndryshuar. “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

3.1.Rekomandimi: Bashkia Kurbin, të vlerësojë situatën dhe të marrë masa për të mos u përsëritur më praktika të tilla, të cilat çenojnë garancinë e zbatimit të kontratës.

Menjëherë

Zbatimi: Rekomandimi 3.1 nuk është zbatuar.

4.Gjetje nga auditimi:

4/1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës nr. 238/10 prot., datë 04.04.2014 me objekt: “*Pastrimi i qytetit, ruajtja dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të varrezave 1+2 +3, Laç*”, Bashkia Kurbin, me vlerë të kontratës 137,457,768 lekë me TVSh, fituar nga OE “B” ShPK, rezultuan diferenca në volumin e shërbimit të pakryer në vlerën **632,207 lekë me TVSh**, si pasojë e paraqitjes gabim të numrit minimal të punonjësve të domosdoshëm. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me DT dhe kontratën nr. 238/10 prot., datë 04.04.2014 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kurbin dhe OE “B.” ShPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 46-94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

4/2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës nr. 2581/10 prot., datë 09.02.2016 me objekt: Loti I “*Pastrimi grumbullimi dhe depozitimi i mjeteve urbane dhe të ngurta, gjelbërimi, dekorimi dhe mirëmbajtje e varrezave për njësinë administrative Mamurras*”, Bashkia Kurbin, me vlerë të kontratës 95,053,210 lekë me TVSh, fituar nga BOE “L 2014 K.” ShPK & “I & K” ShPK & “B” ShPK, rezultuan diferenca në volume shërbimi të pakryera në vlerën **5,406,333.68 lekë me TVSh**, si pasojë e paraqitjes gabim të numrit minimal të punonjësve të domosdoshëm. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me DT dhe kontratën nr. 2581/10 prot., datë 09.02.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kurbin dhe përfaqësuesit ligjor të BOE. “L 2014 K” ShPK

4/3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës nr. 2581/13 Prot., datë 10.02.2016 me objekt: Loti II “*Pastrimi, grumbullimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane dhe të ngurta për Njësinë Administrative Milot*”, Bashkia Kurbin, me vlerë të kontratës 23,999,520 lekë me TVSh, fituar nga OE “B” ShPK, rezultuan diferenca në volumin e shërbimit në vlerën **1,564,649.07 lekë me TVSh**, si pasojë e paraqitjes gabim të numrit minimal të punonjësve të domosdoshëm. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me DT dhe kontratën nr. 2581/13 prot., datë 04.04.2014 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kurbin dhe OE “B” ShPK.

4/4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës nr. 2581/14 Prot., datë 10.02.2016 me objekt: Loti III “*Pastrimi, grumbullimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane dhe të ngurta për Njësinë Administrative Fushë Kuqe*”, Bashkia Kurbin, me vlerë të kontratës 21,836,626 lekë me TVSh, fituar nga OE “B” ShPK “rezultuan diferenca në volume shërbimi të pakryera në vlerën **1,478,373.53 lekë me TVSh**, si pasojë e paraqitjes gabim të numrit

minimal të punonjësve të domosdoshëm. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me DT dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2581/14 Prot., datë 10.02.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kurbin dhe OE “B” ShPK.

4/5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës nr. 942/19 Prot., datë 05.04.2019 me objekt: “Pastrimi i qytetit, ruajtja dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të varrezave 1 + 2 + 3, Laç”. Bashkia Kurbin, me vlerë të kontratës 165,674,646 lekë me TVSh, fituar nga OE “B” ShPK “rezultuan diferenca në volume shërbimi të pakryera në vlerën **8,306,067.67** lekë me TVSh, si pasojë e paraqitjes gabim të numrit minimal të punonjësve të domosdoshëm. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me DT dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 942/19 Prot., datë 05.04.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kurbin dhe OE. “B” ShPK.

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin, të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për diferencat në volumin e shërbimit të pastrimit, si pasojë e paraqitjes gabim të numrit minimal të punonjësve të domosdoshëm (referuar përlllogaritjes së FL, DT, Specifikimeve Teknike e Ofertës Fituese), duke shkaktuar përdorimin pa ekonomikitet të fondeve publike, për vlerën **18,387,631 lekë me TVSh.**

Menjëherë

Zbatimi: Rekomandimi 4.1 nuk është zbatuar.

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit, të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore, rezultoi se janë krijuar debitorë, të cilët në datën 30.06.2020 kanë vlerën progresive 230,494,948 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e njësisë vendore, nga të cilat;

- 473 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën 39,895,606 lekë,
- 8720 familje debitorë për taksën e tokës bujqësore në vlerën 74,903,909 lekë,
- 5,700 familje debitorë për tarifën vendore në vlerën 31,989,500 lekë,
- të tjera taksa (ndërtim etj.) në vlerën 83,705,933 lekë.

Mos arkëtimi i plotë i detyrimeve për taksat dhe tarifën vendore, përveçse është mos përmbushje e detyrimeve ligjore, sipas detyrës funksionale të punonjësve të kësaj strukture, krijon mungesa financiare në buxhet dhe për pasojë ul nivelin e investimeve dhe të shpenzimeve të tjera që njësi vendore ka parashikuar në favor të komunitetit. Mungesa e të ardhurave është ndikim i drejtpërdrejtë në mosrealizimin e buxhetit në zërin e shpenzimeve për periudhën 2019-2020.

Nga Bashkia Kurbin nuk janë ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme ligjore në rend shterues, për arkëtimin e debitorëve, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 89, 90, 91, të Ligjit nr. 9920 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe nenin 12 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore.

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 230,494,948 lekë, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

- a-Të dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.
- b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme).
- c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë).
- d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal.

e- Për debitorët familjarë, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës, të ndërtesave dhe tarifave familjare dhe të realizojë arkëtimin e detyrimit të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Menjëherë

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 nuk është zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit nuk janë marrë masa lidhur me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI, Drejtoria Rajonale Lezhë. Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Kurbin, konstatohet se deri më 30.06.2020, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë 1198 persona, veprimi dhe mosveprimi është në mospërputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23, VKB nr. 75, datë 19.12.2017 “Për Sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, ndryshuar me VKB nr. 81, datë 22.12.2018, pika IV, tabela nr. 5, VKB nr. 40, datë 11.12.2019 “Për Sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, të Bashkisë Kurbin, pika IV, sipas listës që disponon Bashkia, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 42,550,195 lekë.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrë masa të veçanta lidhur me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që janë legalizuar nga ALUIZNI, Drejtoria Rajonale Lezhë, në vlerën 42,550,195 lekë konkretisht për 823 raste në vlerën 30,082,964 lekë, progresive të trashëguara nga viti 2018 dhe për vitin 2019 janë 375 raste në vlerë 12,467,231 lekë, me pasojë të ardhura të munguara të pa kontabilizuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Zbatimi: Rekomandimi 2.1 nuk është zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Kurbin, për periudhën 01.01.2019-30.06.2020 ka vendosur 40 procesverbale gjobe, në vlerën prej 11,000,000 lekë. Inspektorati i Mbrojtës së Territorit Vendor (IMTV) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Kurbin, nuk ka kërkuar në Gjykatë, shndërrimin e 22 vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv, në përputhje me nenin 24 “Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv” dhe neni 30 “Arkëtimi i shumave të detyrimeve” të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. Gjithashtu ndaj 18 personave që kanë kryer ndërtim pa leje në territorin e Bashkisë Kurbin dhe nuk janë vendosur penalitete nga IMTV, në vlerën 9,000,000 lekë, në moszbatim të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar neni 52, shkronja e).

3.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtës Territorit Vendor (IMTV) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Kurbin, të kërkojnë në Gjykatë, shndërrimin e 22 vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv dhe arkëtimin e vlerës 11,000,000 lekë. Gjithashtu të marrë masa për vendosjen e penaliteteve nga IMTV në vlerën 9,000,000 lekë ndaj 18 personave që kanë kryer ndërtim pa leje në territorin e Bashkisë Kurbin.

Menjëherë dhe në vijimësi

Zbatimi: Rekomandimi 3.1 është në proces zbatimi.

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer për arkëtimin e vlerës së taksës për lëshimin e autorizimeve/licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, në zbatim të me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1;

germa "b" dhe pika 9, në Bashkinë Kurbin për periudhën 01.01.2019-30.06.2020 konstatohet se:

Në Bashkinë Kurbin ushtrojnë aktivitetet 11 subjekte debitorë në vlerën 11,000,000 lekë, ("G C" SHPK me vlerë 1,000,000 lekë, "A & C" me vlerë 1,000,000 lekë, "D O" ShPK me vlerë 1,000,000 lekë, "B-P" ShPK me vlerë 1,000,000 lekë, "S G" ShPK me vlerë 1,000,000 lekë, "B" ShPK me vlerë 1,000,000 lekë, "E A" ShPK me vlerë 1,000,000 lekë, "K" me vlerë 1,000,000 lekë, "N.O" me vlerë 1,000,000 lekë, "S P" ShPK me vlerë 1,000,000 lekë dhe "F" me vlerë 1,000,000 lekë), të cilat nuk janë pajisur me autorizime/licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe shitjes së lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët.

4.1 Rekomandimi: Bashkia Kurbin të marrë masa të menjëhershme për pezullimin e aktivitetit deri në pajisjen me lejen/autorizimin e nevojshëm për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin e shumës 11,000,000 lekë për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Menjëherë

Zbatimi: Rekomandimi 4.1 nuk është zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer për procedurat e dhënies me qira të objekteve pronë e Bashkisë Kurbin dhe e ndërmarrjeve shtetërore në varësi ose nën juridiksionin e Bashkisë, u auditua dokumentacioni për periudhën 01.01.2019-30.06.2020, në lidhje me dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore dhe inproduktive, nga ku konstatohet se nga Bashkia Kurbin nuk ka lidhur kontrata me subjektet të cilat janë pajisur me leje nga Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për dhënien me qira për sipërfaqet pyjore dhe kullimore që administrohen nga kjo bashki në vlerën **190,416 mijë lekë**, për subjektet "M H" me sipërfaqe 0.55 ha me vlerë 363,000 lekë, "K" ShPK me sipërfaqe 6.51 ha me vlerë 4,296,600 lekë, "A-G" ShPK me sipërfaqe 16 ha me vlerë 10,560,000 lekë dhe sipërfaqe 29,8 ha me vlerë 19,668,000 lekë, "N K" ShPK me sipërfaqe 6 ha me vlerë 3,960,000 lekë, "I E" ShPK me sipërfaqe 54 ha me vlerë 35.640.000 lekë, "A" ShPK me sipërfaqe 9.07ha me vlerë 5.986.200 lekë, "L" ShPK me sipërfaqe 80,18 ha me vlerë 52,918,800 ha dhe "K-2015" ShPK me sipërfaqe 86.4 ha me vlerë 57.024.000 lekë. Këto subjekte duhet ti referohen pikës 2; lidhjes nr. 2, pika 6/1 dhe pika 9/4 të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", i ndryshuar, me VKM 1064 datë 22.12.2010 "Për Përcaktimin e Tarifave në Sektorin e Pyjeve dhe të Kullotave".

5.1. Rekomandimi: Bashkia Kurbin, të lidhë kontrata me subjektet të cilat janë miratuar me leje nga Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për dhënien me qira për sipërfaqet pyjore dhe kullimore që administrohen nga kjo bashki për subjektet "M H" me sipërfaqe 0.55 ha me vlerë 363,000 lekë, "K" ShPK me sipërfaqe 6.51 ha me vlerë 4,296,600 lekë, "A-G" ShPK me sipërfaqe 16 ha me vlerë 10,560,000 lekë dhe sipërfaqe 29,8 ha me vlerë 19,668,000 lekë, "N K" ShPK me sipërfaqe 6 ha me vlerë 3,960,000 lekë, "I E" ShPK me sipërfaqe 54 ha me vlerë 35.640.000 lekë, "A" ShPK me sipërfaqe 9.07ha me vlerë 5.986.200 lekë, "L" ShPK me sipërfaqe 80,18 ha me vlerë 52,918,800 ha dhe "K-2015" ShPK me sipërfaqe 86.4 ha me vlerë 57.024.000 lekë.

Menjëherë

Zbatimi: Rekomandimi 5.1 nuk është zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Kurbin, nuk është vepruar, për të arkëtuar tarifën e pastrimit, të ndriçimit dhe tarifën e gjelbërimit për subjektet e ndërtimit të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike, për periudhën e auditimit 01.01.2019-30.06.2020. Subjektet debitorë "S-K" ShPK në vlerën 65,000 lekë, "L VII" ShPK në vlerën 65.000 lekë, "B" ShPK

në vlerën 65,000 lekë, “S” ShPK në vlerën 65,000 lekë, “S” ShPK & “2” ShPK në vlerën 65,000 lekë, “C R 2008” ShPK në vlerën 65,000 lekë, sipas paketës fiskale Vendimit të Këshillit të Bashkisë Kurbin nr. 170, datë 12.12.2018 dhe VKB nr. 32, datë 22.11.2019 “Për miratimin e paketës fiskale”, dhe Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe udhëzimit përkatës nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar 43.1. Këto subjekte janë debitorë në vlerën 390.000 lekë, gjë që ka sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Kurbin.

6.1 Rekomandimi: Bashkia Kurbin të marrë masa të menjëhershme për arkëtimin e vlerës 390,000 lekë, për subjektet debitorë “S-K” ShPK në vlerën 65,000 lekë, “L VII” ShPK në vlerën 65.000 lekë, “B” ShPK në vlerën 65,000 lekë, “S” ShPK në vlerën 65,000 lekë, “S” ShPK & “2” ShPK në vlerën 65,000 lekë, “C R 2008” ShPK në vlerën 65,000 lekë.

Menjëherë

Zbatimi: Rekomandimi 6.1 është zbatuar pjesërisht.

F. MASA ADMINISTRATIVE

1. Ing. A.K., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në kontratën nr. 2842/15 Prot, datë 13.08.2018 me objekt “*Rikonstrukcion i shkollës 9-vjeçare nr.3 + ambiente sportive, qyteti Laç*”.

2. Ing. G.I., në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në kontratën nr. 2842/15 Prot, datë 13.08.2018 me objekt “*Rikonstrukcion i shkollës 9-vjeçare nr.3 + ambiente sportive, qyteti Laç*”, Bashkia Kurbin.

Zbatimi: Rekomandimi 5.1 nuk është zbatuar.

(Në mënyrë të detajuar zbatimi i rekomandimeve paraqitet në Kapitullin V “Aneksë - Aneksin nr.4)

Kriteri: Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa j). Shkresa nr. nr.773/11, datë 20.11.2021 e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës.

Shkaku: Mosmarrje e masave për vënien në zbatim të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Ndikimi/Efekti: Risk i shtuar në aktivitetin e Bashkisë Kurbin, ku mangësi të konstatuara në auditimin e mëparshëm vazhdojnë të përsëriten.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e plotë të tyre.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë:

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2021-2023, u konstatua se:

-Nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Kurbin;

-Nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik, strukturë e cila është përgjegjëse për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të integruar të planifikimit;

-Procedura e përgatitjes së PBA 2021-2023 nuk dokumentohet plotësisht, pasi në dosjen përkatëse të PBA, nuk administrohet dokumentacioni mbi kërkesat e bëra për fondet nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Kurbin, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;

-Në buxhetin vjetor të vitit 2021 nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin dhe përmirësimin e fondit pyjor. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “ç” e nenit 5, pika 1 e nenit 33, pika 1 e nenit 35, pika 1 e nenit 37 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pika 5 e nenit 23 në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020; Pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë Grupin e Menaxhimit Strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues i programeve ekonomike.

-Gjithashtu për çdo vit të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Kurbin.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit të procedurave për investime publike, konstatohet se niveli i realizimit të investimeve kapitale të planifikuara në vitin 2021 paraqitet masën 89%. Kjo situatë është krijuar si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Kurbin në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 24 dhe 25 në nenin 3, nenin 47 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta

për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2021, u konstatua se janë të pa likuiduara gjithsej 1344 fatura për vlerën totale 47,605 mijë lekë, nga të cilat 237 fatura të palikujduara janë krijuar në vitin 2021 në vlerën totale 1,552 mijë lekë. Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2021, përcjellë në MFE, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Kurbin ndaj palëve të treta raportuar në MFE, përbëhet nga detyrime për vendime gjyqësore, shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale në vlerën 47,605 mijë lekë, ndërsa sipas përlllogaritjeve të grupit të auditimit referuar të dhënave mbi lëvizjen debitore dhe kreditore të llogarisë 486 me kundërparti llogarinë 467, si dhe llogarinë 401-404, rezulton se vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura ne 31.12.2021, që duhej të raportohet në MFE është në vlerën 48,101 mijë lekë. Në fund të vitit 2021 të ardhurat e trashëguara për vitin 2022 (pa përfshirë fondet e rindërtimit) janë në vlerën 205,916 mijë lekë, ose detyrimet e prapambetura zënë 23% të tyre, ç'ka do të thotë se Bashkia Kurbin mund të likujdojë detyrimet e prapambetura.

-Gjithashtu sa i përket respektimit të radhës së likujdimin të detyrimeve të prapambetura (pra fatura e parë likujdohet më parë), u konstatua se nuk është respektuar ky kriter ligjor në 4 raste. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në udhëzimin nr.26, datë 27.09.2019 "Procedura për menaxhimin e vështirësisë financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore"; Kreun XI pika 1, neni 56 në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 "Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme"; Pikat 8 dhe 184 të udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin dhe Drejtorja e Financës, të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta. -Planifikimin e grafikut të likujdimin të detyrimeve të prapambetura, si dhe likujdimin e tyre gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve në dispozicion.

Përgjatë vitit buxhetor 2023

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.468 "Debitorë të ndryshëm", u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Kurbin për arkëtim ndaj të tretëve, nuk është pasqyruar saktë, sepse kjo llogari është pasqyruar më pak për vlerën 101,030,695 lekë duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, për vlerën prej:

- 1,461,222 lekë për taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale;
- 1,347,673 lekë për taksat dhe tarifën (principal dhe kamat-vonesë) vendore të biznesit;
- 3,679,921 lekë, vlerë e përfshirë brenda shumës totale 59,611,011 lekë, e trashëguar nga vitet e mëparshme dhe që nuk është e analizuar me dokumentacion në mënyrë analitike.
- 17,100,000 lekë, detyrime që kanë për të likujduar 17 subjekte, të cilët janë pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve;
- 1,235,438 lekë detyrim për likujdimin e tarifës së qirasë nga subjekti "H.C" Sh.P.K;
- 55,787,323 lekë për taksën e tokës bujqësore;
- 20,419,118 lekë për detyrimet e kategorisë "Familjar", e trashëguar nga vitet e mëparshme dhe që nuk është e analizuar me dokumentacion në mënyrë analitike.

Konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr. 470 "Llogari në pritje – të ardhura për t'u marrë" (me kundërparti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën "ë", pika 3, neni 12 në ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; Rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja "c" në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe

raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, është pasqyruar më shumë për vlerën 13,002,996 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4” në udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave ju ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.401-408 “Furnitor dhe llogari të lidhura me to”, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më pak, për vlerën 10,565,436 lekë, për fatura të mbërritura, të palikujduara në fund të vitit 2021 dhe të pa regjistruara në pasqyrat financiare. Një pjesë e faturave të mësipërme (dy fatura të muajit tetor të vitit 2021 të subjektit “Vale” Sh.P.K në vlerën 496,048 lekë gjithsej) kanë plotësuar afatin 60-ditor pa u likuiduar, e për rrjedhojë duhet të kontabilizohen në llogarinë nr.467 “Kreditor të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr.486, me qëllim pasqyrimin e plotë të vlerës së detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2021. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar - “funksionimi kontabël i llogarive të klasës 4”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme, që të kryej vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të detyrimeve të bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë nr. 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar me 606,602,230 lekë gjithsej, e ndarë për vlerën prej:

-595,000,000 lekë aksione në shoqërinë aksionare “Ujësjetllës Kanalizime Kurbin Sh.A” me NIPT K07628310A;

-10,727,230 lekë aksione në shoqërinë aksionare “Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A” me NIPT J61819502V;

-875,000 lekë aksione në shoqërinë aksionare “Klubi i Futbollit Laçi” me NIPT L18105301N. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Urdhrin e Ministrit të MFE nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”; Kreun 3.1,

pika 31, shkronja “b” në udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive nr.210 “Toka, Troje, Terrene” nr.211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, u konstatua se në këto llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera në vitet 2006-2018, pa ndryshuar në vijimësi, duke mos pasqyruar:

-vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, të pallatit të kulturës, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj;

-vlerat e trojeve, pyjeve dhe kullotave të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Kurbin,

-Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i aseteve për dy llogaritë e mësipërme.

-Për llogaritë e mësipërme në Bashkinë Kurbin nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kapitullin III, neni 9, pika 1.2 në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Pikat 26, 27, 30 dhe 74 në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; Kapitullin III, pika 30 në udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me qëllim kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve.

8.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme, për:

- Kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.210 “Toka, Troje, Terrene” nr.211 “Pyje, kullota, plantacione”.

- Hartimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, i cili minimalisht duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më shumë për vlerën 49,828,544 lekë, si rrjedhojë e kontabilizimit në këtë llogari të disa makinerive, si 3 fadroma, 1 kovë eskavatori dhe 1 rimorkiator, të cilat janë makineri dhe jo mjete transporti, si dhe duhet të klasifikohen në llogarinë nr.214. Për këto makineri duhet të aplikohet normë tjetër amortizimi (5%) dhe jo (20%). Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik-instalime teknike, paisje, instrumente dhe vegla pune – llogaria 7-shifrore 2140240-Paisje dhe makineri për konstruksione (ndërtime); 2140260-Paisje

pastrimi për rrugët; 2140320-Mjete dhe paisje te tjera teknike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:

-Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.

-Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.

-Për vitin 2021 nuk ka pasur plan-veprimi për MFK.

-Nuk është hartuar “Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”.

-Për vitin 2021 nuk dokumentohet ngritja dhe funksionimi i GMS.

-Nuk është hartuar rregjistri i riskut dhe strategjia e menaxhimit të riskut. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 14-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësat e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

10.2. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Juridike të kryejë ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim shmangien e mbivendosjes dhe përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune në funksion të strukturës organizative të Bashkisë Kurbin.

10.3. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre.

Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2023

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Kurbin përgjatë vitit 2021, u konstatua se:

-Numri i punonjësve në sektorin e auditit të brendshëm nuk është sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, sipas të cilës njësia e auditit të brendshëm duhet të ketë 3 punonjës, ndërkohë kanë qenë dy të punësuar.

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla për titullarin e njesisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit.

-Në auditimet e kryera për vitin 2021, konstatohet se nuk është planifikuar kryerja e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

-Në përfundim të auditimeve të kryera përgjatë vitit 2021 nuk është dhënë opinion i auditimit.

-Për vitin 2021, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Kurbin, të cilat kanë risk të lartë, si Drejtoria e Financës, Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave, prokurimet publike etj. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bëra në shkronjën “ç” në nenin 6, nenin 13, shkronja “ç” në

nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”; Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”; Pikën 3.1.3 në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1, faqe 22-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për:

- Plotësimin e pozicioneve vakante (përgjegjës sektori dhe auditues) në NJAB Kurbin;
- Ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Brenda 6 muhorit të parë të vitit 2023

11.2. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kurbin, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore etj, në mënyrë që t'i ofrojë mbështetje titullarit të njësive vendore në arritjen e objektivave.

Përgjatë vitit 2023 dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se nga 49 rekomandime të dhëna, 27 prej tyre janë zbatuar ose 56%, 3 zbatuar pjesërisht ose 7%, 3 në proces zbatimi ose 7%, si dhe 16 pa zbatuar ose 33%.

-Në vlerë monetare, sa i përket rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, rezulton se: Janë dhënë 3 rekomandime për shpërbllimin e dëmit të krijuar për 3 subjekte në vlerën 6,565 mijë lekë dhe janë pranuar plotësisht nga subjekti, prej të cilave, 2 janë zbatuar dhe arkëtuar për vlerën 5,184 mijë lekë për 2 subjekte, si dhe 1 në proces zbatimi për vlerën 1,381 mijë lekë për 1 subjekt.

Janë dhënë 4 masa për eliminimin e efekteve negative financiare në vlerën 770,658 mijë lekë dhe janë pranuar plotësisht, prej të cilave, 1 masë në vlerën 249,059 mijë lekë ose 33% është në proces zbatimi, si dhe 3 prej tyre në vlerën 521,599 mijë lekë ose 67 % nuk janë zbatuar.

Janë dhënë 6 masa për eliminimin e borxhit tatimor, për 16174 subjekte në vlerën 494,850 mijë lekë dhe janë pranuar plotësisht, prej të cilave, është në proces zbatimi 1 masë për 40 subjekte në vlerën 20,000 mijë lekë, ose 4% e tyre në vlerë monetare, si dhe 5 masa në vlerën 474,850 mijë lekë ose 96 % nuk janë zbatuar.

-Janë lënë 2 masa administrative, të cilat nuk janë zbatuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 59-72, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin të marrë të gjithë masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, të cilat ende rezultojnë të pazbatuara.

Brenda 6-muhorit të parë të vitit 2023

C.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura për vitin 2021, rezulton se Bashkia Kurbin për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërbllim page për largime nga puna të punonjësve, ka shpenzuar vlerën 10,915 mijë lekë për 6 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi për një pozicion pune paguhen dy persona. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur, konkretisht për 6 praktika likuidimi të vendimeve gjyqësore të përzgjedhura në

mënyrë rastësore, u konstatua se janë kryer likuidime pjesore, megjithëse Bashkia Kurbin ka pasur disponibilitete në thesar për të likuiduar plotësisht vendimet gjyqësore. Gjithashtu në urdhrin e Titullarit të institucionit për likuidimin e vendimeve gjyqësore të mësipërme, nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna, moslikuidimit në kohë të detyrimit pa krijuar shpenzime të përmbarimit) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Kurbin. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative, do të ndikonte pozitivisht në korigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore dhe si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin dhe Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme, që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun dhe likuidimin e plotë të detyrimeve të prapambetura nga vendimet gjyqësore.

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Programimi i të ardhurave për vitin 2021 është në vlerën 153,897 mijë lekë dhe janë realizuar në fakt në vlerën 110,498 mijë lekë, pra me një realizim në masën 71.8 %, ku mosrealizimi është në vlerën 43,399 mijë lekë. Detyrimet e papaguara nga taksapaguesit për periudhën 2011-2021 paraqiten në shumën prej 332,560 mijë lekë në progresiv, ku vetëm për vitin 2021 shuma e debitorëve është 103,605 mijë lekë, vlera këto të konsiderueshme, që përbëjnë të ardhura të munguara për Bashkinë Kurbin. Administrimi i procesit për mbledhjen e detyrimeve tatimore ka mangësi në lidhje me ndjekjen e veprimeve procedurale nga ana e Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave Vendore, pasi nuk janë ezauruar të gjitha hapat dhe mekanizmat e përcaktuar në legjislacionin tatimor për të siguruar mbledhjen e këtyre detyrimeve. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH” i ndryshuar, Kreu XI, nenet 89, 90, 91, 93, 97 dhe 98, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2014 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, Kreu VIII, neni 42. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1 Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore, të marrë masa konkrete ndaj subjekteve debitorë duke ndjekur e zbatuar procedurat tatimore, me qëllim mbledhjen e detyrimeve dhe mos krijimin e detyrimeve të prapambetura për secilën kategori biznesi

Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2023 dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktivitetit si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve u konstatua se 17 subjekte nuk kanë paguar tarifën 1,000,000 lekë, për të rinovuar licensën e ushtrimit të aktivitetit, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë në vlerë totale prej 17,100,000 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 9 të VKM nr. 344 datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970 datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1. Rekomandim: Bashkia Kurbin, nëpërmjet Drejtorisë së Ardhurave Vendore të marrë masa që për 17 subjekte⁹ debitorë të arkëtojnë tarifën e plotë, për diferencën debitorë prej 17,100,000 lekë, detyrim ky për paisjen me autorizim/liçensë për tregtimin me pakicë të karburanteve dhe gazit të lëngshëm vajrave lubrifikante për automjetet. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për pagesën e tarifës së liçencë/autorizimit, Bashkia Kurbin në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik Industrial të ndërmarin veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2023

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale, u konstatua se vlera debitorë për këtë taksë në mënyrë progresive është 39,481 mijë lekë për 1095 subjekte, nga të cilat 25 subjekte për vlerën 787 mijë lekë janë krijuar në vitin 2021. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Kurbin, nuk janë marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë¹⁰. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 në nenin 89 në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pikën 2 të nenit 4, shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 22/5 në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar dhe pikën IV në VKB nr.152, datë 14.12.2020 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2021”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 27-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit t’i përcjellë Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave (DAP) listën me subjektet debitorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë, si dhe në vijim DAP Bashkia Kurbin të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë prej 39,481 mijë lekë.

Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2023

⁹ Pasqyruar lista e subjekteve në Raportin Përfundimtar të Auditimit, Kapitulli V “Aneksë – Aneksi nr.2”.

¹⁰ Sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, TNI është taksë vendore dhe për arkëtimin e saj, duhet të zbatohen masat e parashikuara në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

V. ANEKSE

Aneksi nr.1 – Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit trajtuar nga faqja nr.20 deri në faqen nr.73 të raportit përfundimtar të auditimit.

Tabela nr.3 Ndryshimet buxhetore 2021-2023

Nr.	Date	Vendimet e Këshillit të Bashkisë, për ndryshimet e buxhetit për ndryshime ndërmjet programeve buxhetore (2021);
		Qellimi
175	26.08.2021	Për miratimin e rishpërndarjes së fondit të zërave të shpenzimeve korrente për Rikonstruksion i ambienteve ndihmëse në funksion të terreneve sportive Gurëz, në vlerën 1,500,000 lekë gjithsej. Pakësohen fondet e investimeve në objektin për Ndërtim infrastrukture Patok, në vlerën 1,500,000 lekë gjithsej.
150	26.06.2021	Për miratimin e rishpërndarjes së fondit të zërave të shpenzimeve korrente për Ndërtim (Rikonstruksion) I Kuz Milot në vlerën 1,960,000 lekë gjithsej.
3	01.11.2021	Për miratimin e rishpërndarjes së fondit të zërave të shpenzimeve korrente kanë ndodhur shtesa/paksim të fondeve në programin 1110-Administrim planifikim, për pagat e administratës në vlerën 3,139,000 lekë, për sigurimet shoqërore të administratës në vlerën 641,000 lekë, pakësim të fondeve për shpenzime operative në vlerën 3,780,000 lekë.
14	27.01.2021	Me VKB nr. 14 datë 27.01.2021, si dhe me vendim nr. 15 datë 27.01.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësim nga fondi i emergjencave civile në vlerën 1,320,000 lekë.
16	27.01.2021	Me VKB nr. 16 datë 27.01.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësim nga fondi i emergjencave civile në vlerën 600,000 lekë.
24	26.02.2021	Me VKB nr. 24 datë 26.02.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësim nga fondi rezervë në vlerën 220,000 lekë.
38	23.04.2021	Me VKB nr. 38 datë 23.04.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësim për kryerjen e shpenzimeve për investime në vlerën 459,472 lekë.
41	23.04.2021	Me VKB nr. 41 datë 23.04.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësim për kryerjen e shpenzimeve për oponencë teknike në vlerën 4,537,079 lekë.
57-58-59	24.06.2021	Me VKB nr. 57, 58, dhe 59 datë 24.06.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësim nga fondi i emergjencave civile në vlerën 850,000 lekë.
76	26.07.2021	Me VKB nr. 76 datë 26.07.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësim nga fondi rezervë në vlerën 300,000 lekë.
81	30.08.2021	Me VKB nr. 81 datë 30.08.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësim për kryerjen e shpenzimeve për sigurimet shoqërore në vlerën 2,277,913 lekë.
98	03.11.2021	Me VKB nr.98 datë 03.11.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësim për kryerjen e shpenzimeve për shtyerje afati të ambienteve të marra me qera nga Bashkia në vlerën 390,000 lekë.
116	23.12.2021	Me VKB nr. 116 datë 23.12.2021, kanë ndodhur shtesa/pakësim për kryerjen e shpenzimeve për dhënie ndihme për familjet në nevojë në vlerën 500,000 lekë.

Burimi: Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Investime (231 dhe 230) të Bashkisë me të ardhurat e veta për vitin 2021

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti përfundimtar i projektit	Plani i buxhetit viti 2021	Realizimi progresiv 12-mujor	Realizimi ne %	Komente
1260120	Projekt tregu lac	300			300		0%	Per likujdim
1260122	Projekt rruget	500			500		0%	Per likujdim
1260016	Blerje kompjuterash	3,000			3,000		0%	Per likujdim
1260017	Blerje kontenieresh	1,439	2,021	2,021	1,439	1,439	100%	Realizuar
1260129	Ndertim tregu milot	10,000			10,000		0%	Per likujdim
1260129	Supervizim ndertim tregu Milot	500			500		0%	Per likujdim
1260129	Kolaudim ndertim tregu Milot	30			30		0%	Per likujdim
1260061	Kolaudim I ndricim I disa zonave Lac	5			5		0%	Per likujdim
1260061	Investim ne ndricimin rrugor	9,597	2,021	2,021	9,597	9,560	100%	Realizuar
1260061	Supervizim I nderhyrjeve elektrike	171			171		0%	Per likujdim
1260119	Rehabilitim I pallatesh fasada Mamurras+mbikqyrje	49,453	2,021		49,453	41,371	84%	Realizuar
1260115	Rikonstruksioni i shkolles 9-vjecare Mark Trokthi lac	98,419	2,019	2,020	27,288	15,000	55%	Per likujdim

1260102	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare nr 3 Lac	94,453	2,018	2,019	3,391		0%	Per likujdim
1260042	Mbikqyrje e rikualifikimit urban sheshit qendror Lac	1,668			1,668		0%	Per likujdim
1260125	Asfaltim rruges shkolla F.Mamurras -Rruga stacionit	17,849	2,021	2,021	18,000	17,849	100%	Realizuar
1260125	Supervizim asfaltim rruges shkolla F.Mamurras -rruga stacionit	21			21		0%	Per likujdim
1260125	Kolaudim asfaltim rruges shkolla F.Mamurras -rruga stacionit	50			50		0%	Per likujdim
1260123	Supervizim ndertim (rikonstruksion I kuz Milot)	1,304			1,304		0%	Per likujdim
1260123	Ndertim (rikonstruksion I kuz Milot)	4,756	2,021	2,022	4,756		0%	Per likujdim
1260123	Kolaudim ndertim (rikonstruksion I kuz Milot)	30			30		0%	Per likujdim
1260124	Asfaltim rrugeve ne lagje Sanxhak	24,878	2,021	2,021	24,914	11,192	45%	Pjeserisht
1260124	Supervizim asfaltim rrugeve ne lagje Sanxhak	36			36		0%	Per likujdim
1260124	Kolaudim asfaltim rrugeve ne lagje Sanxhak	30			30		0%	Per likujdim
1260126	Ndertim infrastrukture ne patok	1,493			1,493		0%	Per likujdim
1260126	Supervizim ndertim infrastrukture ne Patok	120			120		0%	Per likujdim
1260126	Kolaudim ndertim infrastrukture ne Patok	50			50		0%	Per likujdim
1260043	Mbikqyrje punimesh rikonstruksion Pallati i Kultures Lac	37	2,021		37	37	100%	Realizuar
1260127	Rehabilitim I hapësirave te perbashketa mes pallateve Lac	3,000			3,000		0%	Per likujdim
1260128	Rikonstruksion tregut lac	3,918			3,918		0%	Per likujdim
1260103	Rindertim I terreneve sportive	5,479			5,479		0%	Per likujdim
1260025	Mbikqyrje e rikonstr bashkise Lac	114			114		0%	Per likujdim
1260101	Mbikqyrje e rinovim trotuaresh Lac	116			116		0%	Per likujdim
1260095	Kolaudim I shtrim I rrugeve me cakull	10			10		0%	Per likujdim
1260041	Kolaudim I rik,Shkolles Mesme	116			116		0%	Per likujdim
1260130	Mbikqyrje e prishje e detyruar e banesave individ	337			337		0%	Per likujdim
1260088	Ndertim I ambienteve ndihmese ne funksion te terreneve sportive Gurez	1,500			1,500		0%	Per likujdim
	TOTALI	334,779			172,773	96,448	56%	

Burimi: Bashkia Kurbin, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Aneksi nr.2 – Mbi hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare trajtuar nga faqja nr.74 deri në faqen nr.89 të raportit përfundimtar të auditimit.

Aktivi i Bilancit Kontabël 2021

Llogaria	E M E R T I M I	Viti 2021	Viti 2020
A	A K T I V E T	4,741,465,415	4,042,549,877
	I.Aktivet Afat shkurtra	1,897,358,045	1,516,264,081
	1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	1,509,789,364	1,100,205,582
531	Mjete monetare ne Arke		
512,56	Mjete monetare ne Banke		
520	Disponibilitete ne Thesar	1,509,789,364	1,099,755,582
50	Letra me vlere		
532	Vlera te tjera	0	450,000
54	Akreditiva dhe paradhenie		
59	Provizgjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
	2.Gjendje Inventari qarkullues	59,878,235	103,575,157
31	Materiale	0	125,319
32	Inventar I imet	59,878,235	103,449,838
33	Prodhim nre proces		
34	Produkte		
35	Mallra		
36	Kafshe ne rritje e majmeri		
37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
39	Provizgjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
	3.Llogari te Arketushme	327,690,446	312,483,342
411	Kliente e llogari te ngjashme		
423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	56,681,103	50,115,698

431	Tatim e Taksa		
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
435	Sigurime Shoqerore		
436	Sigurime Shendetstore		
437,438,	Organizma te tjere shteterore		
44	Institucione te tjera publike		
465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
468	Debitore te ndryshem	200,433,496	153,209,401
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	70,575,847	109,158,243
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	0	0
409	Parapagime		
473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
477	Diferenca konvertimi aktive		
481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		
	II.Aktivet Afat gjata	2,844,107,370	2,526,285,796
20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	14,266,254	19,849,053
201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
202	Studime dhe kerkime	14,266,254	19,849,053
203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
21	2.Aktive Afatgjata materiale	2,207,630,048	2,069,609,153
210	Toka, T,roje, Terene	8,652,463	8,652,463
211	Pyje, Plantacione	9,414,833	9,414,833
212	Ndertesa e Konstruksione	953,425,919	798,402,372
213	Rruge, rrjete, vepra ujqore	1,092,944,136	1,123,058,710
214	Instalime teknike, makineri e paisje	30,127,206	27,392,332
215	Mjete Transporti	24,245,023	33,642,414
216	Rezerva Shteterore		
217	Kafshe pune e prodhimi		
218	Inventar ekonomik	78,099,794	61,661,491
24	Aktive afatgjata te demtuara	3,312,673	2,650,138
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata	7,408,000	4,734,400
25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
	4.Investime	622,211,068	436,827,590
230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
231	Per Aktive Afatgjata materiale	622,211,068	436,827,590

▪ **Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme”&“Të tjera aktive afatshkurtra”përbëhet nga:**

	Viti	2021	2020
Llogaria	Llogari te Arketushme	327,690,446	312,483,342
411	Kliente e llogari te ngjashme		
423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	56,681,103	50,115,698
431	Tatim e Taksa		
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
435	Sigurime Shoqerore		
436	Sigurime Shendetstore		
437,438,	Organizma te tjere shteterore		
44	Institucione te tjera publike		
465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
468	Debitore te ndryshem	200,433,496	153,209,401
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	70,575,847	109,158,243
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	0	0
409	Parapagime		
473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
477	Diferenca konvertimi aktive		
481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 70,575,847 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të

Pasqyrës së Performancës Financiare. Vlera prej 70,575,847 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivitet të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar.

Përshkrimi	Mbetja në fund të vitit 2021	Burimi i të ardhurave për mbulimin e detyrimit përkatës
	70,575,847	
Furnitore dhe llogari të lidhura me to	47,605,378	Me grand+ të ardhurat e veta
Detyrime ndaj personelit për pagat dhjetor 2021	16,123,680	Me grand
Detyrime ndaj shteti për tatim mpagje	907,772	Me grand
Detyrime ndaj sigurimeve për dhjetor 2021	4,760,661	Me grand
Detyrime për sig shendetsore	653,456	Me grand
Kreditore të ndryshme (Pagese keshilltaresh dhjetor 2021)	524,900	Me grand

Llogaria 481 “Shpenzime për t’u shpërndarë në disa ushtrime” në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 0 lekë. Është llogari rregulluese ku përfshihen shpenzimet e kryera për riparimet e mëdha, shpenzimet për punime parapërgatitore të një lloji veprimtarie, shpenzime të kryera gjatë vitit ushtrimor (që nuk përfshihen në aktivet e qëndrueshme dhe nuk mund të rëndohen tërësisht në rezultatin e ushtrimit). Këto shpenzime shpërndahen (amortizohen) në vitet e ardhshme.

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë sipas PF në sistemin e thesarit pasqyrohet në vlerën 19,858,004 lekë. Vlera e kësaj llogarie duhet të përfaqësojë detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve, si shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore, për detyrime të prapambetura për shërbime, për detyrime të prapambetura për mirëmbajtje, për investime, për detyrime të prapambetura të tjera.

Kjo llogari ka si kundërpasigje gjendjen e llogarisë nr.467 “Kreditore të ndryshme” në pasiv të bilancit në vitin 2021.

II. AKTIVET AFATGJATA

Llogaria	Viti	2021	2020
	II. Aktivet Afat gjata	2,844,107,370	2,526,285,796
20	1. Aktive Afatgjata jo materiale	14,266,254	19,849,053
201	Prime të emisionit dhe Rimbursimit të huave		
202	Studime dhe kërkime	14,266,254	19,849,053
203	Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme		
21	2. Aktive Afatgjata materiale	2,207,630,048	2,069,609,153
210	Toka, T, roje, Terene	8,652,463	8,652,463
211	Pyje, Plantacione	9,414,833	9,414,833
212	Ndertesa e Konstruksione	953,425,919	798,402,372
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,092,944,136	1,123,058,710
214	Instalime teknike, makineri e paisje	30,127,206	27,392,332
215	Mjete Transporti	24,245,023	33,642,414
216	Rezerva Shtetërore		
217	Kafshe pune e prodhimi		
218	Inventar ekonomik	78,099,794	61,661,491
24	Aktive afatgjata të demtuara	3,312,673	2,650,138
28	Caktime të Aktiveve Afatgjata	7,408,000	4,734,400
25-26	3. Aktive Afatgjata Financiare	0	0
25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet		

Llog.202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 14,266,254 lekë në fund të vitit 2021.

Gjithashtu sipas formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në fund të vitit ushtrimor 2021 llogaria nr.202 “Studime dhe kërkime” paraqitet në vlerën 14,266,254 lekë.

Llogaria	Teprica në fillim			Shtesat gjate vitit		Pakësimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
B			3	4	5	6	7	8	9	10
20	37,218,661	17,369,608	19,849,053	0	5,582,799		0	37,218,661	22,952,407	14,266,254
201										
202	37,218,661	17,369,608	19,849,053	0	5,582,799		0	37,218,661	22,952,407	14,266,254
203	0	0	0					0	0	0

Referuar formatit të mësipërm vihet re së për llogarinë nr.202 “Studime dhe kërkime”, nuk kemi patur shtesa dhe pakësime, ku kosto historike paraqitet në vlerën 37,218,661 lekë duke zbritur amortizimin e akumuluar në vlerën 22,952,407 lekë, teprica neto (vlera kontabël neto) paraqitet në shumën prej 14,266,254 lekë.

PASIVET (DETYRIMET)

	Viti	2021	2020
Llogaria	PASIVET(DETYRIMET)	139,153,854	134,748,239
	I.Pasivet Afat shkurtra	139,153,854	134,748,239
	1. Llogari te Pagushme	139,153,854	134,748,239
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	47,605,378	88,040,394
42	Detyrime ndaj personelit	16,123,680	14,874,747
16,17,18	Hua Afat shkurtra		
460	Huadhenes		
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	907,772	754,573
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
435	Sigurime Shoqerore	4,760,661	4,354,610
436	Sigurime Shendetesore	653,456	598,319
437,438,	Organizma te tjere shteterore	0	0
44	Institucione te tjera publike		
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere	0	450,000
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	68,578,007	25,139,996
467	Kreditore te ndryshem	524,900	535,600
4341	Operacione me shtetin(detyrime		
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
	2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
419	Kreditore, Parapagime		
475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
478	Diferenca konvertimi pasive		
480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
	II.Pasivet Afat Gjata	0	0
Klase 4	Llogari te pagushme		
16.17,18	Huate Afat gjata		
	Provigjonet afatgjata		
Klasa 4	Te tjera		

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Kurbin më 31.12.2021, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2021, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2021, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave të investimeve.

Pasqyra e Performancës Financiare

Llogaria	P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE	VITI	VITI
		USHTRIMOR	I MEPARSHEM
b	c	1	2
A	TE ARDHURAT	3,693,073,843	2,729,818,267
70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	44,062,082	29,069,918
700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	1,916,727	1,568,143
7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
7001	Tatim mbi Fitimin		
7002	Tatim mbi Biznesin e vogel	1,916,727	1,568,143

7009	<i>Te tjera Tatime mbi te ardhurat</i>		
702	2.Tatimi mbi Pasurine	5,283,822	5,350,771
7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme	5,031,032	4,633,709
7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshe		
7029	Te tjera tatime mbi Pasurine	252,790	717,062
703	3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit	36,411,533	22,151,004
7030	Tatim mbi vleren e shtuar(TVSH)		
7031	Akciza		
7032	Takse mbi sherbimet specifike		
7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie		
7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	36,411,533	22,151,004
704	4.Takse mbi tregtine dhe transakcionet nderkombtare	0	0
7040	Takse doganore per mallrat e importit		
7041	Takse doganore per mallrat e eksportit		
7042	Tarife sherbimi doganor e kaliposte		
7049	Te tjera taksa mbi tregtine e transakcionet nderkombtare		
705	5.Takse e rruges		
708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare	450,000	
709	7.Gjoha e Kamat vonesa		
75	II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE	0	0
750	NGA TE PUNESUARIT		
751	NGA PUNEDHENESI		
752	NGA TE VETPUNESUARIT		
753	NGA FERMERET		
754	NGA SIGURIMET VULLNETARE		
755	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHOQERORE		
756	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHENDETESORE		
71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	15,610,665	9,106,103
710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	28,400	1,729,865
7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare		
7101	Nga Ndermarrjet publike financiare		
7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	28,400	1,729,865
711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	8,245,310	7,126,238
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore		
7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	8,245,310	7,126,238
7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale		
7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve		
7114	Te ardhura nga biletat		
7115	Gjoha, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime		
7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje		
719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore	7,336,955	250,000
76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE	0	0
760	Nga interesat e huadhenies se brendshme		
761	Nga interesat e huadhenies se Huaj		
765	Nga interesat e depozitave		
766	Nga kembimet valutore		
72	V.GRANTE KORENTE	3,633,401,096	2,691,642,246
720	1.Grant korent I Brendshem	3,633,401,096	2,691,642,246
7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)		
7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)	3,511,999,560	2,537,355,787
7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH		
7203	Nga Buxheti per mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)		
7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale		
7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
7206	Financim I pritshe nga buxheti	70,575,847	109,158,243
7207	Sponsorizime te brendshme(nga te trete)	8,085,611	1,087,832
7209	Te tjera grante korent te brendshme	42,740,078	44,040,384
721	2.Grant korent I Huaj	0	0
	Nga Qeveri te Huaja		
	Nga Organizata Nderkombetare		
	VI.TE ARDHURA TE TJERA	0	0
781	Te ardhura nga investimet ne ekonomi		
782	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatshkurtra		
783	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatgjata		
784	Rimarrje Shumash per shpenzime te viteve ardhshme		
787	Terheqje nga seksioni I investimeve		
73	VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE		
B	SHPENZIMET	2,251,862,486	1,655,202,681

600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	232,288,871	209,580,776
6001	Paga, personel I perhershëm	232,288,871	205,718,781
6002	Paga personel I Perkohshëm	0	0
6003	Shperblime		0
6009	Shpenzime te tjera per personelin	0	3,861,995
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	38,299,118	34,350,678
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	34,400,405	30,852,910
6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	3,898,713	3,497,768
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	202,427,624	169,877,088
602	Mallra dhe sherbime te tjera		
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	67,729,019	24,504,042
6021	Materiale dhe sherbime speciale	1,143,012	967,082
6022	Sherbime nga te trete	81,910,378	79,880,132
6023	Shpenzime transporti	22,101,958	26,192,979
6024	Shpenzime udhetimi	0	550,000
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	4,908,100	8,303,406
6026	Shpenzime per qeramarrje	591,270	456,780
6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	18,005,740	22,052,864
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua		0
6029	Shpenzime te tjera operative	6,038,147	6,969,803
603	IV.SUBVEZIONE	0	0
6030	Subvecone per diference cmimi		
6031	Subvecone per te nxitur punesimin		
6032	Subvecone per te mbuluar humbjet		
6033	Subvecone per siper marrjet individuale		
6039	Subvecone te tjera		
	V.TRANSFERIME KORENTE	1,735,149,951	1,280,021,817
604	1.Transferime korente te brendshme	938,668,724	592,909,454
6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise		
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetesore		
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse	938,668,724	592,909,454
605	2.Transferime korente me jashte	0	0
6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare		
6052	Transferime Per Qeverite e Huaja		
6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurse te huaja		
6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit		
606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	796,481,227	687,112,363
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	796,481,227	687,112,363
	VI.SHPENZIME FINANCIARE	0	0
65	1.Shpenzime Financiare te brendshme	0	0
650	Interesa per bono thesarit dhe kredi direkte		
651	Interesa per huamarrje te tj. Brendshme		
652	Interesa Letra tjera vlere Qeverise		
656	Shpenz.nga kembimet valutore		0
66	2.Shpenzime Financiare te jashtme	0	0
660	Interesa per huamarrje nga Qeveri.te Huaja		
661	Interesa per financime nga Institucionet.nderkomb		
662	Interesa per huamarrje te tjera jashtme		
	VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA	0	0
681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit		
682	Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashte perdorimit e te shitura		
683	Shuma te parashikuara te shfrytezimit		
686	Shuma te parashikuara per aktivet financiare		
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	43,696,922	-38,627,678
	IX.SHPENZIME TE TJERA	0	
85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIU DHES		
	<i>(Rezultati I Veprimtarise se vititUshtrimor)</i>	1,441,211,357	1,074,615,586

Për sa më sipër paraqitet Raporti Përfundimtar i Auditimit

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT